



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Raporti Vjetor i Punës së Qeverisë për vitin 2015

Prill, 2016
Prishtinë

Raport i zbatimit të Prioriteteve Strategjike të Qeverisë

HYRJE

Gjatë vitit 2015, Qeveria e Republikës së Kosovës ka zbatuar një Plan ambicioz në të gjitha fushat e qeverisjes. Në zbatim të këtij Planit dhe objektivave të përcaktuara në të, Qeveria e Republikës së Kosovës ka hasur në vështirësi të brendshme si dhe sfida që dalin nga Agjenda Evropiane. Pavarësisht, gjatë vitit 2015 është arritur progres i konsideruar si dhe janë vënë në funksion mekanizmat e nevojshëm për t'i arritur rezultatet e synuara, si dhe për shtyrjen përpara të proceseve politike.

Qeveria e Republikës së Kosovës është e vendosur që t'u prijë proceseve të cilat përmirësojnë rangimin e Kosovës, në nivelet e duhura në sferën ndërkombëtare, të cilat janë me rëndësi për zhvillimin e shtetit tonë.

Në arritje të progresit dhe sigurimin e një trendi zhvillimor për vendin, është e nevojshme që të sigurohet stabilitet politik dhe institucional, në këtë kuadër, është e qartë që të gjithë akteret vendor mund të kontribuojnë akoma më shumë, në arritje të objektivave të paracaktuara, si dhe atyre që Qeveria e Republikës së Kosovës do t'i përcaktojë për vitet në vijim.

Ky Raport gjithëpërfshirës, ka për qëllim që t'i nënvizojë progresin e arritur në realizimin e prioriteteve strategjike të qeverisë, me theks të veçantë progresin e arritur përgjatë vitit 2015. Në këtë aspekt, ky Raport ka si pikë reference Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, në kuadër të të cilit nënvizohen pesë prioritete strategjike.

Prioriteti i I-rë: Rritje dhe zhvillim i qëndrueshëm ekonomik

Në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, është arritur progres në përmirësimin e politikave fiskale. Hapat në përmirësimin e reformave fiskale sigurojnë stabilitet financiar dhe ambient të favorshëm për zhvillim ekonomik, sigurojnë politika tregtare konkurruese dhe përmirësimin e mjedisit në të bërit biznes, mundësojnë përkrahjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, promovimin e investimeve, si dhe efikasitetin e shpenzimeve dhe regullatIVES fiskale.

Njëkohësisht, një ndër objektivat strategjike të qeverisë ka qenë dhe mbetet promovimi i politikave për rritje ekonomike dhe krijim të vendeve të reja të punës përmes Fondit për Investim dhe Punësim, diçka që do pritet të mbështesë dhe fuqizojnë akoma më shumë politikatat dhe skemat aktuale e punësimit, të cilat si rezultat i angazhimit të shërbimit publik të punësimit dhe përkrahjes së donatorëve, gjatë këtij viti kanë shënuar përparim të theksuar.

- *Përmirësimi i kornizës strategjike përmes hartimit të një Strategjie Kombëtare për Zhvillim dhe vendosjes së sistemit për planifikim të integruar*

Janë shënuar rezultate të veçanta në koordinimin e politikave dhe planifikimit strategjik, hartimit dhe mbikëqyrjes së legjislacionit në përputhje me Agjendën Evropiane. Janë hedhur hapat për ngritjen e Sistemit për Planifikim të Integruar, nëpërmjet hartimit të Strategjisë për përmirësimin e Koordinimit dhe Planifikimit të Politikave e cila është miratuar në Qeveri, 03.05.2015. Zbatimi i këtij dokumenti strategjik paraqet intervenime substanciale në kuadër të Reformës së Administratës Publike dhe është në përputhshmëri me parimet e Komisionit Evropian dhe OECD/SIGMA për vendet e Ballkanit Perëndimor.

U hartua për herë të parë Strategjia Kombëtare për Zhvillim e cila përkon me reformat që do të realizohen në kuadër të Sistemit për Planifikim të Integruar. Dokumenti i strategjisë ka kaluar në një proces të gjerë konsultimi me akterë të ndryshëm në shoqërinë civile.

Ka filluar hartimi i Programit të Reformave Ekonomike 2016-2018 (PRE), si pjesë e dialogut ndërmjet BE-së dhe Republikës së Kosovës në kuadër të qeverisjes ekonomike. RE 2016-2018, mbulon periudhën afatmesme (tri vjeçare) dhe paraqet kornizën makro-ekonomike dhe politikatat fiskale, si dhe në anën tjetër agjendën gjithëpërfshirëse të reformave strukturore.

Si pjesë e zotimeve të Qeverisë së Kosovës në kuadër të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (KBR), është hartuar dokumenti strategjik "Vizioni i Kosovës për Shkathtësitë 2020", dhe janë finalizuar në tërësi këtë dokument strategjik së bashku me Udhërrëfyesin, Masat dhe Treguesit e tij, i cili është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 20.05.2015.

Në kuadër të identifikimit dhe shqyrtimit të politikave prioritare dhe dokumenteve strategjike të Qeverisë, është koordinuar procesi i hartimit të Deklaratës vjetore së Prioriteteve Afatmesme në kuadër të KASII-it; është bërë analiza dhe vlerësimi i dokumenteve strategjike sektoriale dhe

dokumente të tjera për qëllime të hartimit dhe harmonizimit të politikave prioritare dhe si rezultat final është hartuar Deklarata e Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë.

Në kuadër të koordinimit të procesit të hartimit të dokumenteve strategjike dhe sigurimit të pajtueshmërisë së tyre me prioritetet e Qeverisë, është bërë shqyrtimi i propozimeve të institucioneve për hartimin e dokumenteve strategjike duke dhënë edhe kontribut për Planin dhe Raportin Vjetor të Qeverisë nga pikëpamja strategjike.

Ka vazhduar ofrimi i mbështetjes për Kryeministrin që të sigurohet që të gjitha Ministrinë të veprojnë në pajtim me politikat prioritare dhe strategjike qeveritare; ofrimi i këshillave për Kryeministrin dhe Qeverinë, për identifikimin dhe shqyrtimin e prioriteteve strategjike të Qeverisë; ofrimi i këshillave për Kryeministrin lidhur me çështje të rëndësishme të politikave të cilat parashtrihen për miratim në mbledhjen e Qeverisë dhe që ndërlidhen drejtpërdrejt me prioritetet Qeveritare; përkujdesja që dokumentet strategjike dhe planifikuese të zhvilluara nga Qeveria të jenë në pajtim me prioritetet e përgjithshme të Qeverisë, përfshirë edhe obligimet që dalin nga procesi i integritimit evropian dhe obligimet tjera ndërkombëtare; koordinimi dhe udhëheqja e procesit të zhvillimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Programit të Reformës Ekonomike 2016; sigurimi i vazhdueshëm që dokumentet strategjike dhe planifikuese të jenë hartuar në pajtim me standardet dhe procedurat e përcaktuara nga Qeveria; përfaqësimi i Zyrës së Kryeministrit në proceset kryesore planifikuese të Qeverisë, dhe në veçanti ZPS është kujdesur që prioritetet qeveritare të pasqyrohen në dokumente planifikuese afatshkurtra dhe afatmesme, si dhe në planifikimin buxhetor të Qeverisë; pjesëmarrje në konferenca dhe aktivitetet e ndryshme jashtë vendit.

Qeveria ka miratuar 24 koncept dokumente që kanë kaluar paraprakisht nëpër dy fazat e shqyrtimit dhe vendimmarrjes¹ dhe janë në proces shqyrtimi edhe 22 Koncept Dokumente të tjerë. Me qëllim të ngritjes së mëtutjeshme të kapaciteteve të Qeverisë për koordinimin dhe zhvillimin e përgatitjes së dokumenteve të politikave gjatë këtij viti është negociuar me Agjencinë Ndërkombëtare për Zhvillim të Suedisë- SIDA, Projekti "Mbështetje shumë vjeçare për përmirësimin e zhvillimit të politikave në Kosovë", projekt ky që do të mbështesë Zyrën e Kryeministrit dhe ministrinë për një periudhë 4 vjeçare me një buxhet rreth 3.2 milion euro. Marrëveshja për zbatimin e projektit është nënshkruar më 18.012.2015.

Janë proceduar në Kuvend: 80 projektligje; 39 vendime të Qeverisë, si opinione, raporte strategji, programe për njoftim, propozime për emërimë nëpër borde, komisione etj.

Është përmirësuar procesi i hartimit dhe monitorimit të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë, nëpërmjet rishikimit të udhëzuesve përkatës. Prosesi i hartimit të dokumentit kryesor operacional vjetor të qeverisë, PVPQ është realizuar këtë vit si një proces i koordinuar, si rezultat i formimit të Ekipeve Teknike të shqyrtimit, të përbëra nga zyrtarët e SKQ, MF, MIE ZPS dhe ZI. të cilat kanë shqyrtuar draftet e planeve për secilën ministri dhe janë mbajtur 20

¹Sipas dispozitave të neneve 7 dhe 35 të Rregullores së Punës së Qeverisë.

takime me ministritë për këtë proces dhe konsultime të vazhdueshme me zyrtarët përgjegjës në ministri.

Qeveria me Vendimin e saj nr. 03/38, në mbledhjen e mbajtur më 15.07.2015, ka miratuar Udhërrëfyesin për vlerësimin e impaktit të zbatimit (*ex-post*) të legjislacionit në Republikën e Kosovës, i cili do të shërben për të vendosur hapat që kërkohen të ndërmerren për realizimin e vlerësimit të efekteve sociale-ekonomike që prodhohen nga zbatimi i legjislacionit, dhe rishikimi i politikave të mëtejshme.

Këto hapa të ndërmarra në procesin e koordinimit të politikave synojnë rritjen e cilësisë së politikë-bërjes në Kosovë dhe realizimin e rekomandimeve të dala nga vlerësimi i kryer nga Komisioni Evropian, në vitin 2015, nëpërmjet OECD/SIGMA.

o *Përmirësimi i qeverisjes ekonomike dhe parashikueshmerisë së politikave ekonomike dhe fiskale*

Qeveria ka ndërmarrë një reformë ligjore në fushën e politikave fiskale me qëllim krijimin e lehtësirave të mëtejshme ndaj biznesit. Në mars të këtij viti, Qeveria e Republikës së Kosovës mori vendime për ndryshime fiskale të cilat kanë të bëjnë me projektligjet e reja të: Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH); Tatimit në të Ardhurat e Korporatave, dhe Tatimit në të Ardhurat Personale. Në këtë kontekst, gjithashtu është rishikuar lista e produkteve të liruar nga detyrimi doganor dhe rrjedhimisht ka shtuar produktet e energjisë si dhe produktet farmaceutike në listën e lirimeve nga detyrimi doganor. Është punuar drejt thjeshtëzimit dhe lehtësimit të procedurave për fiskalizim ku një prej masave që është ndërmarrë është liberalizimi i tregut të operatorëve për shitjen e pajisjeve fiskale.

Përmes Projektligjit për TVSH-në, është ulur pragu i TVSH-së nga 50 mijë euro sa është në ligjin aktual në 30 mijë euro, rrjedhimisht secili biznes i cili realizon qarkullim mbi 30 mijë euro brenda vitit, do të detyrohet të regjistrohet për TVSH-në dhe kështu të shlyej obligimet për pjesën e cila tejkalon këtë shumë. Sipas vlerësimeve të bëra nga Qeveria e Republikës së Kosovës, bizneset do ta kenë për rreth 27.6% më lirë fillimin e procesit të operimit.

Përmirësimi i konkurrencës së prodhimeve kosovare në tregun vendor ashtu edhe atë të jashtëm kanë qenë gjithashtu objekt i politikave fiskale të ndërmarra. Pas hyrjes në fuqi të pakos së re fiskale janë aprovuar 152 kërkesa me ç' rast bizneset janë liruar nga TVSH-ja importit të lëndës së parë e cila shfrytëzohet në procesin e prodhimit. Gjithashtu, të drejtën për importim të makinerive të prodhimit, lëndës së parë që shfrytëzohet për procesin e prodhimit dhe Pajisjeve të Teknologjisë së Informacionit e kanë shfrytëzuar gjithsej 163 kompani.

o *Forcimi i kontrollit financiar dhe menaxhimit të të ardhurave*

Me qëllim të rritjes së efikasitetit në raportimin e shpenzimit të parasë publike janë ndërmarrë një sërë veprimesh në menaxhimin efikas dhe ngritjen e infrastrukturës së sistemeve informative të menaxhimit të financave publike.

Të ardhurat tatimore kanë pësuar rritje. Të hyrat nga ATK për vitin 2015 janë në shumë prej 332,772,000 euro që krahasuar me vitin 2014 janë për 29,077,00 euro me shumë.

Të ardhurat nga dogana kanë pësuar rritje. Të hyrat nga Dogana e Kosovës për vitin 2015 ishin 951,808,000 euro, që krahasuar me vitin 2014 janë për 80,830 me të larta. Me qëllim përmirësimit e mëtejshëm të të ardhurave tatimore është aprovuar plani inicial për procesin e bashkimit të ATK-së dhe Doganës së Kosovës në një Agjenci të përbashkët për grumbullimin e të hyrave tatimore dhe doganore.

Janë ndërmarrë masa me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë së vendit. Është ndërmarrë një politikë e re në vendosjen e nivelit të pagave të sektorit publik në linjë me ato të sektorit privat, nëpërmjet vendosjes së kufizimit për rritjen e pagave të sektorit publik vetëm me rritje të produktivitetit.

Meqenëse niveli i borxhit në vend është i ulët ndërsa nevojat për ngritje të infrastrukturës janë të mëdha, është hartuar klauzola e investimeve e cila do të lejojë shpenzime shtesë për projekte zhvillimore jashtë rregullës fiskale e cila kufizon deficitin buxhetor në 2% të BPV-së.

o *Falja e Borxheve*

Kuvendi i Republikës së Kosovës gjatë këtij viti, ka miratuar Ligjin për faljen e borxheve, i cili është shpallur me Dekretin e Presidentes së Republikës së Kosovës më datën 07.08.2015. Qëllimi i këtij Ligji është falja e borxheve publike ndaj Institucioneve Shtetërore dhe Ndërmarrjeve Publike, si dhe përcaktimi i kriterëve dhe procedurave për faljen e këtyre borxheve, që personat fizik dhe juridik kanë për periudhën deri më 31 dhjetor 2008. Me këtë personat e këtyre përveç faljes së rëndësishme të borxhit për periudhën deri me 31 dhjetor 2008, do të përfitojnë edhe me faljen e gjobave, ndëshkimeve, dhe çdo obligim tjetër që rrjedh nga pagesa me kohën e kryerjes së borxhit për periudhën 01 janar deri me 31 dhjetor 2014. E këto ndryshime afektojnë pozitivisht duke qenë se lehtësojnë barrën e obligimeve financiare tek qytetarë të Republikës së Kosovës.

o *Marrëveshja me Fondin Monetar Ndërkombëtar - FMN*

Viti 2015 ka rezultuar me sukses në drejtim të thellimit të bashkëpunimit me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN). Ky bashkëpunim u konkretizua përmes nënshkrimit të Marrëveshjes që për fokus ka reformat ekonomike e fiskale, që tashmë kanë filluar së zbatuari nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës i ka dhënë përparësi masave për zhvillim ekonomik, krijimit të vendeve të reja të punës dhe ofrimit të mbështetjes së fuqishme për sektorin e bujqësisë dhe energjisë në Kosovë. Të gjitha veprimet në sektorin e sigurimit të reformës dhe qëndrueshmërisë fiskale, përkrahjes së klimës biznese dhe reformave sektoriale, janë vlerësuar pozitivisht nga ana e institucionit të FMN-së, dhe si rezultat kemi thellimin e bashkëpunimit me këtë institucion ndërkombëtar.

Sipas vlerësimeve të përbashkëta për vitin 2015, kriteret e parapara në Programin me FMN-së, janë realizuar në masë të kënaqshme, në këtë drejtim vlen të nënvizohet bilanci më i mirë bankar, performancë më e mirë tatimore, menaxhim dhe mbikëqyrje më e shëndoshë edhe efikase e shpenzimeve buxhetore, si dhe kontroll më rigoroz i shpenzimeve buxhetore. Marrë se bashku, të gjitha këto sigurojnë stabilitet më të madh financiar, racionalizim dhe disiplinim të shpenzimeve nga ana e organizatave buxhetore. Ky është rishikimi i parë që i bëhet programit ekonomik që kemi ne si Qeveri, me Fondin Monetar Ndërkombëtar, të aprovuar në muajin korrik nga Bordi i Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Krahasuar me vitin paraprak, rritja ekonomike e Kosovës ka shënuar trend pozitiv, ndërsa vlerësimet e Ministrisë së Financave konfirmojnë që kjo rritje të jetë 3.8%, që është mjaft e lartë krahasuar me vitin e kaluar, dhe presim që vitin e ardhshëm në 2016 të shkojmë afër 4 % të rritjes ekonomike. Me FMN është dakorduar edhe për reformën e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike.

- *Zvogëlimi papunësisë*

Ndër objektivat kryesore të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ka qenë edhe rritja e numrit të punësimin për qytetarët e Kosovës. Sfidat që kemi pasur para nesh për uljen e nivelit të papunësisë, gjatë vitit 2015 janë adresuar përmes Masave Aktive të Tregut të Punës. Këto masa kanë shënuar rritje, duke targetuar përkrahjen e punëkërkesve dhe të papunëve, me fokus të rinjtë dhe gratë, si dhe përkrahjen e bizneseve në sektorët të identifikuar si sektor me potencial rritjeje dhe qëndrueshmërie. Sipas evidencës nga institucione dhe burime relevante, në kuadër të periudhës Janar-Dhjetor 2015, janë punësuar 15,500 punëkërkes dhe të papunë.

Realizimi i politikave të punësimin dhe masat aktive të tregut të punës edhe këtë vit ka vazhduar përmes qendrave për punësim. Në 2015 janë ndërtuar edhe 2 zyra të Punësimin, në Suharekë dhe Mitrovicë.

- *Mbështetje të grupeve të veçanta të popullsisë*

Qeveria vazhdon përkushtimin ndaj qytetarëve me nevoja të veçanta pa dallime etnike, fetare, gjinore e racore, nga fëmijët e deri tek të moshuarit pa përkujdesje familjare. Gjatë vitit 2015 është përfunduar ndërtimi dhe furnizimi me pajisje i objektit të Qendrës së Arsimit Profesional Gjakovë me kapacitet mbi 2000 m² dhe është financuar nga Buxheti i Kosovës. Ka përfunduar procesi i riakreditimit të 7 Qendrave të tjera të Aftësimin Profesional dhe validimit për 21 kabinete në 7 kualifikime. Janë organizuar kualifikime dhe trajnime për fusha të ndryshme nga të cilat kanë përfituar 94 kandidatë, 60 nga të cilët nga komuniteti boshnjak dhe grupe të marginalizuara. Në qendrat korrektuese në Kosovë janë certifikuar 102 kandidatë. Bazuar në të dhënat nga 8 QAP në periudhën janar-nëntor të këtij viti kanë përfituar nga trajnimet 3466 kandidatë. Kurse, brenda kësaj periudhe janë certifikuar 2994 kandidatë.

Mbi 2,750 familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuar, kanë marrë mbështetje si dhe rreth 708 fëmijë janë mbështetur me pagesë mujore për strehim tek familjarët dhe jashtë familjes. 8 OJQ-ve strehimoreve që ofrojnë shërbime për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe trafikimit, ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për fëmijë, persona me aftësi të kufizuar dhe persona të moshuar janë mbështetur me mbi 350,000.00 euro të shpenzuar për vitin 2015.

Është arritur në fushën e licencimit të ofrueseve të shërbimeve sociale dhe familjare si punëtorëve social dhe OJQ-ve, të cilat ofrojnë shërbime sociale dhe familjare. Gjatë vitit 2015 janë licencuar për 54 punëtorë social të nivelit superior, 37 të nivelit mesëm dhe 230 të nivelit bazik, duke e sjellë numrin e përgjithshëm të personave të licencuar të cilët ofrojnë shërbime nga sektori qeveritar dhe joqeveritar për të tri nivelet në 733 punëtorë social. Gjithashtu, këtë vit u licencuan 14 OJQ. Është vazhduar me ofrimin e trajnimeve profesionale për ngritjen e kapaciteteve të punëtorëve social dhe stafit menaxherial të komunave për zbatimin e standardeve minimale dhe menaxhimin e përgjegjësive të transferuara në fushën e shërbimeve sociale nga niveli qendror tek niveli lokal. 250 punëtorë social të licencuar dhe stafi i komunave të sektori social. Janë ofruar shërbime-përkujdesje për klientët e moshuar pa përkujdesje familjare si dhe për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara mendore në dy institucionet bazë në Shtëpinë e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje familjare në Prishtinë dhe Institutin Special në Shtime ISSH dhe në Shtëpitë e Komunitetit të cilat janë të shtrira në këto komuna; Shtime, Ferizaj, Dardanë, Deçan, Vushtrri, Graçanicë, Skënderaj dhe në Gurakoc-Istog. Ndërsa, numri i përgjithshëm i klientëve në të dy institucionet bazë dhe në shtëpitë e komunitetit është 246. Me mjetet e planifikuar për investime kapitale ka përfunduar ndërtimi i Shtëpisë së komunitetit për persona me aftësi të kufizuar në Lipjan dhe janë kryer renovimet ne objektin e Institutit Special në Shtime dhe Shtëpinë e Personave të Moshuar në Prishtinë².

- o *Avancimi i sistemit pensional dhe sigurimi i të drejtës së pensionit për të gjithë shtetasit kosovar që kanë punuar në shtetet e tjera*

Në konsultim me FMN-në, Qeveria e Republikës së Kosovës ka filluar me zbatimin e Ligjit për Skemat Pensionale, përmes së cilës pritet të ketë 68 milionë €, ngritje të alokimeve për këtë kategori. Janë realizuar 7 skemat ekzistuese të pensioneve në Kosovë (Pensionet bazike, kontributeve, të aftësisë së kufizuar, të pensionistëve "Trepça", atë të ish-pjesëtarëve të TMK-së dhe të FSK-së si dhe skema për kompensimin e personave të verbër)³. Për Pensionet kontributeve për vitin 2016 janë paraparë mjete shtesë në shumën prej: 23.050.000 €. Këto mjete do të shërbejnë për kategorizimin e pensioneve kontributeve dhe për shtimin natyral te përfituesve të pensioneve të kontributeve. Gjatë këtij viti është bërë implementimi i pjesshëm i

²Kostoja e investimeve kapitale ne këto projekte është mbi 250,000.00 euro, të financuara nga buxheti i vitit 2015.

³ Kanë përfituar 131.106 pensionistë. Në skemën e pensioneve kontribut-pagues janë 40.115 pensionistë. Numri i shfrytëzuesve të pensioneve për personat me aftësi të kufizuara është 18.973 persona; Në skemën e pensioneve të parakohshme "Trepça" aktualisht janë 3473 shfrytëzues, shuma e paguar ka qenë 4.025.125 euro. Numri i shfrytëzuesve të ish-pjesëtarëve të TMK-së është 904. Për ish-pjesëtarë të FSK-së janë paguar pensionet për 170 persona. Në skemën e pensioneve për Persona të Verbër aktualisht janë 3283 shfrytëzues.

Ligjit nr.04/L-054 . Deri më 30.11.2015 të drejtën në pensione e kanë realizuar gjithsej 12,929 përfitues⁴.

Qeveria ka filluar programin e mbështetjes për Veteranet e UÇK-së. Me 5 tetor 2015 ka filluar pranimi i aplikacioneve për Veteranët e UÇK-së dhe deri me tani janë pranuar 16,891 aplikacione kurse në pagesë kanë hyrë 9,429 në shumën 3,175,283 €. Janë ndarë mjete në vlerë prej 90,000 €, e specifikuar në atë; 40,000 për shoqatën e Invalidëve të Luftës , 25,000 € Për Organizatën e Veteranëve të Luftës si dhe 25,000 për Shoqatën e Familjeve të Dëshmorëve me qëllim të rehabilitimit të personave në nevojë, ndërsa janë arritur marrëveshje mirëkuptimi me Shoqatën e Familjeve të Dëshmorëve, Shoqatën e Invalidëve dhe Organizatën e Veteranëve të Luftës për financimin e projekteve të tyre të caktuara. Përveç, pensioneve përfituesit e skemës kanë përfituar edhe lirim nga shpenzimet e energjisë elektrike në vlerën 1,698,381.24€ për 11,369 familje për vitin 2014 dhe lirim nga shpenzimet e doganimit të veturave për 341 Invalidë të Luftës.

Gjatë vitit 2015, grupi punues për ripërtëritjen e marrëveshjeve sipas konventave të vazhdueshme ndërkombëtare të sigurimit pensional invalidor, ka zhvilluar negociata të vazhdueshme me qeveritë e Zvicrës, Shqipërisë dhe Maqedonisë me të cilën janë disukutuar çështjet dhe problemet lidhur me zbatimin e Marrëveshjes së nënshkruar në vitin 2013.

- *Promovimi i politikave aktive sociale të ndërmarrësisë më qëllim zvogëlimin e varësisë nga skemat sociale*

Qeveria ka dhënë maksimumin në zbutjen e varfërisë, problemeve sociale dhe papunësisë. Gjatë këtij viti janë ofruar shërbime dhe trajnime për punëkërkuuesit, me qëllim të profilizimit për tregun e punës dhe krijimin e mundësive të reja për punësim. Për më tej janë ndërmjetësuar në programe dhe projekte aktive të tregut të punës⁵: ku kanë përfituar gjithsej: 2960 persona, prej tyre 696 femra. Në Zyrat e Punësimit janë lajmëruar 12, 474 vende të lira pune, të hulumtuara nga këshilltarët e Punësimit si dhe janë informuar dhe këshilluar 756 persona rreth mundësive të migrimin të rregullt jashtë shtetit.

U rrit mbështetja financiare për familjet në nevojë. Në pjesën e dytë të vitit 2015, Qeveria e Republikës së Kosovës planifikoi dhe vendosi ngritjen e shumës së deritashme për përfituesit e Asistencës Sociale për 25% për çdo familje e cila përfiton nga kjo asistencë. Ngritja e Asistencës

⁴ Shuma e mjeteve të shpenzuara për transfere deri ne nëntor 2015 është 34,558,415.62 €

⁵Projektet: „Punë Publike“ (Podujevë); „Punësimi i punëtorëve sezonal në punë publike“ (Prishtinë); „Pastrimi i skajeve të rrugës“, (Novobërdë); “Punësimi sezonal në punë publike”(Istog) “Pyllëzimi vjeshtor; “Punësimi sezonal në punë publike”(Ferizaj); “Punësimi sezonal në punë publike”(Leposaviq) “Punësimi sezonal në punë publike”(Vushtrri); “Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura”“Sanimi i gjendjes së pyjeve nga zjarret, aktivitetet silvikulturore, rrallime”, “Shuarja e zjarreve”; “Kultivimi i Fidanëve në Fidanishten e APK-së”, “Praktika në Punë 1 në Sektorin Publik & Privat”, “Praktika në Punë 2 në Sektorin Publik & Privat”, “Praktikantë në Zyrat e Punësimit”, “Praktikantë në QPS”, “Praktikantë në DILFD”, (Departamenti i Invalidëve të Luftës dhe Familjeve të Dëshmoreve).

Sociale përveç që do të ndikojë në rritjen e mirëqenies për këto familje, i shërben gjithashtu edhe synimit për zvogëlimin e shkallës së varfërisë në Kosovë. Ndhmën sociale e kanë shfrytëzuar 27.280 familje, me 114.020 anëtarë të familjes.

Është punuar në legjislacion, në fushën e luftimit të ekonomisë joformale, në përkujdesjen e qytetarëve me nevoja të veçanta, ndërkohë që janë ofruar shërbime edhe për pensionistët në kuadër të legjislacionit në fuqi. Janë hartuar dhe miratuar në Qeveri, Projektligji⁶ “për Aftësim, Riaftësim Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara”, Projektligjit “për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin” Ligji⁷ “Për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave të dhunës seksuale të luftës, viktimave civile dhe familjarëve të tyre” dhe Ligji Nr. 04/I-261 “Për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”.

o *Fuqizimi i sektorit privat dhe nxitja e investimeve të huaja*

Gjatë vitit 2015 është punuar për krijimin e një ambienti sa më të favorshëm për zhvillimin e biznesit dhe investimeve të huaja në Kosovë. Gjatë këtij viti janë regjistruar 428 biznese me pronarë të huaj, ose 1.5 herë më shumë së vitit 2014, ku ky numër ishte vetëm 278. Sipas të dhënave nga BQK, Investimet e Huaja Direkte në periudhën janar – tetor 2015 janë rreth 270 milionë euro, që paraqet një rritje të konsiderueshme krahasuar me 3 vitet e fundit 2012-2014. Janë ofruar shërbime për 62 kompani të huaja të interesuara rreth potencialeve investuese. 13 kompanive të huaja – investitorëve potencial u është ofruar asistencë direkte duke filluar nga regjistrimi i biznesit si dhe procedurave tjera. Janë zhvilluar negociatat për nënshkrimin e marrëveshjeve për mbrojtje dhe promovim të investimeve me: Slloveninë, Shqipërinë, Kanadanë dhe Bullgarinë.

Me qëllim të gjetjes së tregjeve të reja për kompanitë kosovare, janë përkrahur dhe realizuar pjesëmarrja e ndërmarrjeve të ndryshme nëpër panairë ndërkombëtare. MTI ka mbështetur ekspozimin e kompanive kosovare edhe në panairët vendore (panairët dhe aktivitetet promovuese të organizuara nga Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Bizneseve si dhe panairët në: Londër, Berlin, Koln, Izmir, etj. Janë rifreskuar dhe dërguar broshura dhe materiale promovuese në: Gjermani, Bullgari, Itali, Slloveni, Austri, Zvicër, Emiratet e Bashkuara Arabe, Angli, Holandë dhe Amerikë.

o *Politika tregtare që synojnë rritjen e konkurrueshmërisë dhe integrimin e Kosovës në ekonominë rajonale dhe globale*

Kosova ka bërë progres në drejtim të anëtarësimit në strukturat rajonale dhe globale dhe lidhjes së marrëveshjeve të tregtisë së lirë. Në kuadër të Politikave të Hapjes së Tregut dhe Integrimi në Tregjet Rajonale dhe Globale janë realizuar takime në selinë e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) si dhe janë bërë përgatitje për fillimin e procesit të aplikimit për anëtarësim.

⁶Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-019,

⁷Ligji Nr. 04/I-172 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/I-054.

Është realizuar me pjesëmarrjen në takimet e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC), është arritur të anëtarësohem në komitetin për investime të Evropës Juglindore. Në bashkëpunim me OECD-në dhe Këshillin për Bashkëpunim Rajonal është organizuar një takim me komunitetin e biznesit, shoqërinë civile, mediat dhe institucionet relevante në fillim të vitit 2015. Është bërë përgatitja e pozicioneve të Kosovës në negociata lidhur me anëtarësimin në CEFTA. Gjatë këtij viti kanë përfunduar 5 raunde të negociatave⁸ nga gjithsej 6 raunde. Raundi i gjashtë i negociatave pritet të përfundoj në Mars 2016 ku do të negociohen shërbimet financiare, transportit dhe audiovizuale.

Ratifikimi dhe Marrëveshja për Tregti të Lirë me Turqinë pritet të bëhet nga Parlamenti i Kosovës. Kurse në raportet tregtare me Shqipërinë janë marrë masa për adresimin e disa barrierave tregtare nëpërmjet intesifikimit të takimeve me krerët më të lartë të shtetit dhe ministrat relevantë të Qeverisë së Shqipërisë.

Zgjidhja e Barrierave Tregtare me Shqipërinë

*U është dhënë zgjidhje një sërë rastesh të barrierave të ndryshme tregtare më të cilat bizneset kosovare ballafaqoheshin, të tilla si: (i) **Panundësia për të eksportuar vezë në tregun e Shqipërisë** – Kjo çështje tanimë është zgjidhur dhe mbeten të shihen rezultatet e para të eksportit; (ii) **Panundësia për të eksportuar produktet farmaceutike për shkak të mos regjistrimit të produkteve në Agjencinë e barnave të Shqipërisë** – Kuvendi i Shqipërisë tanimë ka amendamentuar Ligjin për produkte farmaceutike i cili ishte paraqitur si barrierë kryesore më parë dhe kjo do t'i mundësoj kompanive kosovare të regjistrojnë produktet farmaceutike në Agjencinë e barnave në Shqipëri dhe për t'i eksportuar dhe pasur qasje të plotë në tregun shqiptar; (iii) **Aplikimi i çmimeve referente ndaj disa produkteve kosovare** - Shqipëria ka siguruar se do të eliminoj aplikimin e një barrierë të tillë dhe nuk kemi indikacione se janë aplikuar përsëri ato; (iv) **Çështja e tahografëve e cila ishte një barrierë a kalërsime për transportuesit kosovarë** -le dy vendet kanë rënë dakord për tekstin e marrëveshjes dhe vetëm pritet nënshkrimi i saj, e cila do të eliminoj plotësisht këtë barrierë për transportuesit kosovarë.*

- **Përmirësimi i ambientit të bërit biznes dhe kushteve për rritjen e investimeve të huaja dhe të brendshme**

Me qëllim të arritjes së një niveli të standardit Evropian të të bërit biznes, Qeveria ka ndërmarrë hapa konkrete që synojnë përmirësimin e kushteve të të bërit biznes. Në vitin 2015 është shënuar progres në aspektin e lehtësimit të procedurave të të bërit biznes dhe është rritur përqindja e regjistrimit të bizneseve. Krijimi dhe zbatimi i politikave që kanë për qëllim thjeshtësimin e kërkesave rregullative, uljen e diskrecionit dhe rritjen e përgjithshme të efikasitetit të kornizës ligjore dhe rregullative. Disa nga lehtësirat e krijuara lidhen me procedurat doganore nëpërmjet ndryshimit të udhëzimeve administrative si dhe infrastrukturës

⁸ Në raundin e parë dhe të dytë janë negociuar shërbimet e biznesit dhe profesionale; në raundin e tretë shërbimet e turizmit, mjedisit dhe rekreative; në raundin e katërt shërbimet e komunikimit dhe ndërtimit; në raundin e pestë shërbimet e distribuimit, arsimit dhe shëndetësore.

aktuale në drejtim të shpenzimeve të transportit, tatimit të akcizës në Lojërat e fatit, tatimit të akcizës në derivatet e naftës-gazit natyror, në cigare etj.

Është punuar në krijimin e ambientit më të volitshëm për zhvillim ekonomik, tërheqje të investimeve të huaja direkte, shfrytëzim të resurseve natyrore dhe kapitalit njerëzor. Jemi në proces të ndërmarrjes së hapave të orientuar drejt liberalizimit të vazhdueshëm ekonomik.

Është realizuar funksionalizimi i Zonave të Lira Ekonomike me qëllim krijimin e lehtësirave fizike për bizneset vendase dhe të huaja. Është bërë finalizimi i punëve rreth Parkut të Biznesit në Drenas dhe kanë vazhduar investimet në Inkubatorin e biznesit në Parkun e Biznesit në Drenas, në Zonën Ekonomike në Mitrovicë, Zonën ekonomike - Shtime, Zonën ekonomike - Suharekë, Zonën Agro Industriale në Samadraxhë dhe Inkubatorin e Biznesit në Komunën e Istogut.

Në kuadër të politikës tregtare, është punuar në eliminimin e barrierave tregtare. Po rishikohet Ligji për shërbimet i cili pritet të finalizohet gjatë vitit 2016. Gjithashtu, është realizuar ueb-platforma elektronike "Raporto Barrierat" e cila është funksionale. Platforma elektronike, tashmë ua mundëson bizneseve kosovare të kenë shumë më të lehtë adresimin e barrierave tregtare gjatë eksportit, importit apo kalimit tranzit të mallrave të tyre. Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve, ka bërë zvogëlimin dhe eliminimin e shumicës së taksave dhe pagesave për shërbimet e ofruara nga ky institucion shtetëror.

Është punuar rreth funksionalizimit të plotë të sistemit të integruar për regjistrimin e Bizneseve. Janë ofruar zgjidhje me qëllim të vazhdimin dhe përmirësimit të mëtutjeshëm të shërbimit të regjistrimit, dhe pajisjen e Bizneseve me numra fiskal dhe certifikatë të TVSII-ës dhe numrit të Export- Importit. Ndërkohë, gjatë këtij vitit është bërë rishikimi dhe analiza e sistemit aktual të sistemit të regjistrimit me qëllim të unifikimit të numrit të regjistrimit në një ID të vetme.

o *Spektori i energjisë në Kosovë*

Qeveria e Republikës së Kosovës ka arritur të realizoj marrëveshjen për ndërtimin e termocentralit Kosova e Re. Pas një angazhimi të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe Kompaninë Contour Global, u arrit marrëveshja rreth pikave që ishin subjekt i negociatave. Është bërë edhe formalizimi i procedurave që mundësuan nënshkrimin e marrëveshjes me Kompaninë Contour Global për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese - TC Kosova e Re. Me qëllim të parandalimit të shtrenjtimit të energjisë elektrike dhe sigurimit të furnizimit të qëndrueshëm energjetik, hapa të cilët shpijnë edhe në drejtim të zhvillimit ekonomik, Qeveria e Republikës së Kosovës ka ri-dizajnuar Projektin Kosova e Re.

Gjatë këtij viti është punuar në zbatimin e projektit kapital të Kosovës - Autostrada e Energjisë Kosovë-Shqipëri, që vlerësohet të jetë projekt strategjik. Ky projekt pritet të inaugurohet më 2016 dhe konsiston në ndërtimin e një linje të tensionit të lartë 400 kV me

gjatësi rreth 238 km, prej së cilës 85.5 km në territorin e Kosovës dhe 153.5 km në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky projekt është në fazën e finalizimit.

Vazhdojnë investimet dhe masat në fushën e Eficencës së Energjisë. Qeveria firmosi marrëveshjen e financimit me Bankën Botërore në formë të huamarrjes – për një shumë investuese prej 31\$Mln Euro. Janë përgatitur dizajnet për 5 ndërtesat e para për zbatim të masave të EE dhe në vitet që vijnë ky investim do të shtrihet më gjerë.

Në kuadër të Projektit Zbatimi i Masave të Efiçencës së Energjisë në ndërtesat e shërbimit publik, është hartuar plani i Auditimit Energjetik (2015-2017) i cili ka përcaktuar edhe masat e mëtejshme për sigurimin e eficientësisë së energjisë në godinat publike. Në vitin 2016 nga investimet kanë përfituar 5 shkolla dhe në dy vitet e ardhshme pritet të përfitojnë edhe një numër i konsiderueshëm i shkollave të Kosovës.

- *Zhvillimi i infrastrukturës së Transportit*

- **Përmirësimi i Infrastrukturës rrugore**

Gjatë këtij viti ka vazhduar puna për modernizimin dhe zhvillimin e infrastrukturës rrugore kombëtare dhe lokale në Kosovë, si dhe lidhjen me rrjetet regjionale. Është duke u zbatuar Projekti i ndërtimit të Autostradës Prishtinë – Hani i Elezit. Më zhvillimin e infrastrukturës Kosova kontribuon krijon parakushte për zhvillim infrastrukturor dhe ekonomik të vendit, si dhe hapje të mundësive të reja të bashkëpunimit mes Kosovës dhe vendeve në rajon. Ndërtimi i Autostradës Prishtinë - Hani i Elezit ka vazhduar të zbatohet normalisht duke arritur një nivel të përgjithshëm në masën 27%. Kanë përfunduar punimet në nënsegmentin C1 nga Kyqja R6/R7 – lidhja me rrugën nacionale N2 (Udhëkryqi i Gjilanit), me gjatësi të përgjithshme prej 5.0 km, dhe rrugët për kyçe dhe shkyçëse të nyjës kryesore të Autostradave R6/R7, me gjatësi prej 5.5 km, dhe po vazhdohet më segmentet e tjera.

Në bashkëpunim me BERZH-in dhe WBIF, ka filluar Plotësimi i Studimit të Fizibilitetit dhe Ndikimit Mjedisor për segmentin Besi - Merdare të korridorit të Autostradës R7 Durrës-Prishtinë – Nish, është filluar me hartimin e projektit të zgjerimit të rrugës Besi-Podujevë (rruga ekzistuese) N25 si dhe po përfundon studimit të fizibilitetit dhe ndikimit mjedisor për segmentin Kijevë – Zahaq (30 km).

Për zgjerimin e rrugës nacionale N2 Prishtinë-Mitrovicë, do të jetë në dispozicion kredia nga Banka Islamike për Zhvillim, Fondi Saudit për Zhvillim dhe OFID-i.

Gjatë vitit 2015 kanë qenë 64 projekte kapitale me anë të së cilave janë asfaltuar 35.55 km rrugë nacionale dhe 21.50 km rrugë rajonale, dhe në bashkëfinancim me komuna janë asfaltuar 81.2 km rrugë lokale. Në vazhdimësi janë duke u ekzekutuar projektet në rehabilitimin dhe ndërtimin e urave, si: a) Zgjerimi i Rrugës Nacionale N 9 Prishtinë - Pejë, segmenti Arllat – Kijevë me gjatësi L= 8.7 km dhe plotësimi i projektit zbatues për segmentin: Pejë- Zahaq, L = 6.6 km; b) Zgjerimi i rrugës Nacionale N 2 Prishtinë - Mitrovicë, segmenti Milloshevë - Lumi i

Madh, L+7.2 km është realizuar; c) Rishtrësimi i rrugës Nacionale N2, segmenti QMI-Hani i Elezit në gjatësi prej 29.07 km; Rikonstruimi i rrugës Nacionale Ferizaj –Kllokot në gjatësi prej 13 km; d) Zgjerimi i rrugës R102 Komoran-Drenas-Skënderaj, L= 13 km; Rikonstruimi i rrugës rajonale Gërlit-Kllokot në gjatësi prej 16 km; e) Rehabilitimi i rrugës N25.3 Shtime – Ferizaj, 10.3km.

- **Përmirësimi i Infrastrukturës hekurudhore**

Investimi në infrastrukturën hekurudhore është me rëndësi të madhe strategjike dhe pritet që do të ndikoj në zhvillimin socio-ekonomik të vendit. Linja Hekurudhore 10 - Projekti për Rehabilitimin e Linjës 10 hekurudhore, që përshkon shtatë shtete, përfshirë Kosovën, është projekt i parë nga Lista prioritare e projekteve infrastrukturore të Kosovës, i cili do të nis zbatimin. Ky projekt që rrjedh nga Agjenda e Berlinit, përkatësisht nga takimi i shteteve të Ballkanit Perëndimor i udhëhequr prej Kancelares Merkel që u mbajt vitin që shkoi në Berlin, do të kushtojë mbi 160 milion euro vetëm për linjën që kalon nëpërmjet Kosovës. Garantët e para për zbatim të këtij projekti gjigant Kosova tashmë i ka përfituar nga BE-ja, më marrëveshjet e firmosura me EBRD-në në vlerë 39.9 milionë euro dhe EIB-në në vlerë prej 42 milionë eurove, ndërkaq punimet lidhur me këtë linjë që fillon nga Selaniku për të përfunduar në Salzburg, pritet të nisnin në vitin që po vjen. Linja 10 pritet të krijojë vende të reja të punës si dhe t'i kontribuojë avancimit të bashkëpunimit ndër-fqinjësor. Ajo është pjesë e rrjetit kyç hekurudhor të Ballkanit Perëndimor dhe Rrjetit Trans-Evropian të Transportit.

Me qëllim ardhjes në ndihmë të grupeve të varfëra të popullsisë, është lidhë kontrata për transportin humanitar me autobus në linja të ndryshme brenda vendit dukë siguruar transportin nëpërmjet tetë linjave të transportit.

Janë iniciuar nëntë marrëveshje bashkëpunimi me vendet e BE-së në fushën e transportit dhe katër marrëveshje janë miratuar nga Qeveria e Kosovës të cilat pritet të miratohen nga vendet përkatëse.

- **Rritja e operimeve në transportin Ajror**

U krijuan mundësitë për rritjen e fluksit të transportit ajror duke ndjekur politika të alternuara sezonale. Në sezonin veror janë bërë 12 aprovime për fluturime të programuara për Avio Kompanitë Ajrore nga Turqia dhe Zvicra, dhe 8 aprovime për sezonin dimëror. U liçensuan 5 Avio Kompani Ajrore të cilat kanë hyrë në tregun e Kosovës për herë të parë, dhe gjithashtu të drejta të trafikut i janë mundësuar të zhvillojnë edhe 16 Avio Kompanive të BE-së dhe 174 fluturime të miratuara të lëshuar për Avio Kompanitë Ajrore si fluturimeve charter.

- **Përmirësimi i vazhdueshëm i politikave në sektorin e ujërave**

Qeveria e Republikës së Kosovës, me vendime të veçanta ka aprovuar caktimin e zonave të mbrojtura sanitare dhe masat e tyre mbrojtëse sipas kriterëve të përcaktuara për burimet ujore që përdoren për pije, të cilat gjenden në Komunën e Suharekës. Po ashtu, u mor vendim për caktimin e zonave të mbrojtura sanitare dhe masat e tyre mbrojtëse sipas kriterëve të përcaktuara për burimet ujore që përdoren për pije "Puset të ish-Fabrika e Letrës", në Komunën

e Lipjanit. Qëllimi i këtyre vendimeve është mbrojtja e burimeve ujore dhe nëntokësore nga ndikimet negative, të cilat mund ta dëmtojnë gjendjen normale dhe të qëndrueshme të ujit nga aspekti i cilësisë dhe sasisë. Janë shënuar rezultate në përmirësimin e rrjetit hidrometrik të ujërave sipërfaqësor përmes të cilit bëhet monitorimi i sasisë dhe nivelit të ujit. Gjithashtu, gjatë vitit 2016 është bërë instalimi i 25 shimatësve manual për matjen e reshjeve.

o *Mbrojtja e mjedisit dhe kontrolli i territorit*

Qeveria i ka kushtuar kujdes të veçantë mbrojtjes së shëndetit të popullatës, jo vetëm nëpërmjet masave në sektorin e shëndetësisë por dhe masave për mbrojtjen e mjedisit. Në vitin 2016 u realizua vlerësimi i ndotjes së tokës bujqësore, në kuadër të projektit "Hulumtim për ndotjen e tokave bujqësore në Kosovë" në 17 komuna të Kosovës, për një sipërfaqe prej 214,749 ha. Nga ky hulumtim rezulton se tokat bujqësore në Kosovë nuk janë të kontaminuara.

Ka përfunduar Master Plani për menaxhimin e Mbeturinave i cili synon përcaktimin e masave dhe investimeve nga komunat për menaxhimin sa më të mirë të mbeturinave dhe riciklimin e tyre. Gjatë këtij viti Qeveria punoi në mënyrë intensive për përgatitjen e projekteve infrastrukturore për fushën e Mjedisit. Projektet janë të rëndësishme së madhe strategjike dhe realizimi i tyre do të ketë ndikim në zhvillim ekonomik të vendit, mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik të qytetarëve. Kostoja totale e saj është përafërsisht 526,771,389.00 milion Euro.

U ndërmorën masa për ndalimin e veprimeve ilegale të funksionimit të furrave të gëlqeres në komunat Lipjan, Shtime dhe Malishevë, duke siguruar përmirësimin e cilësisë së ajrit në këto dy komuna. Janë forcuar masat në drejtim të ndalimit të ndërhyrjeve në zonat e veçanta të mbrojtura të natyrës duke rritur inspektimet e ndërprerë të gjitha aktivitetet dhe ndërtimet e paligjshme në zona si: në Manastirin e Deçanit, në zonën e Ujëvarës së Mirushës dhe ndërtimeve të realizuara brenda kufijve të Qendrës Historike të Prizrenit.

Është krijuar Regjistri Kombëtar i ndërtimeve pa leje i cili që nga muaji Shtator është on-line. Aktualisht janë regjistruar mbi 352.836 mijë ndërtime pa leje. Njëkohësisht ka filluar edhe procesi i legalizimit të ndërtimeve pa leje.

Qeveria po ndërmerr masa të forta ligjore që synojnë mirë-menaxhimin dhe mbrojtjen e pyjeve. Ligji i ri për Pyjet i cili është gati për miratim në Qeveri do të mundësojë një menaxhim efikas dhe do të sigurojë masa të mëdha ndëshkuese për prerësit ilegal. Gjithsesi, edhe këtë vit, mbrojtja ka avancuar dhe ka rënë prerja ilegale, por ajo ende mbetet një sfidë. Janë përgatitur dhjetëra dosje për në organet e hetuesisë për shkelësit e ligjit. Ka vazhduar implementimi i programeve për ripyllëzim dhe këtë vit janë ripyllëzuar 400 hektar me pyje, një program i cili u zbatua si një program social punësimi pasi u realizua nga angazhimi i rreth 1000 punëkërkuesve.

Në kuadër të masave të ndërmarra për ruajtjen e tokës bujqësore, nga ndërtimet e paplanifikuara urbane, ka vazhduar zbatimimi i projektit të komasacionit të papërfunduar të tokës dhe implementimi i projektit për rregullim të tokës në baza vullnetare në 21 Zona kadastrale.

o *Zhvillimi i Bujqësisë*

Një ndër prioritetet kryesore të Qeverisë së Republikës së Kosovës vazhdon të mbetet zhvillimi i Bujqësisë. Kjo fushë ka potencial të madh për të tërhequr investitor dhe për të gjeneruar vende të reja të punës, duke ndikuar kështu në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit. Duke pasur parasysh rëndësinë e Bujqësisë, Qeveria e ka vendosur këtë sektor si sektorët me prioritet, diçka që është reflektuar edhe dyfishimin e ndarjeve buxhetore në Bujqësi për vitin 2015. Kjo mbështetje ka mundësuar rritjen dhe zgjerimin e përkrahjes për fermerët në skemën e subvencioneve dhe granteve. 43 milionë euro në vitin 2015 janë ndarë në dy skema mbështetëse, në pagesa direkte 23 milionë dhe 20 milionë në grante investive. Si rezultat i veprimeve të ndërmarra nga ana e Qeverisë, në vazhdimësi është shtuar sipërfaqja e tokës bujqësore së kultivuar me kultura të ndryshme dhe janë shtuar dukshëm rendimentet e këtyre kulturave. Skema e granteve investive është një nga politikat zhvillimore që ka avancuar e siguruar qëndrueshmëri për agrobiznesin, duke mbështetur rreth 390 ferma dhe agrobiznese në shumë sektorë, dhe të orientuar në prodhim, përpunim, diversifikim dhe ujitje. Ky investim ka gjeneruar 2500 vende të reja pune të sigurta në sektorin e bujqësisë, dhe të cilët do të jenë edhe të regjistruar si të punësuar. Nga skema e Pagesave Direkte janë mbështetur 36,786 fermerë.

Ka vazhduar avancimi i shërbimeve këshillimore në bujqësi, si një nga elementet kyçe për zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e sektorit. Për herë të parë është hapur ueb faqja publike për shërbime këshillimore, www.keshillabujqesore.com.

Qeveria ka marrë masa në drejtim të eliminimit të barrierave në drejtim të shkëmbimeve tregtarë të produkteve bujqësore mes Kosovës dhe Shqipërisë. U miratuar certifikata fitosanitare për importin e vezëve dhe tashmë eksporti i tyre për në Shqipëri nuk has më pengesa. U hoq çmimi referent dhe limiti i sasisë së eksportit të rrushit për në Shqipëri. Gjithashtu, po finalizohet unifikimi i standardëve të miellit, të cilat priten të realizohen në vitin e ardhshëm.

Nënshkrimi i MSA-së i ofron prodhuesve të vendit qasje në një treg prej 500 milionë konsumatorëve dhe pritet t'i kontribuojë zhvillimeve më dinamike në fushën e Bujqësisë.

Prioriteti i II-të: Qeverisja e mirë dhe fuqizimi i sundimit të ligjit

Qeveria e Republikës së Kosovës ka shënuar progres në kuadër të arritjes së prioritetit strategjik lidhur me qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit. Deri me tani janë miratuar 80 projektligje, të cilat janë proceduar në Kuvend.

Miratimi i këtyre akteve ligjore ka rëndësi parësore për zhvillimin ekonomik, proceset integruese evropiane, arsimin, sigurinë, luftën kundër korrupsionit dhe avancimin e shumë proceseve të tjera të rëndësishme për të ardhmen e vendit.

o *Avancimi Strategjik i Sektorit të Drejtësisë*

Në proces të realizimit të reformave në fushën e sundimit të rendit dhe ligjit dhe duke i çuar përpara proceset e normalizimit të marrëdhënieve me fqinjët, luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Qeveria e Republikës së Kosovës po ashtu ka krijuar parakushte të nevojshme për zhvillim ekonomik dhe konsolidim demokratik, si dhe ka fuqizuar Agjendën e Integritimit Evropian të Kosovës.

Reforma në drejtim të avancimit të kornizës ligjore në drejtësi ka vazhduar edhe gjatë vitit 2015, me 19 projektligje të hartuara (9 prej tyre janë miratuar dhe kanë hyrë në fuqi, ndërsa 8 prej tyre janë proceduar për në Qeveri dhe Kuvend). Gjithashtu, ka hartuar 6 koncept dokumente 5 nga këto janë miratuar, tetë akte nënligjore të cilat tanimë janë në fuqi. Gjithashtu, po hartohet korniza strategjike me tri dokumente strategjike të hartuara: "Strategjia Kombëtare për të Drejtat Pronësore", "Strategjia në fushën e Ekzekutimit të Sanksioneve Penale" dhe Programi i Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe është lansuar "Strategjia për Asistencë në Sektorin e Sundimit të Ligjit në Kosovë", ndërsa në bashkëpunim me Komisionin Evropian është duke u hartuar Kodit Civil i Republikës së Kosovës.

Gjatë vitit 2015 është përmirësuar më tej infrastruktura fizike e sektorit të drejtësisë. Ka përfunduar objekti i Prokurorisë Themelore në Pejë dhe në Gjilan. Në këto objekte përveç Prokurorisë Themelore, janë vendosur edhe Drejtoritë regjionale të Shërbimit Sprovues.

Është bërë funksional sistemi i Përmbartimit Privat. Kanë filluar punë për herë të parë 25 Përmbartues Privat si dhe është themeluar Oda e Përmbartuesve Privat në Republikën e Kosovës. Gjithashtu, janë licencuar 11 administratorë falimentues. Kjo ka sjellë rritjen e numrit të rasteve të zgjidhura përmes procedurës së ndërmjetësimit.

Në fushën e drejtësisë penale është arritur progres në lidhjen e marrëveshjeve bilaterale me vendet e tjera. Janë nënshkruar gjatë këtij viti: Marrëveshja me Hungarinë për Ndihmë të ndërsjellë në çështjet penale dhe Marrëveshja me Gjermaninë për Ndihmë Gjyqësore në çështjet penale, si dhe ka vazhduar negociimi i marrëveshjes me Malin e Zi e cila pritet së shpejti të nënshkruhet.

o *Luftimi i korrupsionit*

Një ndër prioritetet kryesore të Qeverisë së Republikës së Kosovës është edhe luftimi i korrupsionit, i cili dëmton ekonominë, konsolidimin demokratik dhe imazhin e vendit. Me qëllim të rritjes së transparencës dhe vendosjes së mekanizmave kontrollues, Qeveria ka ndryshuar Ligjin për Prokurimin Publik. Ky projektion është vendosur me qëllim të rritjes së efikasitetit të shpenzimeve publike dhe në kuadër të këtij ligji do të aplikohet edhe prokurimi elektronik, me këtë do të bëhet zvogëlimi i shpenzimeve administrative deri në 20 % dhe rritja e transparencës dhe llogaridhënies.

o *Luftimi dhe parandalimi i terrorizmit*

Kërcënimi nga radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm nuk është një fenomen i ri në botë. Përdorimi i dhunës politike dhe shkatërrimit për të frikësuar dhe dobësuar shtetet dhe popujt ka qenë i pranishëm përgjatë shekujve, kudo dhe kurdo që një grup politik ose fetar kërkon të destabilizojë dhe dobësojë kufijtë, qeveritë dhe shoqëritë duke dëmtuar civilët dhe shoqëritë përmes akteve të terrorit.

Qeveria ka rishikuar kuadrin strategjik dhe e ka avancuar atë më tej me qëllim hartimin e programeve strategjike dhe institucionale në luftën kundër terrorizmit. Ngjarjet që kanë ndodhur në vitet e fundit në Kosovë, Evropë, Lindjen e Mesme dhe më gjerë e kanë bërë të qartë nevojën dhe interesin e Republikës së Kosovës që të hartoj një Strategji përmes të cilës do të koordinohen masat në forcimin e qëndrueshmërisë së shtetit dhe shoqërisë ndaj kërcënimeve që vijnë nga radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm. Në këtë mënyrë, Qeveria e Republikës së Kosovës së bashku me Qeveritë e vendeve partnere dhe mike do të vazhdojë luftën kundër këtij kërcënimi të përbashkët. Në këtë drejtim, Qeveria e Republikës së Kosovës ka hartuar "Strategjinë për Parandalimin e Ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që shpie në terrorizëm 2015-2020". Gjithashtu, janë hartuar Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit me Narkotikë dhe "Strategjia e re për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore 2015-2019" dhe "Strategjia për Sigurinë Kibernetike 2015-2018".

Në fushën e Krimeve të rënda, korrupsionit, krimit të organizuar dhe terrorizmit gjatë kësaj periudhe janë shkatërruar 20 grupe kriminale si dhe ka pasur ngritje të efikasitetit në sekuestrim dhe konfiskim të aseteve të cilat janë përfituar me vepër penale. Vlera e pasurive në administrim nga Agjencia e Administrimit të Pasurisë së Sekusetruar dhe Konfiskuar është 2,584,630.23€.

Qeveria e Republikës së Kosovës e konsideron si një hap të rëndësishëm për të ndërtuar një shtet dhe shoqëri të fortë dhe të qëndrueshme për të luftuar këtë dukuri globale dhe për të siguruar që kjo dukuri nuk ka vend në Kosovë. Për të arritur këto synime ne do të qëndrojmë dhe punojmë së bashku ndaj këtij kërcënimi me partnerët tanë në rajon dhe më gjerë. SHBA-të kanë vlerësuar lartë përkushtimin e Kosovës në luftimin e radikalizmit. Gjatë këtij viti janë shënuar arritje si në zhvillimin e operacioneve të përbashkëta me shtetet fqinje dhe të BE-së, dhe në lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit. Janë nënshkruar tri marrëveshje ndërkombëtare

në fushën e bashkëpunimit policor me Shqipërinë, Slloveninë dhe Mbretërinë e Bashkuar e Irlandën Veriore.

○ *Integrimi i plotë i të gjitha komunave në sistemin e drejtësisë*

Qeveria e Republikës së Kosovës ka treguar përkushtim të veçantë në rregullimin dhe unifikimin e drejtësisë civile, në integrimin e plotë të komunave veriore në sistemin e drejtësisë. Janë nënshkruar 39 Marrëveshje për projektet e investimeve kapitale nga MAPL në vlerë prej 1 milion euro për 4 komunat (Mitrovicë Veriore, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq) si dhe janë nënshkruar 89 marrëveshje për projektet e investimeve kapitale nga 7 Ministrinë e linjës në vlerë prej 14.5 milion euro për 4 komunat (Mitrovicë Veriore, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq).

○ *Avancimi i Reformës së Administratës Publike në përputhje me objektivat që derivojnë në kuadër të Integrimit Evropian*

Gjatë vitit 2015 ka qenë e përkushtuar në kompletimin e kornizës strategjike për Reformën e Administratës Publike, si dhe kompletimin e kornizës ligjore në fushën e administratës publike. Rëndësi e veçantë i është kushtuar klasifikimit dhe gradimit të pozitave të nëpunësve civilë në pajtim me katalogun e pozitave të nëpunësve civilë, sistemit të ri të pagave; si dhe Sistemit të Informatave për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore. U miratua korniza Strategjike e Reformës së Administratës Publike 2015-2020 dhe vendimi për organizimin dhe funksionimin e strukturave për zbatimin e dokumenteve strategjike të reformës në administratën publike. U themelua Këshilli i Ministrave për Reformën e Administratës Publike (KMRAP), i cili është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më Vendim nr. 05/09 të dt. 21 janar 2015.

Në funksion të zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil dhe përmirësimin të menaxhimit të burimeve njerëzore në shërbimin civil, filloi hartimi i Strategjisë së e Trajnimit për nëpunësit Civilë 2016-2020; Projekt i Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë së Trajnimit të Nëpunësve Civilë 2016-2018” si dhe Metodologjia për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. U miratua Katalogu i vendeve të punës në SHCK si dhe Udhëzuesi për aplikimin e Rregullores për Planifikim të Personelit.

Ka avancuar puna për krijimin e Sistemit të Informatave për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore i cili mundëson menaxhimin e të gjitha proceseve të punës dhe ndërlidhjes me sistemin e pagesave dhe sistemin e thesarit dhe zbatimi i SMIBNJ-së në institucione (procesi rekrutimit) dhe vendosja e të dhënave fizike të personelit.

Gjithashtu, gjatë vitit 2015 ka vazhduar reforma ligjore me qëllim përmirësimin e legjislacionit në fushën e Administratës Publike. Ndër projektligjet më kryesore në fushën e administratës publike të hartuara këtë vit kanë qenë; Projektligji për procedurat e përgjithshme

administrative, Projektligji për festat zyrtare⁹, Projektligji i pagave që paguhen nga Buxheti i Kosovës¹⁰ është finalizuar nga MAP, Projektligji për Shërbimin Civil¹¹ të Republikës së Kosovës.

Instituti i Kosovës për Administratë Publike, gjatë vitit 2015 ka trajnuar 2068 nëpunës civil nëpërmjet 88 moduleve të trajnimit në gjithsej, janë realizuar 272 ditë trajnim. Nëpunësit e trajnuar ishin nga niveli qendror dhe lokal i administratës publike. Në trajnime kanë marrë pjesë nëpunës nga niveli drejtues i lartë, drejtues, profesional dhe administrativ me një përfaqësim të gjerë përfshirë të gjitha ministritë, agjencionet dhe komunat. Struktura gjinore e pjesëmarrësve në trajnim përbëhet nga 43.25% gjinia femërore, 56.75% gjinia mashkullore, 2.41% ishin nga minoritetet që flasin gjuhën serbe.

- *Përmirësimi i kuadrit të planifikimit strategjik dhe institucional për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave civile, politike, ekonomike dhe sociale të të gjithë qytetarëve të Kosovës*

Qeveria e Republikës së Kosovës është duke fuqizuar kornizën institucionale dhe të politikave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe promovimin e barazisë gjinore, garantimin e lirisë së shprehjes dhe lirisë së mediave dhe rritjes së partneritetit me Shoqërinë civile. Është bërë koordinimi i punës së Këshillit për zbatimin e Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile si dhe janë aprovuar Plani i Punës për vitin 2015 për Këshillin si dhe Ndërtimi i Sistemit të Monitorimit të zbatimit të Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile. Është përcaktuar Modeli për Skemën Nacionale të Granteve për Shoqëri Civile (SNG) (Fondi Kombëtar për zhvillimin e shoqërisë civile), është finalizuar.

Qeverisë ka koordinuar dhe ka siguruar mbarëvajtjen e procesit të zbatimit të projektit të binjakëzimit të Bashkimit Evropian kundër Homofobisë dhe transfobisë. Në kuadër të projektit të binjakëzimit është bërë certifikimi i 17 zyrtarëve nga institucionet si: policia, gjyqësori dhe prokuroria për trajner të barazisë. Po ashtu, është shënuar 17 Maji Dita ndërkombëtare kundër Homofobisë dhe Transfobisë me një pjesëmarrje të lartë të strukturave vendimmarrëse; Është hartuar Udhëzuesi për zbatimin e Rregullores nr. 15/2014 për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave në Republikën e Kosovës; Ligji për Paraplegji dhe Tetraplegji në parim është aprovuar nga Kuvendi i Kosovës. Është hartuar draft Strategjia dhe plani i Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Shoqërinë Kosovare (2016-2020). Është themeluar Grupi Punues për koordinimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.; është hartuar plani për zbatimin e rekomandimeve të Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.

Po punohet në drejtim të hartimit të strategjisë për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave gjuhësore. Gjatë periudhës shkurt-mars është publikuar Raporti gjithëpërfshirës: "Monitorimi

⁹Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-064,

¹⁰ Që përfshinë; Projektligjin për pagat e funksionarëve publik, Projektligjin për pagat e nëpunësve publik dhe Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-147 për pagat e nëpunësve civilë),

¹¹ Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-149.

dhe vlerësimi i të drejtave gjuhësore në Kosovë. Ka përfunduar programi i kurseve në dymbëdhjetë (12) komuna të Republikës së Kosovës organizuar nga ECMI, janë certifikuar 185 shërbyes komunal, ku 68 për nivel të avancuar të njohjes së gjuhës, 33 për gjuhën shqipe dhe 35 për gjuhën serbe, 68 për nivelin fillestarë të njohjes së gjuhës, 46 për gjuhën shqipe dhe 22 për gjuhën serbe, ndërsa 49 prej tyre janë certifikuar për pjesëmarrje, 31 për gjuhën shqipe dhe 18 për gjuhën serbe. Qeveria me 24 shtator është shënuar Dita Evropiane e Gjuhëve dhe është transmetuar Radio fushata e mbështetur nga OSBE-ja "Gjuha juaj e drejta juaj" në gjuhën shqipe, serbe, dhe turke.

- *Rritja e transparencës, pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje si dhe avancimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile*

Në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve institucionale të komunave dhe transparencës komunale është organizuar fushata mediale për të drejtën e qytetarëve në informacion dhe zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike. Me qëllim të mbështetjes së kapaciteteve të zyrtarëve komunal në fusha të ndryshme të vetëqeverisjes lokale janë hartuar dokumentet udhëzuese të ndryshme.

Është avancuar programi elektronik për sistemin e menaxhimit të performancës së shërbimeve komunale (CSC/CSM) dhe është bërë mbledhja e të dhënave nga komunat për treguesit matës të shërbimeve, zhvillimi i fushave dhe i treguesve për matjen e performancës së komunave, trajnimi i koordinatorëve të performancës komunale, Mozaiku 2015 - anketimi i qytetarëve për nivelin e kënaqshmërisë së ofrimit të shërbimeve dhe vlerësimi i tregueseve të SMP-së.

Për avancimi i vetëqeverisjes lokale në përputhje me kërkesat e Agjendës Evropiane në ueb aplikacionin e MAPL-së është publikuar linku me informatat e nevojshme për procesin e integriteteve evropiane, janë miratuar 3 programe të bashkëpunimit ndërkufitar për periudhën 2014-2020 me tre shtetet fqinje Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi, si dhe finalizimi i marrëveshjeve të partneritetit dhe kontratave për zbatimin e këtyre programeve, Janë hartuar 38 plane individuale për secilën komunë lidhur me obligimet që dalin nga agjenda evropiane si dhe është përgatitur analiza për përmbushjen e obligimeve të komunave nga agjenda evropiane.

Prioriteti i III-të: Agjenda Evropiane dhe politika e jashtme

Kosova deri me sot është njohur nga 111 vende të botës, përfshirë edhe vendet lidere të botës. Kosova sot është anëtare e institucioneve më të rëndësishme financiare ndërkombëtare.

Janë lidhur marrëdhënie diplomatike me këto shtete: Sierra Leone, Ishujt Komorre, Somalia, Ishujt Cook, Niue, ndërsa janë iniciuar edhe 32 marrëveshje për marrëdhënie diplomatike. Ky vit ka qenë i suksesshëm edhe sa i përket rritjes së numrit të marrëveshjeve bilaterale, duke shënuar 40 marrëveshje të reja. Shërbimi diplomatik dhe konsullor gjatë vitit 2015, është zgjeruar edhe në Otava të Kanadasë, janë bërë përgatitjet për hapjen e Konsullatës në Ioëa të ShBA-së.

o *Integrimi Evropian*

Për Kosovën është shënuar një arritje e madhe me nënshkrimin e Marrëveshjes për Stabilizim Asociimit me Bashkimin Evropian si dhe iniciimin e zbatimit të kësaj marrëveshje e që do të rezultojë edhe me mbështetjen e Bashkimit Evropian për reformat në shumë sektorë e në veçanti në atë të zhvillimit ekonomik, rritjes së eficiencës ekonomike, dhe rritjes dhe hapjes së vendeve të reja të punës.

o *Marrëveshja për Stabilizim Asociim - MSA*

MSA përpos se shërben si platformë e avancuar nga e cila pritet të përfitojë ekonomia e vendit, po ashtu shërben dhe nxitë reforma ligjore dhe politikë-bërëse, që duhet të ndërmerren nga institucionet e Republikës së Kosovës në vijimësi. Duhet përmendur që nënshkrimi i MSA-së pritet ta përafrojë dhe integrojë ekonominë e vendit me hapësirën ekonomike evropiane dhe të shteteve anëtare të BE-së. Me nënshkrimin e MSA-së, prodhuesit vendor pritet të kenë qasje në tregun e BE-së dhe për rrjedhojë të kemi nxitje të prodhimit, punësimit por edhe cilësisë së produkteve dhe shërbimeve. Kosova duhet të përgatitet të përballet edhe me efekte (jo gjithmonë pozitive) indirekte për ekonominë e saj. Kjo marrëveshje krijon një klimë të re për marrëdhënie ekonomike mbi të gjitha për zhvillimin e tregtisë dhe investimeve që janë faktorë kryesorë në modernizimin dhe ristrukturimin ekonomik. Njëherit kjo shpreh angazhimin e Kosovës për të përafruar legjislacionin në sektorët përkatës me atë të BE-së dhe për të zbatuar atë me efektivitet. Në anën tjetër nga kjo Bashkimi Evropian do të ofrojë mbështetje vendimtare për zbatimin e reformave dhe për të përdorur të gjitha instrumentet e disponueshme të bashkëpunimit dhe asistencës teknike, financiare dhe ekonomike, mbi një bazë gjithëpërfshirëse dhe shumë vjeçare.

o *Procesi i Liberalizimit të Vizave*

Dialogu për liberalizimin e vizave me Bashkimin Evropian mbetet një nga prioritetet kryesore afat-shkurtë të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Qeveria e Republikës së Kosovës mbetet e përkushtuar ta mbyllë këtë kapitull në afatin sa më të shpejtë të mundur në mënyrë që qytetarët tanë të udhëtojnë pa viza në vendet e zonës Schengen.

Duhet theksuar se përkundër angazhimit, përkushtimit dhe progresit të arritur në adresimin e kërkesave që dalin nga të gjitha blloqet e udhërrëfyesit për liberalizim të vizave, Kosovës padrejtësisht nuk i është dhënë sinjali i gjelbër për datën e marrjes së liberalizimit. Qytetarët tanë ende nuk mundën të lëvizin lirshëm në shtetet e zonës Schengen dhe ballafaqohen me procedura të tepërta dhe burokratike për t'u pajisur me Schengen.

o *Themelimi i Gjykatës Speciale*

Një ndër Obligimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës në raport me faktorët ndërkombëtarë, ka qenë po ashtu zbatimi i përkushtimit për themelimin e Gjykatës Speciale. Kjo është arritur përmes amandamentimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Përkundër të gjitha pengesave duke pasur parasysh kërkesën imanente të bashkësisë ndërkombëtare, e cila është shprehur se themelimi i kësaj gjykate ka rëndësi jetike për Republikën e Kosovës, Kosova ka arritur që të përmbushë pjesën e saj në raport me këtë obligim.

o *Fuqizimi i marrëdhënieve shumëpalëshe, bashkëpunimit rajonal, e ndërkombëtar dhe vazhdimi i partneritetit strategjik me Republikën e Shqipërisë*

Anëtarësimi i Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare ka qenë një ndër prioritetet parësore të politikës së jashtme edhe gjatë vitit 2015. Republika e Kosovës ka bërë edhe depozitim formal të akteve të aderimit në Konventën për heqjen e kërkesës për legalizim të dokumenteve publike të jashtme, që njihet ndryshe edhe si Konventa Apostile, si dhe Konventën për aderim në Gjykatën e Përhershme të Arbitrazhit apo Konventa e vitit 1907 për zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve ndërkombëtare. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, Konventa e Apostilës pritet të hyj në fuqi në 14 korrik 2016, ndërsa Konventa e Hagës për anëtarësim në Gjykatën e Përhershme të Arbitrazhit do të hyjë në fuqi më 5 janar 2016.

Në kuadër të forcimit të vazhdueshëm të rolit të Kosovës në marrëdhëniet shumëpalëshe dhe në pamundësi të anëtarësimit momental si anëtare me të drejta të plota në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, është vazhduar me lobimin për anëtarësime të mëtutjeshme në agjencitë tjera të specializuara të OKB-së. Vlen të theksohet në këtë drejtim se ka pasur angazhim maksimal për fushatën e anëtarësimit të RKS në UNESCO, duke arritur që krahas vështirësive procedurale etj., t'a vendos Kosovën në Agjendën e Konferencës së Përgjithshme. Gjithashtu, Republika e Kosovës është përfaqësuar në Nju Jork në kuadër të zhvillimit të punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, me ç'rast janë zhvilluar shumë takime me liderë të shteteve dhe organizatave të ndryshme. Ka vazhduar edhe përfaqësimi periodik tre-mujor në mbledhjet e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ku është raportuar vazhdimisht për progresin dhe të arriturat më të fundit në Kosovë.

Ka vazhduar bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare në Kosovë. Në pjesën e parë të këtij viti është realizuar edhe takimi i Tretë i Grupit punues Këshilli i Evropës - Kosovë. Takimi është vazhdimësi e përpjekjeve për intensifikimin e raporteve me Këshillin e Evropës dhe thellimin e bashkëpunimit të drejtpërdrejtë ndërmjet zyrtarëve të lartë të KiE dhe të ministrive të linjës së Qeverisë së Kosovës. Republika e Kosovës ka nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi me Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq. Ky memorandum parasheh

privilegjet dhe imunitetet që përfaqësuesit e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq do të gëzojnë gjatë mandatit dhe aktivitetëve të tyre në Kosovë.

Me qëllim të forcimit të shtetësisë dhe thellimit të fqinjësisë së mirë e të bashkëpunimit rajonal dhe në funksion të forcimit të paqes rajonale janë zhvilluar aktivitete të ndryshme në kuadër të bashkëpunimit me shtetet e rajonit. Prishtina ka qenë kryeqendra e organizimit të Ministerialit në kuadër të procesit të Berlinit (WB6/Western Balkans Six), pjesëmarrja e të gjitha shteteve të rajonit në të, si dhe arritja e deklaratës konstruktive dhe gjithëpërfshirëse, është vlerësuar lartë edhe nga Komisioneri Hahn. Janë zhvilluar takime të ndryshme me përfaqësuesit më të lartë të Qeverisë Turke dhe Greke ku janë diskutuar çështje të interesit të përbashkët si dhe zhvillimet në rajon.

Marrëveshjet e realizuara gjatë vitit 2015 me vendet e rajonit

- *Marrëveshja udërshtetërore për zhvillimin dhe forcimin e bashkëpunimit ekonomik në të gjitha fushat që konsiderohen të jenë me interes të përbashkët mes RKS dhe Sllovenisë;*
- *Marrëveshja për demarkacionin e kufirit në mes të Kosovës dhe Malit të Zi;*
- *Protokolli i bashkëpunimit me Malin e Zi për personat e pagjetur;*
- *Marrëveshja për themelimin e Fondit për Ballkanin Perëndimor në Pragë;*
- *Protokolli për njohjen e certifikatave veterinarë në mes të RKS dhe Republikës së Shqipërisë;*
- *Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë, Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë në Tiranë dhe Prishtinë, dhe British Council nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi në kuadër të bashkëpunimit për zbatimin e projektit "Projekti për diplomaci digjitale – Shqipëria Digjitale dhe Kosova Digjitale".*

Në kuadër të forcimit të bashkëpunimit strategjik me Republikën e Shqipërisë (në ekonomi, politikë, kulturë, sport dhe fusha të tjera), janë bashkërenduar veprimet për mbledhjen e dytë të përbashkët të Qeverisë së Kosovës dhe Shqipërisë. Në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2015 janë nënshkruar një numër marrëveshjesh në fusha të ndryshme.

o *Bashkëpunimi rajonal dhe normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë*

Një ndër objektivat e Qeverisë së Republikës së Kosovës është edhe synimi i saj për zhvillim të marrëdhënieve konstruktive me vendet në rajon, duke u dëshmuar si faktor i paqes dhe stabilitetit. Në proces të normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë, në kuadër të dialogut, është arritur marrëveshja për drejtësi, e cila do të mundëson funksionimin normal të institucioneve të drejtësisë edhe në pjesën veriore të vendit, konform ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës.

Synim i Qeverisë së Republikës së Kosovës përmes procesit të dialogut me Serbinë, është t'i kontribuojë avancimit të interesave të vendit, rolit të saj në rajon si dhe forcimin e subjektivitetit të saj në marrëdhënie me institucione ndërkombëtare dhe globale.

Lidhur me marrëveshjet e arritura në Bruksel, janë arritur të përmbillen marrëveshje që janë mjaft të rëndësishme, të cilat integrojnë fuqishëm komunitetin serb në institucionet dhe në jetën ekonomike dhe sociale të Kosovës, të cilat u mundësojnë institucioneve lokale dhe qendrore të ushtrojnë në mënyrë të papenguar përgjegjësitë e tyre në tërë territorin e vendit. Marrëveshjet e arritura përfshijnë fushat: drejtësia, shuarja e “mbrojtjes civile”, marrëveshjet për kodin telefonik, për energjinë (zhbllokimin e procesit të zbatimit), largimin e barrikadës nga Ura e Mitrovicës dhe asociacionin, marrëveshjet për sigurimin e automjeteve, tregtinë e produkteve medicinale, ndaljen e ndërtimeve ilegale në veri, asistencë e ndërsjellë ligjore, shkëmbimi elektronik i të dhënave doganore dhe licencimi i kompanive në veri. Për sa i takon Asociacionit, marrëveshja e bënë të qartë se nuk do të ketë kompetencë ekzekutive dhe është në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës. Kosova ka kushtëzuar themelimin e Asociacionit me largimin e plotë të strukturave paralele të Serbisë në Kosovë.

- *Përkrahja arsimore dhe kulturore për diasporën me qëllim të ruajtjes së identitetit kombëtar dhe promovimit të vlerave kulturore dhe kombëtare*

Qeveria e Kosovës është e përkushtuar që të ketë sa më shumë bashkëpunim më mërgatën me qëllim të ruajtjes së identitetit kombëtar dhe promovimit të vlerave kulturore. Gjatë vitit 2015 janë realizuar një sërë aktivitete, qëllimi i të cilave ka qenë promovimi i vlerave kulturore ruajtja e të rinjve nga asimilimi dhe realizimi i projekteve të përbashkëta me bashkatdhetarët që jetojnë jashtë Kosovës.

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes Ndërshtetërore më 23 mars 2015 në Tiranë, për organizimin e mësimit për gjuhën shqipe dhe kulturën shqiptare në diasporë, mes Ministrisë të Diasporës dhe Ministrave të Ministrisë së Arsimit të Kosovës dhe Shqipërisë, grupet e punës për zbatimin e kësaj marrëveshjeje tashmë kanë filluar punën. U nënshkrua Memorandumi i bashkëpunimit me Ministrinë e Kulturës së Kosovës dhe atë të Shqipërisë, për nxitjen e bashkëpunimit mes dy qeverive në programet “Ditët e Kulturës Shqiptare në Diasporë” dhe themelimit të përbashkët të qendrave kulturore në Diasporë.

Është organizuar fushata me moton “Ti je pjesë e Atdheut”, e cila është dizajnuar për promovimin e regjistrimit të diasporës, e cila ka zgjatur tre muaj. Kjo fushatë është përkrahur edhe nga biznese të ndryshme të Kosovës, të cilët i ofruan produktet e tyre falas për bashkatdhetarët në pikat kufitare. Ndër mbështetësit e fushatës ishte edhe PTK dhe Posta e Kosovës, të cilët dhanë falas 70,000 numra të operatorit “Vala” për të gjithë bashkatdhetarët që ishin regjistruar në regjistrin e Diasporës, si rezultat i kësaj, vetëm gjatë verës u regjistruan më shumë se 150.000 bashkatdhetarë. Është arritur që tarifa e Kartanit të Gjellbër të zbritet për 50%, ndërsa kanë vazhduar përpjekjet për heqjen e plotë të kësaj tarife, duke propozuar nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale me shtetet anëtare të Këshillit të Byrove.

Më 2 gusht, në Ditën e Diasporës, janë ndarë çmimet “Mërgimtari i vitit” në gjashtë fusha. Janë ndarë çmimet për gazetari në dy kategori – historia më e mirë televizive për promovimin e diasporës dhe mediumet që kanë dhënë kontribut të veçantë në promovimin e diasporës. Po

ashtu, në bashkëpunim me Filatelinë e Kosovës, u prezantua edhe edicioni i veçantë i pullës postare me temën "Diaspora".

Janë zbatuar politika promovuese dhe mbështetëse për zhvillimin e aktiviteve ekonomike nga diaspora. U organizua në Prishtinë Ekspoforumi për t'i identifikuar mënyrat e reja të financimit të projekteve strategjike Kosovë-Shqipëri. Ekspoforumi u hap me Minipanairin e prodhuesve të diasporës në Kosovë. U realizua në Zvicër aktiviteti kulturor i forumit ekonomik turistik për Kosovën, ku morën pjesë afaristë dhe biznesmenë të shumtë nga Kosova, Zvicra e vendet e tjera. Gjatë këtij viti ka përfunduar faza e parë e projektit, duke u themeluar rrjete të juristëve në Gjermani, Suedi, Austri, Zvicër dhe Itali si dhe janë themeluar në kuadër të projektit për rrjetëzimin e bizneseve të diasporës, rrjetet e bizneseve të diasporës në Australi, Gjermani (Hamburg), Turqi (Stamboll), Suedi dhe në Norvegji. Rreth 60 afaristë shqiptarë nga mbarë bota, përfaqësues të rrjeteve të bizneseve të diasporës shqiptare nga shtetet e ndryshme të botës janë mbledhur përgjatë katër ditëve në Prishtinë, Istog dhe në Tiranë. U mbajt forumi ekonomik me temën "Përmirësimi i ambientit për investimet nga investitorët e diasporës në Kosovë". Me qëllim të promovimit të rrjeteve të bizneseve shqiptare të themeluara në botë, informimit lidhur me objektivat dhe qëllimin e tyre, si dhe motivimin e bizneseve të tjera të bëhen anëtare të rrjeteve dhe të kontribuojnë në fushën e investimeve dhe të zhvillimit ekonomik të vendit, është përgatitur një monografi, në të cilën është pasqyruar i tërë procesi i themelimit të këtyre rrjeteve.

Është promovuar kultura, gjuha dhe historia shqiptare nëpërmjet diasporës, me qëllim ruajtjen e identitetit kombëtar. Tri qendrat kulturore në Zvicër, Turqi dhe Suedi organizuan manifestime kulturore kushtuar Ditës së Shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës. Manifestimet u mbajtën në qytete të ndryshme, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe të një numri të madh të bashkatdhetarëve. Në Suedi, në bashkëpunim me shkollat shqipe në Halmstad, u festua 30-vjetori i shkollës shqipe në Halmstad me një program të pasur kulturo-artistik dhe në bashkëpunim me asociacionet kulturo-arsimore dhe grupet rapsodike, u organizua Festivali i parë i rapsodëve shqiptarë në Suedi.

Për të përkrahur mbarëvajtjen e mësimin të gjuhës shqipe, janë shpërndarë më shumë se 50 mijë libra dhe materiale të tjera shkollore në Kroaci, Slloveni, Austri, Itali, Zvicër, Francë, Gjermani, Angli, Suedi, Belgjikë, Danimarkë, Greqi, Turqi, Australi, Zelandë të Re, Kanada dhe SHBA. Po ashtu, në diasporë janë hapur 13 paralele të reja të mësimin të gjuhës shqipe, si vazhdimësi e përpjekjeve për ruajtjen e gjuhës amtare. Me qëllim që nxënësit, studentët dhe mësuesit nga diaspora t'i forcojnë lidhjet me atdheun, gjatë vitit 2015, janë organizuar tetë ekskursionet dhe dy kampe verore me karakter mësimor-njohës. Në to u përfshinë mbi 350 pjesëmarrës (nxënës, mësues, studentë dhe prindër shqiptarë) nga Turqia, Greqia, Austria, Gjermania, Suedia etj. Organizimi i kuizit të diturisë, me nxënës nga diaspora në Suedi, Gjermani, Greqi, Zvicër dhe Slloveni, si dhe gara finale në Kosovë ishin vlerë e shtuar në ruajtjen e identitetit kombëtar.

U organizua manifestimi tradicional "Ditët e Diasporës", i cili këtë vit u karakterizua me më shumë se 200 aktivitete nga fusha e artit, kulturës, biznesit, arsimit e fusha të tjera. Po ashtu, në

kuadër të këtij manifestimi u dhanë çmimet për mërgimtarin e vitit. Duke u bazuar në marrëveshjen e nënshkruar mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë, këtë vit u organizuan “Ditët e Kulturës Shqiptare në Diasporë”, në partneritet me Ministrinë e Kulturës së Kosovës dhe atë të Shqipërisë. Aktivitetet u organizuan në Zvicër, Belgjikë dhe në Gjermani.

Qeveria i ka kushtuar rëndësi mbështetjes së të rinjve në diasporë me qëllim edukimin e tyre më vlerat kombëtare dhe ruajtjen e gjuhës amtare. Krijimi i mekanizmave të strukturimit të diasporës shqiptare rezultoi edhe me themelimin e rrjeteve të të rinjve dhe studentëve në diasporë. Këtë vit, për herë të parë u promovua dhe u testua programi për praktikantë të rinj për studentët e diasporës, të interesuar për kryerjen e praktikës në institucionet e Kosovës. Në këtë program morën pjesë rreth 30 studentë, të cilët qëndruan në institucione të ndryshme publike qendrore.

Prioriteti i IV-të, Prioriteti Strategjik: Arsimi, Shkenca, Kultura dhe Rinia

o *Avancimi i Arsimit në të gjitha nivelet*

Avancimi i Arsimit dhe Shkencës - si prioritet i Qeverisë së Republikës së Kosovës ka gëzuar përkrahjen e vazhdueshme për reformim dhe avancimin e vazhdueshëm të sistemit edukativo arsimor, në Kosovë.

Treguesit e Arritjeve në Sistemin Arsimor

Kosova ka zhvilluar sistemin arsimor në të gjitha nivelet, ku theks të veçantë meritojnë arritjet në përfshirje të nxënësve në këtë sistem. Sot:

- Mesatarisht 9 nga 10 fëmijë ndjekin arsimin fillor, 8 nga 10 fëmijë ndjekin arsimin e mesëm, 5 nga 10 të rinj ndjekin arsimin e lartë;
- Rreth 17% e Buxhetit të përgjithshëm të Republikës së Kosovës ndahet për arsim (€263 milion);
- Investimi në arsim në krahasim me vitin 2010 është rritur për rreth 30%;
- Kosova ka 23.830 mësindhënës, 382.000 nxënës dhe 122.000 studentë;
- Hapësira fizike për nxënës është përmirësuar për 15%;
- Raporti mësues për nxënës është përmirësuar për 16%.

• **Arsimin Parashkollor**

Në Arsimin Parashkollor është zhvilluar një qasje e integruar ndaj edukimit në fëmijërinë e hershme. Në të kombinohen procesi i edukimit, i kujdesit shëndetësor, i arsimimit, lojës së fëmijëve dhe kujdesit profesional ndaj zhvillimit të tyre. Me qëllim të promovimit të edukimit gjithëpërfshirës parashkollor në Kosovë, gjatë vitit 2015 është arritur bashkëpunim me CARITASIN Zviceran për mobilimin e 150 klasave para-filllore me pajisje moderne si dhe trajnimin cilësor të edukatorëve. Në kuadër të ngritjes së cilësisë së punës edukative janë

trajnuar 890 edukatore të klasave parafillore dhe të institucioneve parashkollore për zbatimin e dokumentit bazë për këtë nivel "Standardeve të Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme 0-6 vjeç". Janë hartuar dy udhëzues praktik për edukatore dhe prindër, të cilët do t'i ndihmojnë edukatorët në punën në aspektin praktik me fëmijët, si dhe është në finalizim drafti i parë kurrikulës bërthamë për edukimin parashkollor për moshën 0-5 vjeç.

Në bashkëpunim me Save the Children, janë hapur 2 qendra të komunitetit në komunën e Mitrovicës dhe në Komunën e Obiliqit, ku janë punësuar 6 edukatore.

- **Arsimi Fillor dhe i Mesëm**

Në **Arsimin Fillor dhe të Mesëm** ka avancuar procesi në zbatimin e kurrikulës së re të bazuar në kompetenca. Kurrikula e re është pilotuar për herë të parë në vitin shkollor 2013/2014 në 10 shkolla duke u zgjeruar më tutje në vitin 2014/2015 në 85 shkolla tjera fillore dhe të mesme. Nga shkollat e përfshira në pilotim të kurrikulës, deri më tani janë 6700 mësimsdhënës (në vitin shkollor 2013/2014 -700 , 2014/15 - 3800 dhe 2015/2016-2200) për zbatimin e kurrikulës, si dhe janë realizuar trajnimet për ngritjen e kapaciteteve për menaxhim efektiv (140 kandidatë janë certifikuar gjatë vitit 2015). Zhvillimi i planprogrameve lëndore për klasat pilotuese, rishikimi i përmbajtjeve të teksteve shkollore dhe përgatitja e materialeve tjera për mësimsdhënë, zbatimi i praktikave të reja të vlerësimit të njohurive të nxënësve dhe aktivizimi i aktiveve profesionale në shkollat pilotuese janë disa aspekte me rëndësi të këtij procesi.

Arritshmëria e nxënësve në teste kombëtare është përmirësuar për 8% krahasuar me vitin 2011. Gjatë vitit 2015, Kosova për herë të parë ka marrë pjesë në vlerësimin ndërkombëtar të nxënësve (PISA) që është një vlerësim ndërkombëtar për njohuritë e nxënësve 15-vjeçare në lexim, matematikë dhe shkencë.

Këtë vit, u nënshkrua Marrëveshja me Bankën Botërore, në vlerë prej 11 milion USD për Projektin e ri për Përmirësimin e Sistemit të Arsimit në Kosovë. Projekti do të mbështesë përmirësimin e kapaciteteve menaxhuese në sektorin e arsimit parauniversitar dhe zhvillimin e infrastrukturës së shkollave me qëllim përmirësimin e cilësisë në arsimin para-universitar dhe përmirësimin e kapaciteteve të institucioneve kryesore për monitorimin e rezultateve mësimore dhe të vlerësimit të mësimin të nxënësve.

Me qëllim të përmirësimit të kushteve për mësimsdhënë dhe mësim-nxënë është vazhduar me ndërtimin e 20 objekteve të reja shkollore për nivelin parauniversitar, të gjitha të pajisura me inventarin e nevojshëm shkollor. Këto objekte përfshijnë komunat: Viti, Deçan, Dragash, Ferizaj, Lipjan, Prizren, Mitrovicë, Podujevë, Suharekë, Kaçanik, Pejë.

Si pjesë e zbatimit të Kontratës Kolektive, janë promovuar kontratat e para të përhershme për mësimsdhënës, unike për të gjithë mësimsdhënësit e nivelit parauniversitar në Kosovë që synojnë të mbrojnë punën e mësimsdhënësve dhe të drejtat e tyre.

Gjatë vitit 2015 është shënuar një bashkëpunim i mirë me Republikën e Shqipërisë në institucionalizimin e mësimin plotësues në diasporë duke përkrahur fëmijët e diasporës dhe të mërgatës, përmes furnizimit me libra dhe mbështetje të aktiviteteve të ndryshme edukativo-arsimore, me qëllim të ruajtjes së gjuhës dhe të identitetit kombëtar. Bashkëpunimi me

Shqipërinë po vazhdon edhe në zhvillimin profesional për unifikimin e kurrikulave. Gjithashtu, ka vazhduar bashkëpunimi në fushën e përafrimit të kurrikulës për arsimin parauniversitar me theks të veçantë në rishikimin e Kornizës së Kurrikulës, planit mësimor, planprogrameve për lëndë dhe klasë, praktikën e vlerësimit të nxënësve dhe reformimin e avancimit të cilësisë së teksteve shkollore. Gjithashtu, ka vazhduar Projekti i riatdhesimit, përmes organizimit të kurseve dhe mësimit plotësues për nxënësit e riatdhesuar (në 10 komuna, ku janë përfshirë 150 nxënës). Janë trajnuar 40 trajnerë për zbatimin e doracakëve „Mundësi të barabarta në arsim për të gjithë”, si dhe janë themeluar 120 Ekipë për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes në nivel shkollor dhe komune.

Për herë të parë është ngritur Këshilli i Ekspertëve të programeve dhe teksteve shkollore, i cili ka për qëllim sigurimin e cilësisë së përgatitjes së teksteve sipas standardeve të caktuara.

Gjatë kësaj periudhe është investuar lidhur me integrimin e teknologjisë informative në sistemin arsimor. Është punuar përkatësisht për krijimin e platformave të hapura, zhvillimin e materialeve me përmbajtje elektronike për shkollat tona dhe zbatimin e platformave për digjitalizimin e përmbajtjeve mësimore në formë audio-vizuale të programit shkollor. Kosova, ka filluar me realizimin e Projektit “TIK dhe Mësimi Elektronik në Arsim” dhe “Digjitalizimi i maturës dhe E-edukimi” dhe janë mbështetur mbi 190 shkolla në gjithë Kosovën me furnizimin me pajisje moderne të teknologjisë (€1.5milion). Projekti *e- Edukimi* nga BIT media ka kryer fazën e parë të trajnimit të 51 mësimitdhënësve dhe fazën e dytë të trajnimit 100 mësimitdhënës dhe 300 administratorë për krijimin e portaleve elektronike dhe menaxhimin e tyre. Po ashtu, në bashkëpunim me Agjencinë e Shoqërisë Informativë është zhvilluar dhe zgjeruar zbatimi i aplikacionit e-shkolla. Ky aplikacion digjitalizon të gjithë procesin mësimor, në sistemin shkollor parauniversitar (digjitalizimi i librit amë në shkolla; ditarit dhe punëve në ditar; orarit; dokumenteve: certifikatave, librezave, në bazë të notimeve në ditar; regjistrin të nxënësve, arsimtarëve; regjistrin të lëndëve mësimore; regjistrin të shkollave, klasave dhe inventarit; kurrikulave shkollore, planprogrameve; realizimit të planprogrameve për secilin arsimtar veç e veç).

Sigurimi i Cilësisë mbetet prioritet i Qeverisë në të gjitha nivelet e arsimit. Qeveria miratoi Strategjinë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2016 - 2020¹². Kjo strategji do të shërbejë si një udhërrëfyes për ngritjen e cilësisë në sistemin e arsimit parauniversitar, përmes tri shtyllave kryesore të këtij dokumenti, e të cilat janë: reformimi i procesit të mësimitdhënies, në mënyrë që të ofrohet një mësimitdhënie moderne, ndërtimi i karricrës gjatë gjithë jetës i mësimitdhënësve dhe fuqizimi i aspekteve praktike të planprogrameve.

- **Arsimi Profesional**

Arsimi Profesional po fokusohet në harmonizimin e kurrikulës së tij ¹³ me kërkesat e tregut të punës në Kosovë. Autoriteti Kosovar për Kualifikime Kombëtare është anëtarësuar në

¹²Mbështetur nga Projekti të Binjakëzimit, financuar nga Bashkimi Evropian dhe Kulturë Kontakt Austria.

¹³Me mbështetjen nga Bashkimi Evropian dhe Agjencinë Austriake për Zhvillim.

Grupin Këshillëdhënës për Kornizën Evropiane për Kualifikime (EQF). Fondacioni Evropian për trajnime në raportin e tij për vitin 2015, përmend Autoritetin e Kualifikimeve Kombëtare dhe në përgjithësi Kosovën si vendin më të avancuar në rajon për zbatimin e Kornizës së Kualifikimeve Kombëtare. Kosova për herë të parë do të përfshihet në hulumtimet dhe publikimet e Qendrës Evropiane për Zhvillim të Arsimit dhe Aftësimin Profesional (CEDEFOP)¹⁴ lidhur me Kornizat Kombëtare.

Është hartuar Koncepti për Vizionin mbi Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur. Po ashtu, ka filluar procesi për hartimin e Kornizës së Kurrikulës për Arsim dhe Aftësim Profesional që me përkrahjen e partnerëve zhvillimor pritet të përfundojë brenda vitit 2016. Në kuadër të ofrimit të arsimit joformal është realizuar mësimi kompenzativ dhe mësimi i arsimit dhe aftësimin profesional për të rritur (2013 vijues), si dhe programi “Shkrim-lexim bazik për femra dhe për të verbër” (gjithsej 50 femra dhe 30 të verbër).

Në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale është përgatitur dhe ka filluar zbatimin e Strategjisë për Edukim dhe Orientim në Karrierë.

- **Arsimi i Lartë**

Gjatë këtij viti janë zhvilluar aktivitete në garantimin e autonomisë akademike të institucioneve të arsimit të lartë, si kusht thelbësor në rritjen e cilësisë në arsimin e lartë. Janë mbështetur me masa konkrete universitetet publike në programet mësimore dhe në administrimin e buxheteve, në mënyrë që universitetet t’i përdorin në mënyrë sa më efektive burimet materiale që i zotërojnë. Është arritur pajtueshmëria dhe plan koordinimi me Universitetin e Prishtinës për të ofruar mbështetjen me kuadro akademike edhe për një kohë të caktuar për të ndihmuar universitetet e reja publike. Kjo mbështetje është konkretizuar me marrëveshjet e mirëkuptimit të nënshkruara nga Universiteti i Prishtinës me Universitetin e Gjakovës, Gjilanit, Mitrovicës dhe Prizrenit. Për herë të parë janë organizuar me sukses zgjedhjet në tri (3) universiteteve publike në Gjakovë, Gjilan dhe Mitrovicë për zgjedhjen e organeve drejtuese të Universitetit.

Arsimi i lartë po orientohet gjithnjë e më tepër ndaj nevojave të tregut të punës. Në vitin 2015 është themeluar “Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj”, si institucion publik i arsimit të lartë, i cili do të funksionojë si një universitet specifik, unik në Kosovë, i orientuar në drejtime profesionale, me potencial të madh për krijimin e kuadrove të reja profesionale dhe akademike, të cilat janë të nxitura nga tregu i punës. Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj ka filluar punën në programet e studimit: Arkitektura e Interierit dhe Dizajni i Mobileve, Inxhinieria Industriale me Informatikë, Menaxhmenti Industrial dhe Menaxhimi i Hotelerisë dhe Turizmit.

¹⁴CEDEFOP është Agjenci e Bashkimit Evropian, e cila mbështet zhvillimin e politikave evropiane të arsimit dhe aftësimin profesional.

Në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" në vitin akademik 2015/2016, është realizuar koordinimi i numrit të studentëve në fusha të caktuara të studimit për të reflektuar në nevojat e tregut të punës dhe bazuar në kapacitetet kuadrovike të universitetit. Kryesisht, kjo platformë ka rezultuar në zvogëlimin e numrit të i studentëve të regjistruar në vitin e parë të studimeve nga shkencat sociale, për 2724 studentë. Në gjitha universitetet publike në Kosovë, në vitin akademik 2015/2016 janë regjistruar 15,515 studentë.

Me qëllim të përkrahjes të studentëve në fusha të ndryshme të orientuara në degë të rëndësishme strategjike për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës, me fokus të veçantë në shkencat ekzakte, bujqësi, inxhinieri, mjekësi, shkencat matematiko-natyrore dhe edukim ka ndarë rreth 750 bursa për studentët e institucioneve publike të arsimit të lartë në programet deficitare.

Rritjes së cilësisë në arsim ka qenë edhe një nga sfidat dhe objektivat e rëndësishme të Qeverisë. Agjencia e Kosovës për Akreditim është pranuar në Regjistrin Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR). Janë mbyllur të gjitha institucionet e arsimit të lartë, të cilat kanë vepruar pa akreditim dhe pa licencë, në Republikën e Kosovës. Në bashkëfinancim me USAID janë ndarë 89 bursa për studime Master në SHBA, si dhe përmes Programit të Shkëmbimit të Evropës Qendrore për Studime Universitare (CEEPUS) janë mbështetur dhjetëra mobilitete jashtë vendit të stafit akademik. Janë ndarë rreth mbi 130 bursa studimi për studentët kosovar për studime në universitetet më të mira botërore. Për herë të parë është përgatitur dhe funksionalizuar Sistemi për Menaxhimin të Dhënave në Arsimin e Lartë (SMIAL).

Si pjesë e avancimit të arsimit dhe shkencës është hapur po ashtu Qendra për Përsosmëri në Mësimdhënie, kjo Qendër do të kujdeset vazhdimisht për ofrimin e një mësimdhënie moderne, mësimdhënie të shekullit 21, e cila merr parasysh faktin që kemi nevojë për një mësimdhënës interaktiv, për metodat të cilat do të mundësojnë që studentët Kosovar të marrin mësimdhënie cilësore.

- **Kërkimi Shkencor**

Qeveria e Kosovës me qëllim të avancimit të sistemit të arsimit po ashtu është duke ndërmarrë disa hapa në drejtim të definimit të skemave të stimulimit për pjesëmarrje në projektet ndërkombëtare, përfshirë edhe Horizonin 2020. Horizon 2020 do të ofrojë mbështetje për projektet deri në vitin 2020 me një buxhet prej mbi 70 miliardë eurosh. Republika e Kosovës aktualisht e ka statusin e vendit ndërkombëtarë për bashkëpunim në Horizon 2020. Me qëllim të marrjes së statusit të Asociuar në Horizon 2020, Qeveria e Kosovës është duke punuar në ngritjen e kapaciteteve vendore për të aplikuar me sa më shumë fonde. Në fushën e Shkencës është mbështetur puna kërkimore dhe shkencore¹⁵ përmes granteve të ndryshme. Janë mbështetur 14 projekte shkencore, 8 publikime shkencore, 5 publikime në revista me impakt faktor si dhe janë ofruar granteve për mobilitete afatshkurtra (42). Kosova ka filluar të jetë

¹⁵Në kuadër të Fondit (€570.000)

aktive në Programin Kornizë të BE-së për Kërkim dhe Inovacion - Horizon 2020. 4 projekte janë fituar nga aplikuesit nga Kosova. Gjatë 2015 është hartuar Strategjia e Kosovës për Inovacion.

Është thelluar më tej bashkëpunimi rajonal në fushën e arsimit e shkencës. Gjatë këtij viti Qeveria e Kosovës poashtu ka marrë pjesë në Konferencën Ministrore të Ballkanit Perëndimor për Hulumtime dhe Inovacion, e cila është mbajtur sot në Split të Kroacisë. Gjatë kësaj Konference, ministrat e Arsimit dhe të Shkencës të Kosovës, Shqipërisë, Kroacisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Serbisë dhe Malit të Zi kanë nënshkruar marrëveshjen për themelimin e Qendrës së Ballkanit Perëndimor për Hulumtime dhe Inovacion.

Bashkëpunimi në sferën e hulumtimit dhe inovacionit është një domosdoshmëri e kohës për vendet tona të regjionit dhe është një mundësi shumë e mirë që vendet tona të bashkuara të ecin rrugës së integrimeve evropiane.

Gjatë këtij viti po ashtu është nënshkruar Programi për Bashkëpunim ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë. Nënshkrimi i Programit është bërë në kuadër të Marrëveshjes për Bashkëpunim në fushën e arsimit dhe shkencës, e cila është nënshkruar në korrik të këtij viti në Vlorë, mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë, me synim përforcimin e marrëdhënieve mes dy shteteve në këtë fushë.

Gjatë vitit 2015 është punuar në ndryshime substanciale në kuadër të refomës së legjislacionit për arsimin. Janë miratuar këto projektligje: për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Kosovës të miratuara në Qeveri, ndërsa Ligji për Provimin e Maturës Shtetërore dhe Ligji për Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës janë miratuara nga Kuvendi.

o *Kultura dhe Trashëgimia kulturore dhe historike*

Gjatë vitit 2015 ka avancuar rishikimi i kornizës ligjore dhe hartimi i kuadrit strategjik. Politikat e ndjekura në fushën e kulturës kanë pasur si qëllim vendosjen e rregullave për përkrahjen kulturore. Qeveria ka miratuar Projektligjin për Kinematografi dhe ka filluar hartimi i Strategjisë Kombëtare për Kulturë 2016-2020. Në funksion të garantimit të funksionalizimit të plotë Institucioneve të kulturës janë konsoliduar Këshillat Drejtues të institucioneve të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore. Po ashtu, u është garantuar autonomia financiare, duke u hapur nënkode të veçanta, si dhe u është ndarë buxheti vjetor.

Janë hedhur hapa të mëtejshme drejt bashkëpunimit kulturor me vende të ndryshme. Janë finalizuar marrëveshjet me Kroacinë e Bullgarinë, si dhe janë iniciuar tri marrëveshje të reja me Malin e Zi, Italinë dhe Zvicrën. Ka vazhduar zbatimi i Protokollit të Bashkëpunimit Kulturor me Republikën e Shqipërisë si dhe pjesëmarrja në Bienalen e Venedikut, në Panairin e Librit në Frankfurt etj. Po punohet drejt organizimit të "Ditëve të Kulturës Shqiptare" në diasporë.

Aktiviteti kulturor ka qenë i pasur me aktivitete kulturore të organizuara brenda dhe jashtë Kosovës. Janë shfaqur katër premiera të Ansambllit të Baletit me koreografë eminentë botërore si dhe është mbajtur një premierë të këtij ansambli në Grac të Austrisë. Filarmonia e Kosovës ka mbajtur 22 koncerte premierë, kurse Kori i Filarmonisë katër koncerte në Prishtinë dhe Shqipëri. Ansambli Kombëtar "Shota" përveç dy koncerteve premierë, ka shfaqur edhe dhjetëra të tjera në Kosovë, Shqipëri e Maqedoni. Ndërkaq, vlen të theksohet pjesëmarrja në Festivalin e Portugalisë dhe në Festivalin mbarëkombëtar të Folklorit në Gjirokastër, ku Kosova ka marrë pjesë me dy grupe me nga 60 pjesëmarrës, me ç'rast janë prezantuar vlerat e traditës së folklorit tonë.

Në fushën e Trashëgimisë Kulturore ka vazhduar puna për plotësimin dhe avancimit të kornizës ligjore dhe strategjike. Është miratuar Projektligji për Trashëgimi Kulturore, si dhe është hartuar Strategjia Kombëtare për Trashëgimi Kulturore. Është bërë emërimi dhe funksionalizimi i Këshillave Drejtuese për tri institucionet e nivelit qendror si Instituti i Kosovës për Mbrojtje të Monumenteve, Muzeu i Kosovës dhe Instituti Arkeologjik i Kosovës. Gjithashtu, në zbatim të Ligjit për Trashëgimi Kulturore, edhe këtë vit është plotësuar Lista e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme e cila përmban 1525 asete nga 5 kategoritë ligjore, përfshirë si pjesë përbërëse edhe zonat e veçanta të mbrojtura.

Për herë të parë në vitin 2015 u organizua konferenca me titull: Trashëgimia Kulturore dhe Turizmi. Me pjesëmarrje të specialistëve të mirënjohur ndërkombëtar dhe vendor duke përfshirë dhe Universitetin, konferenca ka trajtuar disa tema me interes për trashëgiminë kulturore të vendit tonë, duke filluar nga aspekti i legjislacionit e deri te promovimi.

Kosova, me trashëgiminë e pasur kulturore, të evidencuar që nga Antikiteti i hershëm e gjerë në historinë e re, ka çfarë t'i ofrojë botës, ndaj njohja e këtyre vlerave, shtron para nesh standarde ndërkombëtare. Megjithëse Kosova nuk u pranua në UNESCO shteti ynë gëzoi një përkrahje të fuqishme përgjatë procesit të votimit dhe ky është indikator i veçantë se Qeveria e Republikës së Kosovës ka përmbushur standarde për anëtarësim në UNESCO.

o *Fuqizimi i rinisë*

Marrë parasysh faktin se Kosova ka një popullsi kryesisht të përbërë nga të rinjtë, Qeveria e Kosovës është përkushtuar që të përkrahë të rinjtë në avancim dhe prosperim. Në këtë lëmi është arritur progres përmes projekteve të ndryshme me impakt të dukshëm për të rinjtë e Kosovës. Edhe gjatë këtij viti Qeveria ka investuar në drejtim të mbështetjes së infrastrukturës fizike, institucionale dhe ngritjes së kapaciteteve. Kanë përfunduar punimet në objektin e qendrës rinore në Gjilan si dhe është kontraktuar ndërtimi i objektit të qendrës rinore në Ferizaj. Rreth 150 pjesëmarrës janë trajnuar në kuadër të projektit për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve rinore komunale, përfaqësuesve të qendrave rinore si dhe të këshillave të veprimtimit rinor lokal. Janë mbështetur një numër i konsiderueshëm i të rinjve dhe organizatave rinore në kuadër të bashkëpunimeve dhe rrjetëzimeve rajonale dhe ndërkombëtare.

Në kuadër të objektivës për punësueshmëri dhe ndërmarrësi janë realizuar trajnime për ndërmarrësi për të rinjtë ku kanë përfituar rreth 800 të rinj, të trajnuar për shkathhtësi jetësore me qëllim të përgatitjes së tyre për tregun e punës, si dhe 220 prej tyre kanë përfituar grante për hapjen e bizneseve. Në kuadër të politikës së integrimit shoqëror janë mbështetur 75 projekte të organizatave rinore përmes së cilave janë realizuar objektivat specifike si: kohezioni social, puna vullnetare, integrimi i të rinjve dhe të rejave nga zonat rurale, personat me aftësi të kufizuara si dhe pakicat. Po ashtu, janë mbështetur rreth 45 organizata rinore që kanë realizuar projekte në fushën e sigurisë njerëzore dhe edukimit shëndetësorë për të rinjtë.

Në fushën e rinisë janë nënshkruar marrëveshje bilaterale dhe multilaterale me vendet e Ballkanit. Marrëveshja për Bashkëpunim në fushën e rinisë në mes Shqipërisë dhe Kosovës; Deklarata e Përbashkët për themelimin e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor në Ballkanin Perëndimor (Shqipëri, Kosovë, Mali i Zi, Serbi, Maqedoni dhe Bosna dhe Hercegovina).

o *Përkrahja e sportit kosovar*

Qeveria e Kosovës është përkushtuar në vazhdimësi që të ofrojë përkrahje për sportin kosovar. Është përmirësuar infrastruktura për ambientet sportive e rekreative si Palestrat e Sportit në Dardanë, Rahovec, Deçan, Istog, Skënderaj, Klinë e Mitrovicë. Kanë vazhduar punimet në stadiumet e Prizrenit, Vushtrrisë dhe ka përfunduar ndërtimi i 14 poligoneve sportive në qendrat regjionale.

Me qëllim të shmangies së dhunës në sport Qeveria ka miratuar Projektligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës në Sport.

Gjatë këtij viti janë bërë hapa konkret në drejtim të zhvillimit të strukturave qeveritare dhe jo-qeveritare, si dhe në reformimin dhe avancimin e punës në kuadër të KOK-ut, Federatave Sportive, shoqatave dhe klubeve të sportit në mbështetje të cilat kanë përmirësuar gjendjen e federatave në veçanti dhe sportit të Kosovës në përgjithësi, ku janë arritur rezultate përmbajtësor, zhvillimin e kuadrove, anëtarësimin dhe licencimin e sportit të Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Prioriteti i V-të Strategjik: Shëndetësia Moderne

Qeveria e Republikës së Kosovës është e determinuar që të bëjë reforma dhe modernizim në sektorin e shëndetësisë. Tri parakushtet për zhvillimin e reformës janë: vizioni i qartë, korniza politike që promovon dhe avokohet nga Qeveria dhe vullneti politik për të zbatuar ndryshimet. Të tre këto elemente trasojnë rrugën për zhvillimin e reformës shëndetësore, duke e ditur edhe faktin se Qeveria e Kosovës, për herë të parë është duke e trajtuar shëndetësinë si prioritet dhe e ka futur atë në mesin e pesë prioritetëve të saj.

o *Reformimi dhe modernizimi i shëndetësisë*

Gjatë këtij viti është bërë prezantimi i Kornizës logjike të veprimeve që dalin nga Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2015-2020 dhe Planin i Veprimit të këtyre veprimeve. Akterët e përfshirë në reformën shëndetësore kanë dhënë vizionin dhe kontributin e tyre lidhur me arritjen e objektivave të parapara në reformën shëndetësore. Korniza logjike e veprimeve, do të shërbejë si instrument për të matur zbatimin e strategjisë bashkë me Planin e Veprimit që do të jetë udhërrëfyes për përgatitjen e planeve të departamenteve dhe gjithë institucioneve shëndetësore. Qeveria synon zhvillimin e strategjisë sektoriale të bazuar në rezultatet si qasje e re në zbatimin e kësaj strategjie, duke matur arritjen me rezultate konkrete. Janë përcaktuar edhe indikatorët e qartë që Strategjia të mos mbetet në dokument në sirtarët shëndetësor, por të jetë një dokument i zbatueshëm.

Qeveria synon të bëjë edhe riororganizimin e roleve të reja në shëndetësi nëpërmjet funksionalizimit të Odave të profesionistëve shëndetësor. Gjatë vitit 2015 është përmbyllur cikli i themelimit të pesë odave profesionale, me themelimin e Odës së Fizioterapeutëve të Kosovës si dhe zgjedhjen e organeve të Odës së Fizioterapeutëve.

Është plotësuar korniza ligjore në sektorin e shëndetësisë. Janë miratuar: Ligji për shëndet mendor – i cili ka për qëllim vendosjen e rregullave bazike në shëndetin mendor, mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit mendor, parandalimin e problemeve që lidhen më të, garantimin e të drejtave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me çrregullime mendore; Ligji për të ushqyerit me qumësht gjiri – i cili mbron të ushqyerit me qumësht gjiri përmes inkurajimit dhe promovimit të tij dhe kufizimeve në marketingun e produkteve të caktuara për ushqim të foshnjave dhe fëmijëve të vegjël.

Po ashtu, janë miratuar edhe udhëzimet administrative: për Autorizimin për Marketing për Produkte Medicinale; për Organizimin, përcaktimin e shërbimeve dhe veprimtarisë së Institucioneve të Kujdesit Parësor Shëndetësor (KPSH); për Laboratorët Galenik; për Komisionin për Vlerësimin e produkteve Medicinale dhe Pajisjeve Medicinale; për Bordin e Ankesave; për Kushtet e Përgjithshme dhe të veçanta spitalore; mbi kërkesat e praktikës së mirë të prodhimit lëshimit të autorizim prodhimit dhe Certifikatës për praktiken e mirë të prodhimit për Produktet; për Protokollin klinike dhe Udhërrëfyesit; për Mjediset pa tym duhani dhe vendosja e shenjave për ndalimin e pirjes së duhanit në hapësirat e mbyllura; për

Mbledhjen e premiumeve për sigurimin shëndetësor të obligueshëm; për qarkulluesit me pakicë për produkte dhe pajisje medicinale.

Programi i Shkollimit Specialistik të Mjekësisë Familjare të Kosovës është akredituar nga Kolegji Mbretëror i Mjekëve të Përgjithshëm të Mbretërisë së Bashkuar. Është bërë botimi i katërt i Regjistrit zyrtar të barnave në Republikën e Kosovës. Regjistri i ri përmban 160 molekula të reja apo 613 lloje të ndryshme të barnave të regjistruara, ndërkohë që vet tregu kosovar i barnave është solid dhe numëron rreth 700 molekula apo 3000 forma farmaceutike. Në kuadër të edukimit të vazhdueshëm profesional, 84 profesionist shëndetësor kanë vijuar aktivitete të vazhdueshme profesionale (kongrese, kurse, seminare, punëtori, etj).

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve në shërbimin shëndetësor të burgjeve janë punësuar (10). Agjencioni për Financim Shëndetësor në mbështetje të fondeve nga Banka Botërore ka filluar procesin e trajnimit të 50 zyrtarëve nga Ministria e Shëndetësisë, Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, SHKSUK për master trajnues, të cilët do të vazhdojnë trajnimin e të gjithë personelit relevant.

Me qëllim të vazhdimin të zhvillimit të Sistemit të informimit shëndetësor është bërë lansimi i Sistemit të Integruar të Informimit Shëndetësor (SISH). SIZH po pilotohet në regjionin e Prishtinës, përkatësisht në klinikën e pediatriisë, që është institucioni i parë prej 68 institucioneve të përfshira ku SISH-i do të pilotohet.

Janë kryer investime kapitale me qëllim përmirësimin e infrastrukturës në sektorin e shëndetësisë. Ka vazhduar ndërtimi i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Kaçanik, ndërtimi i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Skënderaj. Ka përfunduar renovimi i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Zveçan. Ndërkohë kanë filluar procedurat e tenderimit për projektin e ndërtesës së Klinikës së Emergjencës dhe inicimi i projektit për ndërtimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare në Bajr-Mitrovicë.

o *Mbrojtja e shëndetit të popullatës*

Vëmendje vazhdon ti kushtohet shëndetit të nënës, fëmijës dhe shëndetit reprodaktiv. Janë ndërmarrë një sërë aktivitete promovuese dhe trajnuese të profesionistëve shëndetësor me qëllim sigurimin e një kujdesi efektiv. Në tri (3) komunat pilot: Prizren, Gjakovë dhe Fushë Kosovë, nga ekipet e Mjekësisë Familjare janë realizuar gjithsejtë: 839 vizita shtëpiake në familje ku janë vizituar 232 shtatzëna dhe 607 fëmijë. Nga këto, 31 vizita janë realizuar në komunitetin rom, ashkali dhe egjiptas. Aktivitetet promovuese dhe mbështetëse kanë sjellë një përmirësim të nivelit të vdekshmërisë së foshnjave. Për vitin 2015 vdekshmëria perinatale është 11.9 që tregon një trend të uljes prej 4% krahasuar me vitin 2014.

Në zbatim të Strategjisë për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës 2009- 2015, ka vazhduar programin e imunizimit të fëmijëve të komunitetit rom, me vaksinimin e 550 fëmijëve, ashkali dhe egjiptas që janë të pavaksinuar apo pjesërisht të pavaksinuar. Janë ndërmarrë fushata me qëllim të vetëdijësimit të parandalimit të

ekspozimit ndaj Plumbit për komunitetin rom si komunitet më i rrezikuar. Popullata e komunitetit Ashkali dhe Egjiptian janë integruar në sistemin shëndetësor, për ndryshim nga ai Rom i cili ende heziton edhe përkundër prioriteteve dhe angazhimit. Qeveria ka siguruar pajisjet për analiza të gjakut si dhe produktin për trajtimin e personave të diagnostifikuar me nivel të lartë të plumbit në gjak.

Edhe gjatë vitit 2015 ka vazhduar zbatimin e Programit Nacional të Kontrollit të Kancerit në Kosovë 2014-2020. Nëpërmjet projektit të mamografisë mobile i janë nënshtruar kontrollit 994 femra në disa rajone të Kosovës. Mamografi mobile janë bërë deri tash në komuna e rajone të ndryshme të Kosovës si: Gjilani, Vitia, Novobërda, Zhupa e Prizrenit, Prishtina dhe Podujeva. Gjatë vitit 2016 ekzaminimi do vazhdojë edhe në komunat e tjera sipas planit dinamik të lëvizjes së mamografit.

Raportet Sektoriale

Zyra e Kryeministrit

Zyra e Kryeministrit në rolin udhëheqës të koordinimit të punës së Qeverisë është fokusuar në përmbushjen e detyrave të caktuara në kuadër të prioriteteve strategjike të Qeverisë, si dhe në përmbushjen e detyrave në kuadër të prioriteteve të vet ZKM-së. Në kuadër të përmbushjes së këtyre detyrave në 62 mbledhje të mbajtura të Qeverisë, janë nxjerrë 497 vendime ku janë miratuar 24 koncept dokumente dhe 80 projektligje që janë proceduar në Kuvend. Projektligjet së bashku me 39 vendime të Qeverisë, si opinione, raporte, strategji, programe për njoftim, propozime për emërimë nëpër borde, komisione etj. janë proceduar në Kuvend. Janë pranuar nga Kuvendi dhe janë përcjellë ministrive 364 pyetje parlamentare, janë proceduar të Presidentja e Kosovës 11 vendime të Qeverisë për dhënien e autorizimit Ministrave për nënshkrimin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare. Qeveria ka miratuar njëzet e katër (24) akte nënligjore; shtatëmbëdhjetë (17) Rregullore; shtatë (7) Udhëzime Administrative. Qeveria ka miratuar gjithsejtë 137 Akte nënligjore (16 Rregullore dhe 97 Udhëzime Administrative). Qeveria ka miratuar Udhërrëfyesin për Vlerësimin Ex-post të Legjislacionit në Republikën e Kosovës, i cili do të shërben për të vendosur hapat që kërkohen të ndërmerren për të bërë vlerësimin ex-post. Me qëllim të funksionalizimit të këtij Regjistri, Qeveria e Kosovës me datë 15.04.2015 ka miratuar Rregulloren Nr. 06/2015 për Regjistrin Qendror të llojeve të lejeve dhe licencave.

Me qëllim të ngritjes së mëtutjeshme të kapaciteteve të Qeverisë për zhvillimin e politikave Sekretariati ka arritur marrëveshje me Agjencinë Ndërkombëtare për Zhvillim të Suedisë- SIDA Projektin “Mbështetje shumë vjeçare për përmirësimin e zhvillimit të politikave në Kosovë” projekt ky që do të mbështes Zyrën e Kryeministrit dhe ministrinë për një periudhë 4 vjeçare me një buxhet rreth 3.2 milion euro.

Është bërë monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të prioriteteve strategjike dhe objektivave të Qeverisë të parapara në Planin Vjetor të Punës së Qeverisë për vitin 2015 si dhe monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të vendimeve të Qeverisë në periudha tre mujore për të cilat janë përgatitur analiza.

SKQ si institucion koordinues ka ndihmuar në funksionalizimin e trupave qeveritare si dhe ka ndihmuar punën e komisioneve ekzistuese. Në këtë drejtim është përkrahur puna e Grupit Punues për ballafaqim me të kaluarën dhe pajtim, janë zhvilluar procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të bordeve për 15 Ndërmarrje Publike duke përfshirë dhe bashkëpunimin me komunat përkatëse për ndërmarrjet e ujit dhe ujësjellësve.

Po ashtu është bërë kompletimi i bordeve me anëtarë nga ana e Qeverisë, të cilat i janë përcjellë Kuvendit për: Komisionin për dhënien e Provimit të Jurisprudencës; Këshillin Kombëtar të Shkencës; Komisionin Rregullativ të Pokurimit Publik; Këshilli Drejtues i Institutit Gjyqësor të

Kosovës; Organin Shqyrtues të Prokurimit; Agjencionin Kosovar për Privatizim; Zyra e Rregullatorit për Energji; dhe Autoritetin Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare, Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Komisioni për Shqyrtimin e Kërkesave për Blerjen e Banesave për të cilat Ekziston e Drejta Banesore ka përmbyll procesin e shqyrtimit të kërkesave, me ç'rast janë nënshkruar 58 kontrata për shitblerje të banesave.

Për mbështetje të trupave qeveritare gjatë kësaj periudhe është punuar në përmbushjen e procedurave për vlerësimin e performancës për zyrtarët e lartë, procedurat disiplinore dhe shkarkimin e zyrtarëve të lartë drejtues, procedurat për zgjedhjen e ankesave dhe janë hartuar propozimet për vazhdimin e mandateve për zyrtarët e lartë drejtues, të gjitha këto të dala nga 8-të mbledhjet e Këshillit për Pozita e Nivelit të Lartë Drejtues ku janë nxjerrë 12 vendime dhe 3 rekomandime.

Ka vazhduar identifikimi dhe shqyrtimi i politikave prioritare dhe dokumenteve strategjike të Qeverisë, janë bërë vlerësime në Sfidat Strategjike me ç'rast është bërë analiza e gjendjes së kornizës strategjike në fushën e arsimit, shkencës dhe teknologjisë, kulturës, rinisë dhe sporteve dhe mirëqenies sociale. Në vazhdim të kësaj është ndërmarr konsultimi për ndryshimin e qasjes në procesin e hartimit të dokumenteve Strategjike, duke sugjeruar që të mbahet një qasje sa më sektoriale, dhe me këtë janë dhënë udhëzime dhe informata për ministrinë lidhur me nevojën e ndryshimeve në disa aspekte si dhe mbi procesin e hartimit të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit dhe Planifikimit të Integruar.

Ka vazhduar drejtimi i Grupit Punues për hartimin e Strategjisë për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit, që shpie në Terrorizëm 2015-2020.

Si pjesë e zotimeve të Qeverisë së Kosovës në kuadër të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (KBR), ZPS e përkrahur nga Nisma FRAME e European Training Foundation (ETF), ka koordinuar procesin e hartimit të dokumentit strategjik "Vizioni i Kosovës për Shkathtësitë 2020", dhe ka finalizuar në tërësi këtë dokument strategjik së bashku me Udhërrëfyesin, Masat dhe Treguesit e tij, i cili është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Në kuadër të Qeverisjes së Mirë është përfunduar Raporti i vlerësimit të Strategjisë dhe Planit Nacional të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve 2009-2013; Publikimi i Udhëzuesit për zbatim të protokollit për parandalim të dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar; Draftimi i treguesve kundër dhunës; Raporti i monitorimit të Treguesve për Drejtësi për Fëmijë dhe adresimi i rekomandimeve të dala tek institucionet përgjegjëse; Finalizimi i veprimeve të nevojshme rreth procesit të raportimit për Konventën për të Drejtat e Fëmijës; Mbarëvajtja e aktiviteteve të Këshillit për Mbrojtje dhe Drejtësi për Fëmijë; Raporti vjetor i Këshillit për Mbrojtje dhe Drejtësi për Fëmijë; Raport Vjetor për bashkëpunimin qeveri-shoqëri civile; Fuqizimi i bashkëpunimit të Qeverisë me shoqërinë civile në Republikën e Kosovës.

Është hartuar Raporti i vlerësimit për zbatimin e Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile si dhe Plani i Punës për Këshillin dhe zbatimi i objektivave dhe masave të parapara në Strategjinë dhe Planin e Veprimit qeveritar për bashkëpunim me shoqërinë civile.

Sa i përket fushës së Bashkëpunimit Rajonal gjatë periudhës raportuese ZKBR ka zhvilluar aktivitetet në kuadër të planit të zyrës në koordinim me Sekretariatit e RCC-së në Sarajevë. Gjatë muajit Shkurt 3-4 2015 Sekretariati i RCC-së në bashkëpunim me MTI kanë organizuar në Prishtinë Takimin dy ditor për Strategjinë e Evropës Juglindore SEE-2020. Në Shkurt 11-13 2015 në Sarajevë është mbajtur Takimi i I-rë i Komitetit të Programeve të EJL-së 2020 ku Qeveria është përfaqësuar nga MIE dhe MPJ, organizuar nga RCC. Në këtë takim u diskutua rreth angazhimeve të marra në lidhje me zbatimin e Strategjisë për Evropën Juglindore 2020, si dhe për të vendosur një forum të ashtuquajtur "Komiteti i Programeve të EJL 2020". Takimi për Koordinimin e Donatorëve në Ballkanin Perëndimor u mbajt në Sarajevë (12-13 Shkurt 2015). Në Prill 2015, u emërua Koordinatori Nacional në KBR. Me 12 Maj 2015 në Sarajevë është mbajtur Takimi i rregullt i Bordit të RCC-së me ç' rast Republika e Kosovës u përfaqësua nga MPJ. Ndërsa, me 22 Maj 2015 është mbajtur Takimi Vjetor i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal në Tiranë në të cilin Kosova është përfaqësuar nga Koordinatori Nacional në KBR. Me ftesë të Roma Decade Secretariat me 10-11 Shtator 2015 Koordinatori Nacional i Romëve – përfaqësues nga ZQM/ZKM mori pjesë në International Steering Committee në Sarajevë, me ç' rast u diskutua mbi Projektin rajonal "Roma Integration 2020". Zyra e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal ka përmbyllur aktivitete e saja me pjesëmarrjen në takimin e rregullt të Bordit të RCC-së të 27-tin me radhë, i cili u mbajt në Sarajevë (15 Tetor 2015) përfaqësuar nga Koordinatori Nacional në KBR.

Çështja e personave të zhdukur, vazhdon të trajtohet me prioritet mbarë institucional, në veçanti duke pasur parasysh sfidat me të cilat përballen institucionet kompetente të Republikës së Kosovës, të mandatuara për ndriçimin e fatit të personave të zhdukur. Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur, në përputhje me kompetencat dhe mandatin, ka vazhduar organizimi dhe mbajtja e takimeve të rregullta të Komisionit, mbi 11 takime të Komisionit (nga të cilat 8 takime të rregullta dhe 3 takime të jashtëzakonshme), si dhe një sërë takimesh me akterët vendor dhe ndërkombëtar të përfshirë në procesin e ndriçimit të fatit të personave të zhdukur.

Gjatë këtij viti janë mbi 20 aktivitete gjermuese në terren, të realizuara nga ekspertët mjekoligjor vendor dhe të EULEX-it, përfshijnë 16 lokacione në territorin e Republikës së Kosovës dhe 2 lokacione në territorin e Serbisë.

Nga 16 lokacionet në territorin e Republikës së Kosovës, duhet theksuar se 8 lokacione, apo 50% nga numri i përgjithshëm i lokacioneve të proceduara gjatë këtij viti, kanë rezultuar me gjetje të mbetjeve mortore, përfshirë këtu lokacionet si: Varrezat myslimane në Mitrovicë; Lokacioni në fshatin Pjetershan, Komuna e Gjakovës; lokacioni në fshatin Leshan, Komuna e Suharekës; lokacioni në varrezat e qytetit të Prizrenit; lokacioni në varrezat ortodokse në fshatin Budisalc, Komuna e Klinës; si dhe tri lokacione apo raste të iniciuara në adresim të keq-identifikimeve të

mundshme, si: lokacionin në fshatin Hodonovc, Komuna e Kamenicës; lokacioni në fshatin Pastasel, Komuna e Rahovecit; dhe lokacioni në fshatin Krushë e Vogël, Komuna e Prizrenit.

Ndërsa, në Serbi, siç u potencua edhe më lartë, gjatë këtij viti janë proceduar 2 lokacione (rasti i Kozarevës, Novi Pazar; dhe rasti i Kizhevakut, Rashkë), të dy këto raste të ndërlidhura me informatat dhe kërkesat e paraqitura nga Delegacioni i Kosovës, vite më parë për Delegacionin e Serbisë. Rezultati i gërmimit në lokacionin në Kozarevë, ka qenë negativ, mirëpo ky rast për Komisionin Qeveritar të Republikës së Kosovës për Persona të Zhdukur nuk ka përfunduar meqë nuk është përfshirë e tërë hapësira e shënjuar, ndërsa në lokacionin e shënjuar në Kizhevak, punimet janë duke vazhduar. Në respektim të të drejtave të familjarëve për të ditur për fatin dhe vendndodhjen e më të dashurve të tyre të zhdukur gjatë luftës, familjeve të personave të zhdukur iu janë kthyer për rivarrim mbetjet mortore të 65 personave, viktimë të luftës. Nga këto rivarrime, janë 59 identifikime të reja dhe 6 raste ribashkimi të mbetjeve mortore, të personave të identifikuar, vite më parë. Qeveria ka mbuluar, pothuajse, të gjitha shpenzimet e rivarrimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Po ashtu, gjatë këtij viti, në kuadër të procesit të rivarrimit, përkatësisht dorëzimit të mbetjeve mortore të personave të identifikuar, tek familjarët, Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur ka qenë i angazhuar dhe ka përkrahur familjet edhe në një rast të riadhesimit nga Bosnja e Hercegovina për në Republikën e Kosovës, të një personi, qytetar i Kosovës, viktimë në luftën e Bosnjës.

Në kuadër të bashkëpunimit rajonal, Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur, gjegjësisht Qeveria e Republikës së Kosovës ka luajtur një rol aktiv në përpjekjen e Komisioneve nga shtetet e rajonit, për krijimin e Listës Rajonale të Personave të Zhdukur, në mënyrë të veçantë në takimin rajonal të mbajtur më 7 - 8 maj 2015, në Mal të Zi, ku në parim është vendosur mbi 'Marrëveshjen për krijimin e kësaj Liste' dhe modalitetet se si do të procedohet tutje më 'Projektin e Listës Rajonale të Personave të Zhdukur'. Gjatë këtij viti, janë mbajtur edhe dy takime të Grupit Punues për Persona të Zhdukur, pra mes Delegacionit të Kosovës dhe Delegacionit të Serbisë, si dhe një takim i Nëngrupit Punues për Mjekësi Ligjore, në mes të të dy delegacioneve. Ndërsa, më 22 tetor 2015, është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit, në mes të Komisionit Qeveritar të Republikës së Kosovës për Persona të Zhdukur dhe Komisionit të Malit të Zi për Persona të Zhdukur, në kuadër të bashkëpunimit dhe përpjekjeve të përbashkëta për ndriçimin e fatit të personave të zhdukur, gjatë luftërave në ish-Jugosllavi.

Gjatë këtij viti, përfaqësues të Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, së bashku edhe me përfaqësuesit e Shoqatave Familjarë, kanë marrë pjesë në Sesionin e Këshillit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, të mbajtur gjatë muajit Shtator, në Gjenevë, ku Kryesuesi i Komisionit iu është adresuar të pranishmëve me një fjalë rasti. Po ashtu, në kuadër të vizitës zyrtare të realizuar gjatë muajit Mars, në Republikën e Kroacisë, me qëllim të intensifikimit të bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe Kroacisë në çështjen e personave të zhdukur, përfaqësuesit e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur së bashku me përfaqësuesit e Shoqatave Familjare, kanë marrë pjesë edhe në Konferencën e II-të Ndërkombëtare mbi Krimet e Luftës.

Edhe gjatë këtij viti, Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur, në bashkëpunim me përfaqësuesit e familjeve të personave të zhdukur dhe me përkrahjen e nën përkujdesjen e udhëheqësve më të lartë shtetërorë, kanë organizuar një sërë aktivitetesh në shënimin e 27 Prillit – Dita e të Pagjeturve të Kosovës dhe 30 Gushtit – Ditë Ndërkombëtare për Personat e Zhdukur, ku gjatë këtij viti për herë të parë është organizuar ‘Java për Personat e Pagjetur’ si dhe mbajtja e një seance të veçantë dedikuar çështjes së personave të zhdukur, të organizuar pikërisht me 27 prill.

Aktualisht, duke iu referuar të dhënave zyrtare të publikuara nga Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur, më 24 dhjetor 2015, janë të evidentuar edhe 1668 persona të zhdukur, si pasojë e luftës së viteve 1998 –’99, në Kosovë.

E fushën e cila ka për qëllim mbështetjen e Komuniteteve, Qeveria në bashkëpunim me ambasadën Norvegjeze ka përgatitur Projektin për “programin e praktikës”, janë pranuar gjithsej 605 aplikacione dhe kandidatë janë duke u intervistuar. Po ashtu Qeveria ka filluar iniciativën letër falënderimi Kryetareve të Komunave të cilit e përkrahin punën e zyrës tonë për një të ardhmen në të mirë të komuniteteve jo shumicë në Kosovë. Janë organizuar për festimin e ditëve të Komuniteteve Boshnjak, Turk, Goran, Rom, Ashkali dhe Egjiptian si dhe qeveria ka ndarë grante për organizimin e festës për këto komunitetepërmës OJQ-ve të këtyre komuniteteve. Qeveria ka përkrahur Projektin “Mbështetja e komunave të sapo formuara në veri të Kosovës përmes zhvillimit të kulturës, rinisë dhe sportit” në vlerë prej 88 000 euro.

Qeveria ka vazhduar të zbatoj marrëveshjet me Serbinë duke përfunduar Procedurat e aplikimit për punë në institucionet publike të Republikës së Kosovës për pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë që kanë diploma të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës Veriore. Po ashtu ka vazhduar bashkëpunimi me AUK-un, ku Qeveria është duke financuar studentet të komuniteteve jo shumicës dhe këtë vit është emëruar drejtori i ri i zyrës për Çështje të Komuniteteve.

Në kuadër të zbatimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve zyrtare është përpiluar koncept strategjia për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave gjuhësore dhe Plani i veprimit i kësaj strategjie.

Për sa i përket publikimit në Gazetë Zyrtare (ueb-faqe): 40 Numra të Gazetës Zyrtare, janë shtypur në formë të librit, 1 Amendament Kushtetues, 40 Ligje, 3 Tabela të Ligjit për Buxhet, 1 Njoftim për përmirësim të Ligjit, 6 Marrëveshje Ndërkombëtare të ratifikuara me ligje, 32 Marrëveshje Ndërkombëtare të ratifikuara me dekret të Presidentes, 4 Udhëzime Administrative (QRK), 13 Rregullore (QRK), 110 Vendime, Rregullore, Udhëzime Administrative e akte tjera të ministrive, 40 Vendime të Qeverisë, për shpronësime me tabela përcjellëse, 138 Vendime, Aktvendime, Aktgjykime, rregullore e akte tjera të Gjykatës Kushtetuese, 295 Vendime, Aktvendime, shpallje e akte të tjera të Gjykatave Themelore të Kosovës, 134 Vendime, Rregullore, Udhëzime Administrative e akte të tjera të Komunave, 18 Vendime dhe Udhëzime të institucioneve tjera të pavarura. Në këtë periudhë raportuese gjithsejtë janë publikuar 835 akte normative. Aktet normative janë redaktuar, lekturuar dhe

përkthyer në gjuhët përkatëse gjegjësisht janë publikuar në 5 gjuhë (shqipe, angleze, serbe, turke dhe boshnjake).

Në fushën e Barazisë Gjinore si masë e veçantë për regjistrimin e pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të dy bashkëshortëve kjo do të jetë 'Masë e veçantë e përkohshme', e cili ka afat zbatimi një vit nga hyrja në fuqi dhe ka për qëllim garantimin e të drejtave të barabarta gjinore dhe promovimin e barazisë gjinore, në fushat specifike të jetës shoqërore siç është prona, si dhe të stimuloj regjistrimin e pronave të paluajtshme të përbashkëta në emër të të dy bashkëshortëve në regjistrat publik. Janë subvencionuar pjesërisht 7 projekte të cilat kanë për qëllim ndërgjegjësimin e përgjithshëm të qytetarëve për barazi gjinore, fuqizim ekonomik të grave, si dhe të promovojnë zhvillimin e turizmit rural, dhe bujqësisë. Në vlerë prej 30.000 euro.

Në bashkëpunim me Institutin Evropian për Barazi Gjinore në Lituani (IEBGJ), të përkrahur nga ZKE në Kosovë, ka organizuar punëtori dy ditore me 04 dhe 05 Qershor me temë "*Indeksi Gjinor si mekanizëm për përfshirjen e perspektivës gjinore në politika publike*". Ekspertet nga IEBGJ prezantuan para 50 përfaqësuesve të institucioneve "*Indeksin e barazisë gjinore në BE*", teknikat dhe instrumentet që duhet të përdoren për hartimin e indeksit edhe për vendin tonë. Është prezantuar Ligji për Barazi Gjinore i amendamentuar, në pesë regjionet e Kosovës Prishtinë, Mitrovicë, Prizren, Gjilan dhe Pejë. Po ashtu, ABGJ ka mbajtur tryezë të diskutimit ku është promovuar ligji i ri, me këtë rast ABGJ ka organizuar fushatë promovuese, është publikuar Ligji, si dhe janë publikuar 1000 fletushka me sqarime adekuate për nenet e caktuara të LBGJ që janë risi: sanksionet - gjobat, buxhetimi gjinor, teknikat e aplikimit. Janë vendosur 10 billbordë në kryeqytet me mesazh promovues të Ligjit në fuqi. Është publikuar Raporti i parë Monitorues për Progresin e Implementimit të Planit të Veprimit për Zbatimin e Rezolutës 1325 "*Gratë, Paqja dhe Siguria*". Është shënuar 25 Nëntori, Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas (16 Ditët e Aktivizimit) përmes fushatës senzibilizuese, tryezë diskutimi, materiale promovuese dhe vendosjen e 10 billbordëve në qytete, me moton "*Sa vlen jeta e gruas, nënës, vajzës, motrës tuaj*". Është xhiruar dhe transmetuar një videoklip promovues për të gjithë akterët që ofrojnë shërbime për rastet e dhunës në familje, dhe linjat telefonike falas. Gjatë kësaj fushate ABGJ në bashkëpunim me UN Women ka ndriçuar ndërtesën në ngjyrë portokalli, duke iu bashkëngjitur kryeqyteteve botërore në përcjelljen e mesazhit për luftimin e fenomenit të dhunës ndaj grave dhe vajzave.

Grupi Punues për Ballafaqim me të Kaluarën dhe Pajtim (GP BmKP) ka finalizuar listën e çështjeve që do të shtjellojë secili nën-grup në hartimin e strategjisë, listë kjo e cila është përdorur si referencë kryesore në çështje substanciale, ka hartuar planin e komunikimit, ka përpiluar hartëzimin në fushën e Drejtësisë Tranzicionale dhe ka identifikuar objektivat strategjike dhe nën-objektivat, për katër (4) fushat e DT: E drejta për tu informuar, E drejta për drejtësi, E drejta për reparacione dhe fusha për Garancitë për Mospërsëritje.

Për Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore, agjencia përkatëse ka hartuar draftet e 5 rregulloreve të cilat ndërlidhen me zbatimin e rekomandimeve të dala nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA-së), dispozitat e të cilave detyrojnë Agjencinë që teknikisht të sjellë

Kornizën Ligjore të saj në përputhje me atë të BE-së dhe gjithashtu të sigurojnë zbatimin e saj. Janë hartuar dokumentet strategjike si "Strategjia për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore" dhe "Plani i Veprimit për Implementimin e Strategjisë" të cilat kanë shkuar për vlerësim te Zyra për Planifikime Strategjike në ZKM.

Agjencia ka përfunduar inventarizimin e burimeve radioaktive (duke mos përfshirë rrezet X) në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Gjatë këtij viti është bërë përditësimi i Inventarit nëpërmes 79 inspektimeve në terren për: Pajisje që gjenerojnë rrezatim jonizues; Pajisje që gjenerojnë rrezatim jo-jonizues; Mbetje radioaktive (deponi) dhe Rrufepritës radioaktiv.

Në fushën e Arkivave të Kosovës me qëllim të dhënies së udhëzimeve dhe rekomandimeve rreth menaxhimit zyrtar si dhe rregullimit e klasifikimit të lëndës arkivore tek fond krijuesit janë realizuar 487 vizita. Janë sistemuar dhe përpunuar 359m gjatësi të lëndës arkivore. Janë pastruar, dezinfektuar, restauruar dhe konservuar 804 fletë, janë lidhur 379 libra dhe 105 regjistra të fondeve arkivore, 34.900 këmishëza janë përgatitur. Është bërë indeksimi i 10.739 dokumenteve të digjitalizuara (Fondi i Vjenës dhe Deferët e Regjistratit të Prizrenit/viti H.1264-M.1847), janë digjitalizuar në data bazë 1.883 emra, skanuar 13.620 dokumente si dhe janë shërbyer diku rreth 2.363 palë. Është pranuar material regjistraturik nga fond krijues të ndryshëm si institucional ashtu edhe privat: dokumentacioni i Lidhjes së të Verbërve në Kosovë (1949-1992), raporte, harta dhe marrëveshje të ushtrisë bullgare nga hulumtimet e bëra (vitin e kaluar) në Arkivin Ushtarak të Velika Tarnovës (1913-1944), 115 dokumente mbi aktivitetin ushtarak të Mehmet Pashë Derallës (1896-1898), dokumentacioni i ish Gjykatës Komunale të Prishtinës (1960, 1965-1985), dokumentacioni i Drejtorisë Komunale të Urbanizmit në Gjilan, dokumente bashkë me fotografi të Shoqatave Humanitare dhe Kulturore në Gjilan (1990-2012), fondi i Institucionit Parashkollor "Ardhmëria I" (Gjilan), dokumentacioni i Këshillit Komunal për Financim, gjithashtu në Gjilan (1994-1996), dokumentacioni i Sekretariatit të Punëve të Brendshme në Prizren (1945-1999) i dorëzuar nga Drejtoria Rajonale Policore e Prizrenit, fotografi të shumta (Ali Podrimës, pastaj afër 200 fotografi në CD të viteve 1932 - 1952 me gjurmë të historisë së arsimit kombëtar shqiptar nga Elbasani, Gjakova dhe Shkodra), nga hulumtimet e bëra në Arkivin Shtetëror të Shqipërisë janë sjell 3486 dokumente. Është bërë pranim-dorëzimi i dokumenteve të grumbulluara nga takimet me bashkatdhetarët dhe shoqatat e shumta që vepruan në vende të ndryshme (gjatë viteve 90) projekt ky i përbashkët me Ministrinë e Diasporës. Nga Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë janë pranuar dy fonde: Drejtoria e Vakëfeve (vitet 1921-1941, 19 kuti arkivore) dhe Kuvendi i RSM-së për Kosovën (vitet 1968-1988, 29 kuti arkivore) të bartura në 12 CD. Gjithashtu, janë pranuar edhe fonde private si nga Prof. dr. Fehmi Pushkollu, Prof.dr. Ismet Dërmaku, Prof.dr. Emin Kabashi etj., përafërsisht 230m gjatësi të materialit regjistraturik.

I hulumtime arkivore janë bërë në Arkivin Shtetëror të Kroacisë dhe atë në dy fonde: Burgu Qëndror i Goli Otokut dhe Burgu i Stara Gradishtës (regjistrat e të burgosurve shqiptar) si dhe në Arkivin Historik të Kotorit ku janë hulumtuar materialet arkivore nga Shek. XIV-XVIII. Sa i përket veprimtarisë botuese-shkencore është botuar revista profesionale-shkencore nga Arkivistika dhe Historia-Vjetari Nr. 51/2015, Bibliografia e revistës Vjetari (1965-2015) si dhe libri

Drenica e Epërme dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Gjithashtu, janë organizuar dy Ekspozita: "26 Vjetori i Demonstratave për Mbrojtje të Kushtetutës së Kosovës në Gjilan" si dhe "Prishtina në fotografi të shek.XX".

Në fushën e bashkëpunimit janë realizuar vizita të ndryshme si në Arkivin Shtetëror të Maqedonisë, Malit të Zi ku pritet të nënshkruhet Marrëveshja e Bashkëpunimit, është nënshkruar vazhdimi i Protokollit të Bashkëpunimit me Drejtorinë e Vakëfeve pranë Kryeministrit të Turqisë, vazhdimi i Bashkëpunimit me Arkivin Shtetëror të Shqipërisë, janë zhvilluar bisedime me Arkivin Shtetëror të Bullgarisë rreth vazhdimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit e cila pritet të nënshkruhet në fillim të vitit të ardhshëm, vizita në Arkivin e Korçës, si dhe takimi me Agjencinë Turke TİKA.

Në fushën e Statistikave të Kosovës janë realizuar: Hartimi i raportit vjetor të punës për vitin 2014, sipas Ligjit mbi Statistikat Zyrtare duke matur performancën mbi realizimin e Planit të Punës, Raporti është aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës; Gjithashtu, sipas dispozitave Ligjore të Ligjit mbi Statistikat Zyrtare, ASK-ja ka hartuar Planin e Punës për vitin 2016, i cili është aprovuar nga Qeveria e Kosovës; ka përgatitur planin kombëtar për zbatimin e MSA-së, pjesa për statistikave; Hartimin e hartës rrugore 2016; ka vazhduar se zbatuari Programit 5 vjeçar i statistikave Zyrtare 2013-2017 përmes planit operacional vjetor sipas dinamikës së paraparë; ka vazhduar se zbatuari Rregullorja për ri-organizimin e ASK-së. Janë hartuar dy raporte analitike nga sistemi i SIPK-ut lidhur me performancën e ASK, njëri Janar- tetor 2015 dhe tjetri Janar- dhjetor 2015, qëllimi vendimmarrja e bazuar në të dhëna. Është përgatitur draft Ligji për regjistrimin e popullsisë dhe bujqësisë në 4 komunat veriore të Republikës së Kosovës të cilat nuk kanë marrë pjesë në regjistrimin e popullsisë 2011. Po ashtu, janë bërë ndryshimet e nevojshme në plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit mbi statistikave Zyrtare si dhe është bërë ndryshimi dhe plotësimi i UA/nr. 08/2012 sipas kërkesave të ZAP-it. Draft Ligjet dhe UA, tashme janë dërguar në zyrën e kryeministrit për procedim të mëtejshëm.

Statistikat sektoriale - janë publikuar raportet statistikore sipas kalendarit të paraparë në fillim të vitit. Të dhënat statistikore (Publikimet) të publikuara mbulojnë fusha socio-ekonomike, bujqësisë, shëndetësisë, arsimit, kulturës, etj. për periudhën e raportimit në fushën e statistikave ekonomike janë publikuar 70 publikime statistikore, në fushën e statistikave sociale dhe të popullsisë 20 publikime, në fushën e statistikave të bujqësisë dhe ambientit 13 publikime si dhe publikime të përgjithshme si Vjetari Statistikor 2015, Kosova në shifra, etj. Në shtojcën e -I-, të bashkëngjitur gjeni Listën e Publikimeve të realizuara nga 1 Janar - 31 Dhjetor 2015.

Regjistrimi i Bujqësisë 2014, është bërë publikimi i rezultateve preliminare dhe përfundimtare të regjistrimit të bujqësisë 2014. Në rezultatet finale janë publikuar "Të dhënat kryesore" dhe "Raporti i cilësisë" ndërsa deri në fund të vitit 2015 janë përgatitur si draft final "publikimet speciale" (tematike) mbi pemëtarinë, vreshtarinë dhe Kulturën e arave si dhe "Raporti final" mbi Projektin e regjistrimit të bujqësisë. Anketa e grupimeve të treguesve të shumëfishtë 2013/2014 (AGTSH) - të dhënat e publikuara kanë dy dimensione: të dhënat e publikuara "në nivel vendi" dhe të dhënat për "komunitetin RAE".

Statistikat ekonomike: Publikimet, në baza vjetore: Llogaritë Qeveritare 2014, Bruto Produkti Vendor ne qasjen e shpenzimeve dhe të prodhimit për vitin 2014, Statistikat e Tregtisë së Jashtme 2014, Indeksi i Çmimeve të Konsumit 2014, Rezultatet e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve 2014.

Publikimet në baza tremujore: Indeksi i Çmimeve të Importit TM4-2014 deri TM2-2015, Indeksi i Çmimeve të Prodhimit TM4-2014 deri TM3-2015, Indeksi i kostos së ndërtimit TM4-2014 deri TM3-2015, Statistikat e Hotelierisë TM4-2014 deri TM3-2015, Statistikat e tregtisë me pakicë TM4-2014 deri TM3-2015, Statistikat e industrisë TM4-2014 deri TM3-2015, Bilanci i Energjisë në Kosovë TM4-2014 deri TM3-2015, Repertori i Ndërmarrjeve në Kosovë TM4-2014 deri TM3-2015, Statistikat e Transportit TM4-2014 deri TM3-2015 dhe Bruto Produkti ne dy qasjet TM3-2014 TM3-2015.

Publikimet në baza mujore: Indeksi i Çmimeve të Konsumit për periudhën Dhjetor 2014 deri Nëntor 2015, Statistikat e Tregtisë së Jashtme, për periudhën Dhjetor 2014 deri Nëntor 2015.

Statistikat Sociale dhe të popullsisë: Rezultateve të Anketës së Fuqisë Punëtore, 2014, Rezultateve të Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare, 2014, Statistikat e Arsimit 2014/2015, statistikat e Jurisprudencës për persona madhore 2014, statistikat e Jurisprudencës për persona të Mitur 2014, statistikat e Shëndetësisë 2014, statistikat e Kulturës, 2014, statistikat e Mirëqeniës Sociale 2014, statistikat e lindjeve, 2014; statistikat e vdekjeve, 2014; statistikat për shkaqet e vdekjeve, 2012/2013; gratë dhe burrat, 2012/2013 (çdo dy vjet); statistikat kurorëzime, 2014; statistikat për shkurorëzime, 2014; vlerësimin e popullsisë, 2014. Raporte ne baza tremujore, statistikat e mirëqenies sociale për TM1, TM2 dhe TM3/2015. Publikimi i statistikave te arsimit sipas niveleve te arsimit për vitin arsimor 2014/2015; Publikimi i statistikave te arsimit 2014/2015, realizimi i pilot anketës së SILCU-ut.

Statistikat e bujqësisë dhe të ambientit: Indeksi tremujor i çmimeve të prodhimeve dhe çmimet në bujqësi, TM4-2014; Indeksi tremujor i çmimeve të inputeve dhe çmimet në bujqësi, TM4-2014; Indeksi vjetor i çmimeve të prodhimeve dhe çmimet në bujqësi, 2010 – 2014, (2005 = 100); Indeksi vjetor i çmimeve të inputeve dhe çmimet në bujqësi, 2010 – 2014, (2005 = 100); Indeksi tremujor i çmimeve të prodhimeve dhe çmimet në bujqësi, TM1-2015; Indeksi tremujor i çmimeve të inputeve dhe çmimet në bujqësi, TM1-2015; Indeksi tremujor i çmimeve të prodhimeve dhe çmimet në bujqësi, TM2-2015; Indeksi tremujor i çmimeve të inputeve dhe çmimet në bujqësi, TM2-2015; Indeksi tremujor i çmimeve të prodhimeve dhe çmimet në bujqësi, TM3-2015; Indeksi tremujor i çmimeve të inputeve dhe çmimet në bujqësi, TM3-2015; Anketa e mbeturinave industriale 2014; Anketa e mbeturinave komunale 2014; 'Disa Fakte mbi Mjedisin'' 2015; Në fushën e metodologjisë dhe TI, janë realizuar këto aktivitete si në vijim: Në bashkëpunim me Statistikat e Suedisë ka filluar Projekti për Dokumentimin e Produkteve Statistikore në sistemin e Metadateve ESMS. Me këtë sistem është punuar në 11 produkte statistikore (nga Statistikat ekonomike dhe te llogarive kombëtare).

Në kuadër te Projektit te binjakëzimit në përkrahje të sistemit statistikor të Kosovës është punuar dhe janë shënuar rezultate të mira në përmirësimin e sistemit statistikor me theks të

veçantë në kualitetin e statistikave, llogarive kombëtare, statistikave të biznesit, disiminimit dhe teknologjisë informative. Sa i përket infrastrukturës së IT-së, progres i dukshëm është arritur në shumë fusha. Të gjithë serverët për prodhim janë virtualizuar, duke përfshirë ASKData, eDAMIS dhe platformën e UN për shpërndarja e të dhënave DevInfo.

Dokumentimi për sistemin e IT është krijuar. Ky dokumentim për ASK-në, si organizata me fond dhe mbështetje të kufizuar, është një aset i veçantë. Çdo ndryshim i bërë në sistemin e IT-se, dokumentacioni është duke u përditësuar.

Në fushën e shpërndarjes - disiminimit në bashkëpunim me Statistikat e Danimarkës është punuar në hartimin e strategjisë dhe politikës së disiminimit. Me mbështetjen e projektit të binjakëzimit me statistikave daneze, është lansuar platforma për shpërndarjen e të dhënave online ASKData. ASK, mëton që deri në vitin 2017, të gjitha të dhënat të shpërndahen përmes kësaj platforme. Strategjia dhe Politika e Shpërndarjes (Diseminimit), tashmë është krijuar dhe është online në web faqen e ASK-së.

Sistemi i Informatave Gjeografike (GIS), ka azhurnuar qarqet regjistruese për komunat veriore si dhe në vazhdimësi ka krijuar harta tematike për tema të ndryshme statistikore, e në veçanti për rezultatet e regjistrimit të bujqësisë.

Për të mbajtur kodin burimor në një sistem të mirë të kontrollit, Team Foundation Server (TFS), është instaluar. Ekipi i zhvillimit të softuerit është trajnuar nga ekspertet e SIDA-së, se si të përdorin dhe është bërë konfigurimi i tij. Për herë të parë është zhvilluar Softueri për Anketën e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore 2015 duke u bazuar në TFS.

Instalimi i TFS në ASK ka lehtësuar mënyrën e programimit, ngase ekspert të ndryshëm të projektit mund të punojnë së bashku në mënyrë më efektive. Anëtarët e ekipit mund të ndajnë planet e projektit, produktet e punës, dhe vlerësimet e progresit. Gjithashtu, duke përdorur TFS, kodi burim është backup.

Puna e krijimit e një Politikë të detajuar të sigurisë tashmë ka filluar në ASK. Lidhur me backup, pasi është instaluar dhe konfiguruar Data Protection Manager (DPM), shumica e dosjeve dhe bazave të të dhënave janë backup. Ende punë duhet për backup afatgjatë dhe kthim në rast të ndonjë fatkeqësie.

Zhvillimi i mëtejshëm për sistemin SIPK është bërë në përputhje me kërkesat e menaxhimit të ASK-së. Një program i ri për PPI është zhvilluar dhe është duke u përdorur nga sektori i çmimeve. Gjithashtu, një software të ri për IMPI është zhvilluar dhe janë në fazën e testimit.

Në fushën e sigurisë së Ushqimit dhe Veterinarisë gjatë vitit janë hartuar dhe përgatitur këto akte nënligjore, Rregullorja QRK nr. 03/2015 për Vendosjen e standardeve minimale për mbrojtjen e derrave; Rregullorja QRK nr. 05/2015 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores nr. 17/2012 për Caktimin e Lartësisë së Pagesës së shërbimeve dhe kontrolleve zyrtare të AUV; Rregullorja QRK nr. 10/2015 për Kushtet shëndetësore të kafshëve të Akuakulturës, produkteve të tyre si dhe parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve të kafshëve akustike; Udhëzimi

Administrativ MBPZHR nr. 05/2015 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ MBPZHR nr. 15/2014 për vendosjen e kafshëve të gjalla në Karantinë; Udhëzimi Administrativ MBPZHR nr. 06/2015 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ MBPZHR nr. 12/2012 për Identifikimin dhe Regjistrimin e kafshëve.

Në fushën e Shëndetit Publik Qeveria ka bërë Aprovimin e operatorëve të biznesit me Ushqim me origjinë shtazore: qumështore 6; thertore të gjedheve 2; fabrika të përpunimit të mishit 8, Depo Ftohëse 2, Objekte tjera 6, Regjistrimi i OBU – ve me prejardhje jo shtazore (Fabrika për përpunimin dhe grumbullimin e pemëve dhe perimeve 22, Fabrika për përpunim të konzervateve 2, Fabrika të Verës dhe Birrës 7, Furra Buke dhe pjekurinave 11, Fabrika për ripaketim 12, Fabrika për përpunim të melmesave 4, Fabrika të ujit dhe lëngjeve 6.

Në kuadër të Programit të vaksinimit të kafshëve shtëpiake janë kryer vaksinime kundër këtyre sëmundjeve: kundër Tërbimit janë vaksinuar 23,700 qenë, kundër Antraksit janë vaksinuar 1,979 gjedhe dhe 893 dele dhe dhi, kundër Murtajës Klasike të Derrave janë vaksinuar 19,896 derra, kundër Brucellozës janë vaksinuar 67,724 dele dhe dhi dhe kundër Murtajës Atipike të Shpezëve janë vaksinuar 2 milion pula. Në kuadër të çrrënjësjes së sëmundjes Ethet Hemorragjike, është bërë repelimi i 61,669 gjedheve dhe 41,523 dele dhe dhive. Në kuadër të testimit të kafshëve, 17.724 gjedhe janë testuar në tuberkulozë dhe 16.843 gjedhe në mastit. Si rezultat i paraqitjes së sëmundjeve ngjitëse tek kafshët janë asgjësuar; 50 gjedhe të sëmura nga *Brucella abortus*, 493 dele dhe 166 dhi të sëmura nga *Brucella melitensis* dhe 393 familje bletësh të sëmura nga Pesta Amerikane. Gjatë këtij viti janë matrikuluar: 77,859 gjedhe, 86,217 dele, 10,527 dhi dhe 21,057 derra, lëvizje të raportuara: 18,418 gjedhe, 21,394 dele, 3,449 dhi dhe 20,194 derra.

Gjatë periudhës raportuese janë inspektuar:

Inspektorati Fitosanitar i brendshëm – ka kryer 2.991 inspektime, ka lëshuar 55 fitocertifikata për qarkullim të brendshëm, 3.945 fitocertifikata për eksport, 40 vendime, 81 fletëparaqitje ka marrë 1.740 mostra.

Inspektorati Fitosanitar i kufirit - ka kryer 38.556 inspektime, 19 ngarkesa janë refuzuar , 371 ngarkesa janë blombuar dhe ka marrë 1154 mostra.

Inspektorati Veterinar i brendshëm – ka kryer 1244 inspektime, ka lëshuar 1150 certifikata për transport të brendshëm, ka inspektuar 3926 therrije, ka lëshuar 70 akt-vendime dhe ka marrë 995 mostra, janë konfiskuar 262 gjedhe, 8 kuaj, 20 familje bletësh, 255 dele dhe 1397 pula.

Sektori Veterinar i kufirit – ka inspektuar 11822 lëndë, janë importuar 13146 kafshë për therrije, ka refuzuar 3 ngarkesa, janë marrë për analiza 423 mostra.

Inspektorati Sanitar – ka kryer 2645 inspektime, ka nxjerrë 8 vendime, 215 fletëparaqitje, 75 pëlqime sanitare, ka shqyrtuar 124 ankesa të konsumatorëve dhe ka marrë 237 mostra e 720 strisho. Për arsye të afateve të skaduara, mungesës së dokumentacionit adekuat janë asgjësuar 542.677 kg dhe 1.356.819 litra të lëngjeve.

Aktivitetet në Laboratorin e Ushqimit dhe Veterinarisë: Gjatë këtij viti në laboratorët e LUV, janë pranuar ky numër i mostrave; Patologjia dhe EU DCE projekti janë të pranuar 528 mostra dhe janë kryer 528 teste, Bakteriologjia dhe parazitologjia janë pranuar 229 mostra dhe janë kryer 229 teste, Serologjia dhe KAHIL projekti janë pranuar 11518 mostra dhe janë realizuar 12000 teste, Analizat e qumështit janë pranuar 17548 mostra të cilat janë analizuar në 3 parametra me numër të analizave prej 50000, Kimia ushqimore dhe mbetjeve veterinerë ka pranuar 624 mostra, ku janë realizuar 2885 teste në parametra të ndryshme, Mikrobiologjia Ushqimore ka pranuar 422 mostra të cilat janë analizuar në parametra të ndryshëm dhe numri i testeve të realizuara ka qenë 1600.

Në kuadër të plotësimit të kornizës ligjore **Ministria e Financave** nga gjithsej 27 Projektligje, përfshirë këtu edhe Projektligjet për Ratifikimin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare, 17 Projektligje janë miratuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe janë proceduar për miratim në Kuvend. Prej tyre 9 (nëntë) Ligje janë dekretuar dhe publikuar ndërsa 11 (njëmbëdhjetë) gjenden në shqyrtim në komisionet parlamentare. Po ashtu, ka sponsoruar 6 Udhëzime Administrative të cilat janë miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ndërsa Ministri i Financave ka miratuar 3 (tri) Udhëzime Administrative dhe 1(një) Rregullore.

Dogana e Kosovës - Të hyrat nga Dogana për vitin 2015 ishin 951,808,000 euro, që krahasuar me vitin 2015 janë për 80,830 me të larta. Përveç, mbledhjes së të hyrave Dogana është përkujdesur edhe për të përmbushur rolin e saj në krijimin e lehtësirave për bizneset duke bërë ndryshimin e udhëzimeve administrative si dhe infrastrukturës aktuale: Udhëzimi Administrativ (UA) për shpenzimet e transportit, Vendimi për tatimin e akcizës në Lojërat e fatit, Vendimi për tatimin e akcizës në derivatet e naftës-gazit natyror, Vendimi për tatimin e akcizës në fishekzjarrë, Vendimi për tatimin e akcizës në cigare.

Për këtë periudhë raportuese **Administrata Tatimore e Kosovës** ka mbledhur të hyra në shumë prej 332,772,000 euro që krahasuar me vitin 2014 janë për 29,077,00 euro me shumë. Gjatë 2015 ATK ka pajisur me arka fiskale gjithsej 22.360 biznese ndërkaq rimbursimi i mjeteve nga Kuponat Fiskal ka arritur shumën e përgjithshme prej 737, 750 euro duke përfutur kështu gjithsejtë 45.355 qytetarë.

Pas hyrjes në fuqi të pakos së re fiskale gjithsejtë janë aprovuar 152 aplikacione me ç'rast bizneset janë liruar nga TVSH-ja me rastin e importit të lëndës së parë e cila shfrytëzohet në procesin e prodhimit.

Gjithashtu, të drejtën për importimin e makinerive të prodhimit, lëndës së parë që shfrytëzohet për procesin e prodhimit dhe pajisjeve të teknologjisë së informacionit e kanë shfrytëzuar gjithsej 163 kompani.

Sa i përket tregut me letra me vlerë, janë zhvilluar 21 ankande për shitjen e letrave më vlerë. Nga to, 14 ankande ishin për të ri-financuar maturimet, kurse 7 ankande ishin për të emetuar instrumente të reja.

Gjithashtu, përveç vazhdimit të emetimit të instrumenteve 3, 6, 12 muaj dhe 2 vjeçare janë, me sukses në këtë vit janë emetuar obligacione me maturitet 3 dhe 5 vjeçare. Në rrafshin e

investitorëve, këtë vit baza është zgjeruar edhe më tutje, duke shtuar si investitorë kompanitë e sigurimeve dhe Bankën Qendrore.

Me qëllim të rritjes së efikasitetit në raportimin e shpenzimit të parasë publike janë ndërmarrë një sërë veprimesh në menaxhimin efikas dhe ngritjen e infrastrukturës së sistemeve informative të menaxhimit të financave publike.

Për financimin e projekteve janë nënshkruar 10 marrëveshje financiare me IFN, me një shumë totale prej rreth 143 milion euro, ku dominon investimi në infrastrukturë transportuese dhe efikasitet të energjisë, me nga 111 dhe 30 milion euro përkatësisht.

Gjithashtu, kemi negociuar edhe një marrëveshje garancioni për një kompani publike që kap vlerën 10 milion euro.

Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2016 është miratuar në Kuvendin e Kosovës sipas afatit ligjor. Buxheti është në linjë të plotë me objektivat e Qeverisë për rritje të qëndrueshme ekonomike dhe qëndrueshmëri fiskale.

Buxheti arrin që t'i financojë kërkesat me prioritete të secilës organizatë buxhetore dhe njëkohësisht ta ruaj stabilitetin buxhetor që është parakusht për rritje të qëndrueshme ekonomike. Të hyrat e rregullta buxhetore për vitin 2016 janë planifikuar në masë prej 1 miliard e 598 milionë, buxhet i cili përfaqëson një rritje prej 4.1% në raport me buxhetin e rishikuar për vitin 2015 dhe një rritje prej rreth 19% me buxhetin e realizuar të vitit 2014.

Për vitin 2016, parashihen shpenzime bazë në vlerë prej 1 miliard e 674 milionë euro (përfshirë 'Shpenzimet nga grantet e përcaktuara te donatorëve').

Buxheti për vitin 2016 është plotësisht i harmonizuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Qeveria ka aprovuar Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2016-2018, me të cilin dokument është informuar Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Sa i përket menaxhimit më efektiv dhe transparent të Financave Publike, janë përgatitur raportet mujore të gjendjes së projekteve kapitale dhe në baza ditore janë përgatitur raportet për gjendjen e të hyrave, shpenzimeve dhe bilancin bankar. Si pjesë e verimeve të marra për të përmirësuar menaxhimin e financave publike, në baza mujore është përgatitur raporti mbi Performancën e të Hyrave dhe Shpenzimeve buxhetore.

Në fushën e Politikave Ekonomike Qeveria për herë të parë është ftuar nga Komisioni Evropian si shtet kandidat para-aderimit në BE, ka dorëzuar Programin për Reforma në Ekonomi. Ky program para së gjithash paraqet kornizën makro fiskale dhe sfidat me të cilat ballafaqohet Kosova për ngritjen e aftësisë konkurruese të vendit.

Qeveria ka hyrë në negociata me FMN-në dhe rrjedhimisht ka nënshkruar një program Stand-by për një periudhë 22 mujore dhe të gjitha kriteret strukturore dhe kuantitative të përcaktuara me programin SBA, janë përmbushur me sukses dhe në afat nga Ministria e Financave. Si rezultat, është disbursuar mbështetja financiare në vlerë prej 35 milionë euro në korrik të këtij viti dhe 35 milionë euro në dhjetor të këtij viti.

Gjatë kësaj periudhë është arritur që të nënshkruhen këto marrëveshje për bashkëpunim: për Rehabilitimin e Linjës Hekurudhore 10 me EBRD-në në vlerë 39.9 milionë euro; për Rehabilitimin e Linjës Hekurudhore 10 me EIB-në në vlerë prej 42 milionë eurove; për

Bashkëpunim Financiar me Qeverinë Federale të Gjermanisë për vitin 2014 për pjesën grant dhe kredi (pjesa e grantit është ratifikuar ndërsa ajo e kredisë jo); për Bashkëpunim Ekonomik me Emiratet e Bashkuara Arabe (është përcjellë për ratifikim); me Qeverinë Austriake nga programi për kredi të Buta për Projektin “Modernizimi i shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës” (është përcjellë për ratifikim); dy marrëveshje me KfE-në për Projektin “Përmirësimi i sistemit të ngrohjes komunale”, respektivisht njëra 4 milionë euro, ndërsa tjetra 1,47 milionë euro (janë përcjellë për ratifikim); me Bankën Botërore për Projektin e “Përmirësimit të Sistemit të Arsimit në Kosovë” (është përcjellë për ratifikim); për METD me Britaninë e Madhe (është përcjellë për ratifikim); me Zvicëranët për zbatimin e Marrëveshjes për Furnizim me ujë të Pijshëm për Zona Rurale. Ndërsa, kanë përfunduar negociatat për marrëveshjet për METD me Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Kroacinë.

Ministria e Financave ka bashkëpunuar me Ministrinë e Integritimit Evropian për të themeluar Këshillin Kombëtar të Investimeve (KKI), i cili është një nga kriteret e BE-së për bashkëfinancim. Ministria e Financave ka luajtur rol kyç në përgatitjen dhe konfirmimin e aplikacionit për grant nga BE lidhur me financimin deri në 51% të Rehabilitimit të Linjës Hekurudhore 10. Është përpiluar për herë të parë Lista Prioritare e Projekteve për sektorët e transportit, mjedisit dhe energjisë.

Këshilli Kombëtar i Investimeve ka dërguar në EBIF 3 aplikacione për studim të fizibilitetit, të cilat janë aprovuar. Nga këto tri kërkesa që janë aprovuar, për herë të parë janë ndarë 1.5 milionë euro nga EBIF për të bërë studimin e fizibilitetit për Kanalin e Ibër-Lepencit përgjatë pellgut të lumit Lepenc.

Qeveria është në proces të negociimit të Marrëveshjes Kornizë për bashkëpunim ekonomik me Qeverinë Gjermane, e cila do të zëvendësojë marrëveshjet e ish-Jugosllavisë dhe vendos bazë të re më të afërt të bashkëpunimit teknik dhe financiar.

Është arritur që të hapen negociatat për eliminimin e tatimit të dyfishtë me vendet ku kemi diasporë të madhe respektivisht me Qeverinë e Austrisë dhe Zvicrës, si dhe ka vazhduar komunikimi me Qeverinë Italiane, Luksemburgut dhe Francës.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka ndërmarrë veprime dinamike përgjatë gjithë vitit 2015 sa i përket përmbushjes së objektivave strategjike dhe realizimit të planit të punës, përkatësisht Programit të Qeverisë 2015-2018. Të gjitha objektivat dhe masat e parapara në planin qeverisës janë adresuar duke qenë në përputhshmëri me afatet kohore të parapara në planin për zbatimin e programit të Qeverisë 2015-2018.

Në kuadër të Politikave Tregtare Konkurruese dhe Përmirësimi i Mjedisit të të Bërit Biznes-Hapja e Tregut dhe Integrimi në Tregjet Rajonale dhe Globale janë realizuar takime në selinë e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) si dhe janë bërë përgatitje për fillimin e procesit të aplikimit për anëtarësim, është realizuar pjesëmarrja në takimet e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC), është arritur të anëtarësohemi në komitetin për investime të Evropës Juglindore, si dhe kemi marrë pjesë aktivisht në nëngrupet e turizmit, procesimit të ushqimit dhe të investimit.

MTI ka mbikëqyrur implementimin e strategjisë së Evropës Juglindore 2020. Në këtë drejtim, gjatë këtij viti janë rishikuar indikatorët dhe targetet, po ashtu në fillim të vitit në bashkëpunim

me OECD-në dhe Këshillin për Bashkëpunim Rajonal është organizuar një takim me komunitetin e biznesit, shoqërinë civile, mediat dhe institucionet relevante.

Ratifikimi dhe Marrëveshja për Tregti të Lirë me Turqinë pritet të bëhet nga Parlamenti i Kosovës.

Është nënshkruar Marrëveshja për Stabilizim Asociim (MSA) me BE-në. E njëjta, është ratifikuar në Kuvendin e Kosovës në nëntor 2015. Është punuar në përgatitjet rreth implementimin të marrëveshjes: Plani implementues 2016-2020 është draftuar.

Negocimi i shërbimeve në CEFTA - Është bërë përgatitja e pozicioneve të Kosovës në negociatave lidhur me shërbimet, ku gjatë këtij viti kanë përfunduar 5 raunde të negociatave nga gjithsej 6 raunde. Në raundin e parë dhe të dytë janë negociuar shërbimet e biznesit dhe profesionale; në raundin e tretë shërbimet e turizmit, mjedisit dhe rekreative; në raundin e katërt shërbimet e komunikimit dhe ndërtimit; në raundin e pestë shërbimet e distribuimit, arsimin dhe shëndetësore. Raundi i gjashtë i negociatave pritet të përfundoj në Mars 2016 ku do të negociohen shërbimet financiare, transportit dhe audiovizuale.

Është realizuar pjesëmarrja në takimet e organizatave të specializuara të infrastrukturës së cilësisë.

Raportet tregtare me Shqipërinë - Për adresimin e barrierave tregtare janë organizuar takime me krerët më të lartë të shtetit dhe ministrat relevantë të qeverisë së Shqipërisë, ku janë ngritur një sërë rastesh të barrierave të ndryshme tregtare më të cilat bizneset kosovare ballafaqoheshin, të tilla si:

- Pamundësia për të eksportuar vezë në tregun e Shqipërisë - Kjo çështje tanimë është zgjidhur dhe mbeten të shihen rezultatet e para të eksportit;
- Pamundësia për të eksportuar produktet farmaceutike për shkak të mosregjistrimit të produkteve në Agjencinë e barnave të Shqipërisë - Kuvendi i Shqipërisë tanimë ka amendamentuar Ligjin për produkte farmaceutike i cili ishte paraqitur si barrierë kryesore më parë dhe kjo do t'i mundësoj kompanive kosovare të regjistrojnë produktet farmaceutike në Agjencinë e barnave në Shqipëri dhe për t'i eksportuar dhe pasur qasje të plotë në tregun shqiptar;
- Aplikimi i çmimeve referente ndaj disa produkteve kosovare - Shqipëria ka siguruar se do të eliminoj aplikimin e një barriere të tillë dhe nuk kemi indikacione se janë aplikuar përsëri ato;
- Çështja e tahografëve e cila ishte një barrierë a kahershme për transportuesit kosovarë - Sa i përket kësaj çështjeje ministritë/agjencitë relevante të të dyja vendeve kanë rënë dakord për tekstin e marrëveshjes dhe vetëm pritet nënshkrimi i saj, e cila do të eliminoj plotësisht këtë barrierë për transportuesit kosovarë.

Funksionalizimi i Zonave të Lira Ekonomike-Për të ndihmuar komunat në funksionalizimin e Zonave Ekonomike në rajone të ndryshme të Kosovës, janë ndërmarrë veprimet si në vijim: Është bërë finalizimi i punëve rreth Parkut të Biznesit në Drenas; Për Inkubatori i biznesit në Parkun e Biznesit në Drenas është shpallur konkursi për hapësirat (zyrat) e që t'u jepet

bizneseve fillestare, një restoranti dhe një institucioni financiar; Për Zonën Ekonomike në Mitrovicë, gjatë vitit 2015 janë ndarë 200.000,00 euro për të investuar në nivelizimin e terrenit në këtë zonë dhe është investuar në dy faza (faza e tretë dhe faza e katërt); Zona ekonomike - Shtime, në pjesën e parë të vitit, MTI ka ndarë 100,000.00 euro për ndërtim të infrastrukturës, e cila ka përfunduar në pjesën e parë të vitit, derisa në pjesën e dytë të vitit MTI ka ndarë edhe 150,000.00euro tjera, me të cilat janë duke u realizuar punimet në ndërtim të infrastrukturës; Zona ekonomike - Suharekë, Agro zona Industriale në Samadraxhë, është krijuar këtë vit dhe nga MTI janë ndarë 110,000.00 euro për ndërtim të infrastrukturës, me të cilat janë duke u realizuar punimet në ndërtim të infrastrukturës; Inkubatori i Biznesit në Komunën e Istogut, Qeveria i ka ndarë Komunës së Istogut 70,000.00 euro për të përkrahur ndërtimin, respektivisht renovimin e një qendre të dedikuar për Inkubator të Biznesit.

Eliminimi i Barrierave dhe Zvogëlimi i Burokracisë - Në kuadër të politikës tregtare, është punuar në eliminimin e barrierave tregtare. Gjatë këtij viti janë organizuar takimet e 4 nëngrupeve punuese: nëngrupi punues për bujqësinë, industrinë, shërbimet dhe lehtësimin e tregtisë.

Me qëllim të eliminimit të barrierave administrative dhe ligjore për ofruesit e shërbimeve, është punuar rreth Ligjit për shërbimet; është aprovuar në Qeveri koncept-dokumenti për shërbimet, dhe ligji pritet të finalizohet gjatë vitit 2016. Gjithashtu, është realizuar ueb-platforma elektronike "Raporto Barrierat" e cila është funksionale. Platforma elektronike, tashmë ua mundëson bizneseve kosovare të kenë shumë më të lehtë adresimin e barrierave tregtare gjatë eksportit, importit apo kalimit tranzit të mallrave të tyre.

Në kuadër të pakos së re fiskale MTI ka asistuar Ministrinë e Financave në procesin e reformave fiskale (hyrë në fuqi nga 1 shtatori 2015) dhe lehtësirave doganore për nxitjen e prodhimit vendor. Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve, ka bërë zvogëlimin dhe eliminimin e shumicës së taksave dhe pagesave për shërbimet e ofruara nga ky institucion shtetëror.

ARBK, ka punuar me ATK-në dhe Doganat rreth funksionalizimit të plotë të sistemit të integruar për regjistrimin e Bizneseve. Janë ofruar zgjidhje me qëllim të vazhdimin dhe përmirësimit të mëtutjeshëm të shërbimit të regjistrimit, dhe pajisjen e Bizneseve me numra fiskal dhe certifikatë të TVSH-ës dhe numrit të Export- Importit. Në ndërkohë kemi bërë rishikimin dhe analizën e sistemit aktual të sistemit të regjistrimit me qëllim të unifikimit të numrit të regjistrimit në një ID të vetme. Raporti është përgatitur dhe analizat, plani dinamik i propozuar dhe rekomandimet janë në fazën finale.

Përkrahja e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme- Me qëllim të lehtësimit të qasjes në financa për NVM-të, është përgatitur Projektligji për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore (i cili është në shqyrtim të dytë Kuvend), është bërë ndarja e granteve financiare nga fondi i përbashkët me BE-në, në vlerë totale prej 4 milion €. Nga ky projekt, 20 ndërmarrje mikro kanë përfituar ndihmë financiare deri në 25.000 € dhe 16 ndërmarrje të vogla dhe të mesme kanë përfituar shuma deri 200.000 €.

Në kuadër të Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik të Kosovës (KKZHE) i cili është ri-funksionalizuar, MTI në bashkëpunim me ZKM, ka mbajtur katër takime deri tani, ku janë

marrë një sërë vendimesh të rëndësishme dhe adresuar shumë kërkesa të bizneseve përkitazi me eliminimin e barrierave dhe përmirësimin e klimës së të bërit biznes.

Gjithashtu, është punuar me prioritet në implementimin e Aktit Evropian për Biznes të Vogël, dhe për këtë qëllim, në kuadër të Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik është formuar nëngrup i veçantë i punës i cili merret vetëm me implementimin e plotë të Aktit Evropian për Biznes të Vogël; Është rritur intensiteti i ofrimit të shërbimeve të këshillimit të NVM-ve përmes "Skemës Voucher". 154 ndërmarrje kanë përfutuar nga këto shërbime. Kjo skemë ofron këshillime të subvencionuara në vlerë prej 80% të vlerës totale të këshillimeve; Në kuadër të Programit "Internship Biznesi 2015" është bërë përzgjedhja e 150 studentëve që kanë filluar praktikën e tyre në ndërmarrjet e ndryshme kosovare. Kjo do t'i ndihmojë studentët në gjetjen e mundësive të punësimit dhe krijimit të përvojave të para të punës; Me qëllim të fuqizimit të Grave në Ndërmarrësi, është mbështetur nga MTI Panairi "Gratë në Biznes 2015" mbajtur në Prishtinë, ku kanë marrë pjesë mbi 60 kompani të udhëhequra nga gratë; MTI ka punuar ngushtë me NVM-të duke thelluar dialogun e përbashkët me to; MTI i ka informuar bizneset rreth reformave me qëllim të përmirësimit të kushteve për zhvillimin dhe rritjen e NVM-ve të ndërmarra nga Qeveria e Kosovës. Në kuadër të Ditëve të Biznesit të Vogël, janë realizuar nëntë konferenca informuese me bizneset (NVM-të) në 7 rajone të Kosovës, si dhe në nivel kombëtar, ku janë diskutuar çështje konkrete që kanë të bëjnë me zhvillimin e sektorit privat, shërbimet që ofrohen nga Qeveria dhe donatorët, si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel lokal, si dhe projektet e donatorëve për zhvillimin e sektorit privat. Barrierat e prezantuara nga bizneset, janë adresuar nëpër grupe përkatëse punuese, dhe kur ka qenë e nevojshme ato janë adresuar edhe në nivel të KKZHE-së. Në kuadër të këtyre konferencave, është realizuar gara 'Top NVM-ja më konkurruese', e shoqëruar me Ceremonitë e ndarjes së çmimeve për ndërmarrjet nga 7 rajonet e Kosovës.

Promovimi i Investimeve - Gjatë vitit 2015 është punuar për krijimin e një ambienti sa më të favorshëm për zhvillimin e biznesit dhe investimeve në Kosovë, duke krijuar politika të favorshme ekonomike dhe duke punuar në eliminimin e barrierave që pengojnë klimën e të bërit biznesit në Kosovë.

Gjatë këtij viti janë regjistruar 428 biznese me pronarë të huaj, ku në krahasim me vitin e kaluar ky numër ishte vetëm 278. Rritje në regjistrim kemi edhe te kompanitë vendore. Derisa shuarjet e bizneseve kanë shënuar trend më të ulët krahasuar me tri vitet e kaluara.

Sipas të dhënave nga BQK, Investimet e Huaja Direkte në periudhën janar – tetor 2015 janë rreth 270 milionë euro, që paraqet një rritje të konsiderueshme krahasuar me 3 vitet e fundit 2012-2014.

Me qëllim të gjetjes së tregjeve të reja për kompanitë kosovare, MTI në bashkëpunim me donatorët ka përkrahur dhe realizuar pjesëmarrjen e ndërmarrjeve të ndryshme nëpër panairë ndërkombëtare (sikurse në: Londër, Berlin, Koln, Izmir, etj.). MTI ka mbështetur ekspozimin e kompanive kosovare edhe në panairët vendore (panairët dhe aktivitetet promovuese të organizuara nga Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Bizneseve).¹⁶

¹⁶ Aktiviteti 1.4.1.3 dhe 1.4.1.7

Hartimi i Udhëzuesve Praktik lidhur me Infrastrukturën e Cilësisë dhe shtyllat e saj si dhe sektoret që mbulohen nga MTI.

Janë organizuar vizita të ndryshme me rrjetet e bizneseve në diasporë, si në Vjenë, Cyrih, Dyseldorf, Këln dhe vende të tjera për t'i siguruar bashkatdhetarët tanë se MTI-ja do të jetë gjithmonë një derë e hapur dhe do të luaj rol in avokues për të gjitha bizneset, duke lehtësuar procesin e investimeve dhe të zhvillimit të afarizmit në Kosovë.

Me qëllim të promovimit të mundësive që ofron vendi për investime, KIESA ka marrë pjesë në gjashtë (6) konferenca, tri (3) forume, një (1) vizitë studimore dhe një (1) punëtori-panair.

Janë rifreskuar dhe dërguar broshura dhe materiale promovuese në: Gjermani, Bullgari, Itali, Slloveni, Austri, Zvicër, Emiratet e Bashkuara Arabe, Angli, Holandë dhe Amerikë.

Janë ofruar shërbime për 62 kompani të huaja të interesuara rreth potencialeve investuese. 13 kompanive të huaja – investitorëve potencial u është ofruar asistencë direkte duke filluar nga regjistrimi i biznesit si dhe procedurave tjera.¹⁷

Janë zhvilluar negociatat për nënshkrimin e marrëveshjeve për mbrojtje dhe promovim të investimeve me: Slloveninë, Shqipërinë, Kanadanë dhe Bullgarinë.

Zhvillimi i Turizmit- Lidhur me Projektin për Zhvillimin e Qendrës Turistike të Brezovicës, sa i përket kontratës me konsorciumin MDP Consulting – Compagnie des Alpes, Qeveria i ka përmbushur deri më tani të gjitha obligimet e saj kontraktuale për periudhën tranzitore.

Është në proces të finalizimit, botimi i broshurës promovuese “Kosova nga Ajri,” projekt i MTI-së, i financuar nga donatorët.

Është finalizuar Plani Zhvillimor për Sektorin e Turizmit dhe Plani i Veprimit (Strategjia e Turizmit), që do të jetë pjesë e Strategjisë për Zhvillimin e Sektorit Privat 2016-2020, të MTI-së.

Është realizuar studimi për Vlerësimin e potencialeve turistike – për Rajonin jugor, i hartuar me asistencë të UNDP-së.

Përmirësimi i Infrastrukturës Ligjore - Ligji Nr. 05/L-039 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-029 për Patenta dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-026 për Markat Tregtare janë miratuar në Kuvend,

Projektligji për themelimin e fondit kosovar për garanci kreditore, Projektligji për Dizajnin Industrial dhe Projektligji për treguesit gjeografik dhe për emërtimet, janë në shqyrtim të dytë në Kuvend. Ndërsa, Projektligji për Investime Strategjike në Republikën e Kosovës dhe Projektligji për falimentim, janë miratuar në Qeveri.

Aktet Nënligjore të Nënshkuara-Udhëzimi Administrativ Nr.01/2015 Për formën dhe përmbajtjen e regjistrimit të investimeve të huaja, dt. e nënshkrimit 04.03.2015;

2. Udhëzim Administrativ Nr.02/2015 Për periudhën verifikuese të mjeteve matëse ligjore, mënyra e zbatimit si dhe periudhat ri-kalibruese për etalonët të cilët përdoren për verifikimin e mjeteve matëse ligjore, dt. e nënshkrimit 01.07.2015;

¹⁷ Aktiviteti I.4.2.3

3. Udhëzim Administrativ Nr.03/2015 Për përcaktimin e taksave për shërbimet e ofruara nga Agjencia për regjistrimin e Bizneseve, dt. e nënshkrimit 21.07.2015;

4. Udhëzim Administrativ Nr.04/2015 Për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2013 Procedurat dhe mënyra e testimit të miratimit të tipit të mjetit matës, dt. e nënshkrimit 28.08.2015;

5. Rregullore Nr. 01/2015 Për punën e këshillit kombëtar për zhvillim ekonomik të Kosovës, dt. e nënshkrimit 04.06.2015.

Është miratuar Koncepti dokumenti për tregtinë me shërbime.

Rregullimi i Tregut të Brendshëm dhe Infrastruktura e Cilësisë - Sa i përket tregut të naftës, është bërë regjistrimi me GPS i të gjitha pikave shitëse të karburanteve në vend. Është arritur rezultat i lartë në formalizimin e pikave shitëse të karburanteve: Numri i pikave të shitjes të licencuara është rritur në 522 sosh. Po ashtu, numri i pikave të kalibruara është 522. Kanë mbetur vetëm edhe 30 pika pa u licencuar për shkak të mos kompletimit të dokumentacionit për shkak të problemeve pronësore.

MII nëpërmjet Inspektoratit të Tregut ka bërë inspektime të vazhdueshme për kontrollimin e cilësisë së derivateve të naftës. Aktualisht, Inspektorati i Tregut këtë detyrë e ushtron nëpërmjet trupave të autorizuar dhe laboratorëve të akredituar dhe MTI po punon në rritjen e numrit të kontrolleve të cilësisë së naftës dhe të produkteve të saj. Janë rritur ndjeshëm kontrollat e jashtëzakonshme, nga 7 sa ka qenë në 47 kontrolle.

Duke marrë parasysh praktikën më të mira të vendeve të rajonit ka blerë pajisje laboratorike që do t'ia mundësojë Inspektoratit të Tregut që të bëjë vizita *ad-hoc* në tregun e brendshëm (nëpër pika individuale të derivateve të naftës) dhe të bëjë matjen e parametrave kryesorë (dhe të vlerave korrelative të tyre) për matjen e cilësisë të naftës dhe benzinës si dy produktet më të shitura nga kjo kategori.

- MII, përmes, Agjencisë së Metrologjisë, ka realizuar verifikimin e mbi 522 pikave shitëse të karburanteve, respektivisht ka verifikuar mbi 4443 dorëza.
- Janë tërhequr nga tregu, asgjësuar 215 copë pajisje: Llompë e lëvizshme për fëmijë të pasigurta për shkak të mos përmbushjes së kërkesave themelore të sigurisë.
- Aktvendime për konfiskim të mallit: 22.
- Shqyrtimi i Ankesave të Konsumatorëve: 85.

Agjencia e Metrologjisë ka intensifikuar ushtrimin e Kontrollit ligjor të mjeteve matëse ligjore në qarkullim publik. Ka pasur rritje të shërbimeve metrologjike, respektivisht rritje të numrit të verifikimeve/kalibrimeve për të gjitha instrumente matëse për fushat e metrologjisë siç janë: masa, vëllimi dhe rrjedhje, temperaturë dhe lagështi, kontrolli i cilësisë së punimeve të metaleve të çmuara.

Drejtoria e Akreditimit e Kosovës (DAK) ka rritur numrin e Trupave të Vlerësimit të Konformitetit të akredituara. Janë kryer: 22 Mbikëqyrje të rregullta (18 Laborator Testues dhe 4 Trupa Inspektues); 10 Vlerësime (8 Laborator Testues dhe 2 Trupa Inspektues); 13 Akreditime (11 LT dhe 2 TI), (9 akreditime fillestare, 3 ri-akreditime, një zgjerim fushe, 3 laborator të Agjencisë së Forenzikës); 13 Aplikime për akreditim (12 LT dhe 1 TI). 1 Pezullim i akreditimit.

Agjencia për Pronësi Industriale, ka mbajtur vizitën e parë për treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës për përfaqësuesit e institucioneve përgjegjëse për këtë sistem; Janë bërë raportime tek MIE dhe Komisioni Evropian për progresin e arritur në API dhe për të gjitha raportet që është kërkuar; Është mbajtur një Takim i Këshillit Shtetëror për Pronësi Intelektuale me të gjithë anëtarët e këtij Këshilli; Janë mbajtur takimet e rregullta të Task Forcës kundër Piraterisë; Është punuar në regjistrin online të objekteve të pronësisë industriale; Është instaluar IPAS në Serverin e ri, i ndarë dhe i posaçëm për Agjencinë e Pronësisë Industriale. Kjo ka rezultuar që IPAS të jetë më i shpejtë dhe më i sigurt. Agjencia e Pronësisë Industriale ka vazhduar aktivitetin e saj në pranimin dhe evidentimin e aplikimeve për objekteve të pronësisë industriale: Marka Tregtare, Patentave, Dizajne Industriale, kundërshtime të markave të publikuara, hulumtime të markave tregtare, patentave, ekzaminime të parakohshme, vazhdime, ndryshime, kërkesa për mbajtje në fuqi, dokumente të përparësisë, ndërrim përfaqësuesi, autorizime gjeneral, autorizime për lëndë përkatëse, ankesa në komision të ankesave, vendime të komisionit të ankesave dhe dokumentacione tjera shtesë.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik - është angazhuar në krijimin i mjedisit të favorshëm ligjor, rregullator, si dhe hartimin e dokumenteve strategjike për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve.

Në kuadër të **Sektorit të Energjisë** është finalizuar drafti i Strategjisë së Energjisë të Republikës së Kosovës 2015-2024; *drafti i Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Republikës së Kosovës 2015-2017*; *Janë hartuar nëntë (9) Plane Komunale për Eficiencë të Energjisë 2015-2020*; Është miratuar (a) Balanca e Energjisë të Republikës së Kosovës për vitin 2016 (parashikimet), (b) Balanca Vjetore e Energjisë Elektrike për vitin 2016 (parashikimet), dhe (c) Balanca Vjetore e Energjisë e Republikës së Kosovës për vitin 2014. Me qëllim të përkrahjes së sektorit të eficiencës së energjisë, është finalizuar studimi lidhur me krijimin e fondit për eficiencë të energjisë, me qëllim të reduktimit të konsumit të energjisë elektrike përmes zbatimit të masave për kursim.

Sektori i Minierave- Është miratuar nga MZHE Raporti i Progresit për vitin 2014 lidhur me Programin për Zbatimin e Strategjisë Minerare 2012-2014; është hartuar Programi për Zbatimin e Strategjisë Minerare 2015-2017; është miratuar Planit për Menaxhimin e Resurseve Minerale (PMRM) për vitin 2015 dhe ka filluar hartimi i Planit për Menaxhimin e Resurseve Minerale (PMRM) për vitin 2016.

Sektori i TIK-Është finalizuar draftit i Strategjisë së Kosovës për Teknologji.

Me qëllim të përkrahjes së sektorit të Teknologjisë së Informacionit, është finalizuar studimi lidhur me krijimin e fondit për sektorin e Teknologjisë së Informacionit me qëllim të krijimit të mjedisit më të favorshëm për zhvillim dhe investime në këtë sektor.

Miratimi i kornizës ligjore dhe zbatimimi - Projektligji për Energjinë, Projektligji për Rregullatorin e Energjisë janë miratuar në Qeveri dhe është pjesërisht në përputhje me Direktivën 2009/72/EC. Projektligji për Gazin Natyror, është miratuar në Qeveri dhe është në përputhshmëri me Direktivën Nr. 2009/73/EC për rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror dhe Rregulloren Nr.715/2009/EC për kushtet e qasjes në rrjetet e bartjes të gazit natyror. Ky projektligj është miratuar në lexim të parë në Kuvendin e Kosovës.

Projektligji për Energjinë Termike, është miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ky Ligj është pjesërisht në përputhshmëri me Direktivën Nr. 2009/28/EC lidhur me promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme”.

Sektori i Minierave - Është miratuar Rregullorja Nr.01/2015 për sistemin informativ unik për resurset minerale. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, gjithashtu është angazhuar për implementim të Programit të Zbatimit të Strategjisë Minerare, krijimin e mjedisit të favorshëm ligjor, nxitjen e shfrytëzimit të qëndrueshëm dhe pasurimit të resurseve minerale në bazë të standardeve ndërkombëtare.

Sektori i TIK-Ligji Nr. 05/L-027 për Digjitalizimin e Transmetimeve Radio Difuzive Tokësore është miratuar në Kuvendin e Kosovës, Udhëzimi Administrativ (MZHE) Nr.01/2015 Për Rregullat për Ushtrimin e Kontrollit të Operatorëve Postar, është miratuar. Udhëzimi Administrativ (MZHE) Nr.02 /2015 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.04/2012 për Pulla Postare- është miratuar.

Sektori i Ndërmarrjeve Publike – janë miratuar në Kuvendin e Kosovës Ligji Nr.05/009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligji për ratifikimin e marrëveshjes bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për Projektin e bashkëpunimit për zhvillim “KSV/018: Mbështetje institucionale dhe teknike për sistemin e furnizimit me ujë në rajonin e Mitrovicës” dhe Ligji Nr.05/L-008 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-035 për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Pasurisë së Tyre.

Projekt - Rregullore për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores nr.02/2013 Mbi kriteret për krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe Pjesëmarrja e Komunave në Bordet e drejtorëve të Ndërmarrjeve Rajonale të ujit, është proceduar në Qeveri për shqyrtim dhe miratim.

Zbatimi i Projekteve në Sektorin e Energjisë.

Projekti TC Kosova e Re - KDP ka aprovuar raportin dhe është vlerësuar oferta financiare.

Qeveria ka negociuar kthimin në kapital (ekuiteti) në shifrën prej 21.5 % të IRR-së (krahasuar me 23% - 27% të kërkuar nga CG).

Termocentrali do të ndërtohet me një bllok të vetëm super-kritik me qymyr, me efikasitet jo më të ulët se 37 % dhe kapacitet elektrik bruto prej 500 MW, duke arritur të balancohet pranueshmeria e efektit në tarifat e energjisë elektrike dhe sigurimi i furnizimit me energji për vendin. Blloku gjenerues komisionohet më 2022. Projekti nuk parasheh kontribut financiar të Qeverisë.

KDP ka shpallë investitorin Contour Global si Investitor i Preferuar. Ndërsa, në muajin dhjetor është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Investitorit Contour Global. Nivelë i investimeve kapitale parashihet të jetë afërsisht 1 miliardë Euro.

Faza e Post Privatizimit të KEDS – Në kuadër të përmbushjes së obligimeve që dalin nga kontrata e Privatizimit ka përfunduar shturja ndërmjet divizioneve të distribucionit dhe furnizimit (KEDS /KESCO). Rezultat i këtij procesi është kompania KESCO e licencuar për furnizim me energji elektrike.

Sa i përket marrëveshjes për punëtorë - (Marrëveshja për zbatim) e cila garanton kontratat e punëtorëve për periudhë 3 vjeçare që nga data e privatizimit - nuk janë evidentuar largime të punëtorëve nga puna.

Plani i investimeve - Sipas raportimeve nga KEDS dhe nga raportet e ZRRE-së, KEDS që nga viti 2013 janë investuar rreth 55 milionë Euro, që do të thotë se është duke zbatuar plani investiv 5 vjeçar 2013-2017 të aprovuar nga ZRRE në vlerë prej 107 milion Euro. Kjo është në përputhje me nenin 4.14 që thotë se KEDS duhet të investojë në periudhë 15 vjeçare shumën prej 300 milionë Euro.

Projekti për EE dhe BRE i financuar nga Banka Botërore në formë të huamarrjes - Marrëveshja është ratifikuar në Parlamentin e Kosovës dhe shuma investuese është 31\$Mln. Janë përgatitur dizajnet për 5 ndërtesat e para për zbatim të masave të EE dhe pas përfundimit të procedurës së prokurimit, pritet të fillojë zbatimin i masave përkatëse. Projekti i fushatës publike promovuese për BRE dhe EE, ka përfunduar.

Në kuadër të Projekti Zbatimi i Masave të Eficiencës së Energjisë në ndërtesat e shërbimit publik, programi mbështetës për Auditimin Energjetik (2015-2017), është realizuar. Nga projekti kanë përfituruar 5 shkolla në komunat e Kosovës dhe në kuadër të projektit për vitet në vijim, pritet të përfitojnë edhe një numër i konsiderueshëm i shkollave të Kosovës.

Sektori i Minierave - Ka përfunduar Projekti "Studimi gjeologjiko-gjeokimik, gjeomjedor dhe resurset gjeoturistike të zonës së Gashit".

Realizimi i mbështetjes financiare nga Buxheti i Republikës së Kosovës, destinuar për "Trepça" në kategorinë ekonomike të Subvencioneve dhe Investime Kapitale për vitin 2015 është 4,812,870.00 €.

Subvencioneve nga Buxheti i Republikës së Kosovës, destinuar për Trepça-AKP është 3,082,870.00 €. Trepça-AKP - jugu për vitin fiskal 2015, shuma e paguar 2,158,009.00 €. Trepça-AKP - veri për vitin fiskal 2015, shuma e paguar 924,861.00 €.

Investimeve Kapitale nga Buxheti i Republikës së Kosovës përmes MZHE, destinuar për Trepça-AKP është shuma 1,730,000.00 €.

Trepça-AKP - jugu përmes investimeve kapitale janë realizuar dy projekte në: (1) Projekti: Hapja e vend punishteve të reja në horizontet X-XI në minierën "Trepça" në Stan Tërg. Vlera e projektit për vitin 2015 - 635,000.00 €. (2) Projekti: Riaftësimi i vend punishteve në horizontin VIII dhe IX. Vlera e projektit për vitin 2015 - 700,000.00 €.

Trepça-AKP - veriu në investimet kapitale është realizuar një projekt: Projekti "Instalimi i pajisjeve për filtrim dhe aparaturave për përmirësim të teknologjisë dhe kushteve të punës në rafineri - Zveçan". Vlera e projektit për vitin 2015 - 400,000.00 €.

Përgatitja e pasaportës për zonën e interesit të veçantë "Zhegoc" dhe "Dabëllde të shpallur nga Qeveria e Republikës së Kosovës të cilat do të jenë udhërrëfytes për hulumtime të detajuara për investime të mëtejme.

Në bashkëpunim me UNDP-në është bërë rregullimi i tërësishëm i stacioneve sizmike dhe mirëmbajtja e serverëve "GeoHub" dhe "SeisComp".

Sektori i TIK -Projekti Bashkë-shfrytëzimi efikas i resurseve të Infrastrukturës telekomunikuese (KOSTI) - Bazuar në këtë studim është përgatitur edhe metodologjia dhe modeli financiar i përlogaritjes së çmimit për shfrytëzimin e infrastrukturave në dispozicion të tyre.

Zhvillimi i sistemit të atlasit elektronik për infrastrukturën telekomunikuese brezgjere në Kosovë (ky projekt është komponentë e projektit të sipërpërmendur) – që si rezultat ka pas studimin dhe më pastaj rekomandimin në formë udhëzuesi të detajuar për zhvillimin e sistemit të atlasit elektronik për infrastrukturën telekomunikuese brezgjere në Kosovë, që do të zhvillohet Brenda MZHE-së.

Projekti për zhvillimin e infrastrukturës brezgjere në zonat rurale (475,000 \$) – që si rezultat ka pasur raportin e detajuar bazuar në studimin e detajuar të tregut të brodbendit, analizën teknike të hendeqeve të infrastrukturës ekzistuese, analizën financiare dhe në formulimin e rekomandimeve.

Programi i Pullës Postare - Komisioni për Pullë Postare (KPP) ka përgatitur Programin e Pullës Postare për vitin 2016. KPP po ashtu ka zhvilluar aktivitetet e rregullta për përzgjedhjen e motiveve dhe dizajneve fituese, si dhe miratimin e mostrave të para të pullës postare nga Programi i Pullës Postare për vitin 2015.

Ndërmarrjet Publike-Është investuar në: Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në rrugët: Fetah Gega dhe Kadri Nesho 50,000; Linja e Ujit të pijes nga baseni i Radoniqit, Faza e II-të - LINJA ANADRINI 250,000; Vendosja e ujëmatësve nëpër zona 130.000; Rehabilitimi dhe zgjerimi i ndërtesës së shërbimit teknik 117,074; Ndërrimi i gyp sjellëseve primar dhe sekondar – Ferizaj 192,460; Ndërtimi i Pendës në fshatin Dubovë – Pejë 50,000; Kanali Derivues i Basenit të Radoniqit 300,000; Ndërtimi I kanalit të Isniqit 258,460; Kanalizimi në qytetin e Pejës 83,766; Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në pjesën qendrore të Prizrenit 150,000; Projekti për ujë dhe kanalizim në zonat rurale të Kosovës faza 5A – RËSPP 3,000,000; Renovimi i pajisjeve të rrjetit VPN 300,000; Riparimi i lokomotivave-ri fabrikimi 1,091,859; Furnizim me pajisje dhe mjete pune për mirëmbajtjen e linjave hekurudhore 701,087; Furnizimi me pjesë rezervë të infrastrukturës 268,913; Renovimi i urave dhe tuneleve në linjat hekurudhore 100,000; Subvencionimi i skemës sociale për familjet në nevojë 3.500.000,00 Euro; Ngrohja Qendrore e Gjakovës: 500.000,00 Euro, Subvencione për blerje të mazutit; Uji dhe Hedhurinat: 625,000,00, Subvencione për mbulim të kostos së humbjeve të ujit të pijes.

Trainkos 500,000,00 euro dhe Infrakos: 600.000,00 euro për subvencione për mbulim të kostove të transportit publik.

Ministria e Infrastrukturës -Projekti për Autostradën R6 Gjilan – Dheu i Bardhë, kompania projektuese ka dorëzuar projektin preleminar të Autostradës. Projekti zbatues pritet të përfundoj në gjysmën e parë të vitit 2016.

Në bashkëpunim me ËBIF dhe BERZH-in, ka filluar plotësimi i studimit të fizibilitetit dhe ndikimit mjedisor për segmentin Kijevë – Zahaq (30 km) si dhe plotësimi i projektit zbatues.

Është publikuar njoftimi i përgjithshëm i prokurimit (General Procurement Notice) dhe në fillim të pjesës së dytë të vitit të ardhshëm pritet të kryhet procesi i përzgjedhjes së operatorit. Gjatë këtij muaji (dhjetor) pritet të emërohet Njësia për Implementimin e Projektit.

Duhet të ceket se kanë qenë 64 projekte kapitale me anë të së cilave janë asfaltuar 35.55 km rrugë nacionale dhe 21.50 km rrugë rajonale, dhe në bashkëfinancim me komuna janë asfaltuar 81.2 km rrugë lokale.

Programi i rregullt i sinjalizimit horizontal dhe vertikal i rrugëve nacionale dhe rajonale dhe g) në vazhdimësi është bërë edhe kontrolli i rregullt i ngarkesave boshtore dhe shënimet nga

numëruesit automatikë për vëllimin e trafikut. Janë lëshuar 412 aktvendime për transport të jashtëzakonshëm, janë kryer 3300 kontrollat të peshave boshtore dhe prej tyre 275 fletëparaqitje për gjykatë.

Në planin legjislativ: *Ligji për patent shofer është miratuar në lexim të parë në Kuvend dhe Ligji për rregullat e komunikacionit rrugor është dorëzuar në Qeveri dhe pritet të miratohet*) dhe Rregullorja për Organizimin e brendshëm është miratuar në Qeveri. Janë nënshkruar gjashtë UA nga Ministri.

Janë licencuar dhe rilicencuar 99 autoshkolla, 861 shofer instruktor dhe 131 ligjërues. Qendra të kontrollës teknike janë rilicencuar tetë (8). Kandidatë të testuar për patentë shofer nga pjesa teorike 54357 me kalueshmëri 29227 apo 53.70% dhe nga praktika 36367 me kalueshmëri 28197 apo 77.47%. Testimi elektronik është në procedurë të zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit i cili do të funksionalizohet në fillim të vitit vijues ndërkaq nëpër njësit e patentë shoferëve është bërë instalimi i kamerave.

Në fushën e transportit përveç UA të nënshkruar, MI është marrë me krijimin e ambientit të favorshëm dhe të sigurt për ngritjen e cilësisë të shërbimeve në transport, përkrahjen financiare sipas planifikimit të buxhetit për NP "Trainkos" me qëllim të funksionit të qëndrueshëm të vijës hekurudhore Prishtinë-Klinë-Pejë-Prishtinë dhe Prishtinë- Hani i Elezit-Prishtinë.

Është zhvilluar aktiviteti i prokurimit dhe është lidhë kontrata për transportin humanitar me autobus në linja të ndryshme brenda vendit, gjejmësisht tetë linja të transportit.

Janë iniciuar nëntë marrëveshje bashkëpunimi me vendet e BE-së në fushën e transportit, marrëveshje bilaterale është nënshkruar në mes Hungarisë dhe Kosovës, katër marrëveshje janë miratuar nga Qeveria e Kosovës të cilat pritet të miratohen nga vendet e përkatëse. Në fushën hekurudhore është nënshkruar huamarrja prej EBRD-së dhe EIB-së për zhvillimin dhe rehabilitimin e rrjetit hekurudhor linja 10. Aktualisht është bërë përzgjedhja e kompanisë për hartimin e projekt dizajnit të linjës 10 hekurudhore Fushë Kosovë – Hani i Elezit.

Janë realizuar 482 inspektime në rrugët publike, 1149 inspektime në transportin rrugor, 422 inspektime në qendrat e kontrolleve teknike dhe 1071 inspektime në auto-shkolla.

Në sezonin veror janë bërë 12 aprovime për fluturime të programuara për Avio Kompanitë Ajrore nga Turqia dhe Zvicra, për sezonin dimëror janë bërë 8 aprovime për fluturime të programuara për Avio Kompanitë Ajrore nga Turqia dhe Zvicra, janë licencuar 5 Avio Kompani Ajrore të cilat kanë hyrë në tregun e Kosovës për herë të parë, dhe gjithashtu të drejta të trafikut i janë mundësuar të zhvillojnë edhe 16 Avio Kompanive të BE-së dhe 174 fluturime të miratuara të lëshuar për Avio Kompanitë Ajrore si fluturimeve charter.

Është miratuar Strategjia për siguri në komunikacionin rrugor, si rrjedhojë nga strategjia janë mbajtur tri takime të Këshillit për siguri në komunikacionin rrugor, është realizuar fushatë vetëdijësuese, Projekti "stop vdekjes nga aksidentet", shënimi i ditës botërore për përkujtimin e viktimave nga aksidentet rrugore, është bashkëpunuar me Policinë e Kosovës për ngritjen e vetëdijësimin në trafik, mbajtja e ligjëratave në 158 shkolla fillore duke përfshirë 25 komuna, shpërndarja e fletëpalosjeve dhe broshurave, si në pikat kufitare ashtu edhe nëpër shkolla.

Është mbajtur takimi sektorial në kuadër të Dialogut të Procesit të Stabilizim Asociimit "Infrastruktura" me përfaqësuesit të Komisionit Evropian. Është përgatitur plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dala nga takimet sektoriale. Nga asistenca teknike në kuadër të TAIFEX-it, është realizuar "Draftimi i Doracakut për Shqiptim të Gjobave ndaj Aviokompanive dhe Agjencioneve jo Përgjegjëse Ndaj Pasagjerëve". Është aprovuar Strategjia Sektoriale dhe e Transportit Multi Modal.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka vazhduar të zbatoj politikat programore në mbështetje të fermerëve, avancimit të sektorit të bujqësisë në përgjithësi si dhe menaxhimit të ruajtjes së pyjeve. Këto politika programore këtë vit kanë avancuar dhe kanë qenë në harmoni me Planin e Qeverisë.

Këtë vit, buxheti për bujqësi ishte dyfish më i madh së në vitin 2014, gjë që ka mundësuar që ne të rrisim dhe zgjerojmë përkrahjen për fermerët në skemën e subvencioneve dhe granteve, përkundër obligimeve të mëdha të bartura nga viti i kaluar. Janë 43 milionë euro të cilat për vitin 2015 janë ndarë në dy skemat mbështetëse, në pagesa direkte 23 milionë dhe 20 milionë në grante investive. MBPZHR-ja ka hartuar ligje të rëndësishme dhe bazike për sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë, si dhe dhjetëra udhëzime administrative për nënsektorë. Bashkëpunimi rajonal ndërkombëtar mbetet një prej hallkave të rëndësishme të implementimit të programeve tona dhe bashkëpunimi është avancuar dhe janë eliminuar barrierat tregtare për produktet bujqësore.

Grantet Investive

Skema e granteve investive është një nga politikat zhvillimore që ka avancuar e siguruar qëndrueshmëri për agrobiznesin. Edhe këtë vit mbështetja është rritur dhe zgjeruar. Në vitin 2015 janë ndarë grante për rreth 390 ferma dhe agrobiznese në shumë sektorë, dhe të orientuar në prodhim, përpunim, diversifikim dhe ujitje.

Për këto rreth 390 ferma dhe agrobiznese janë ndarë nga MBPZHR-ja rreth 20 milionë euro dhe duke pasur parasysh se skema jonë e mbështetjes parasheh projekte në bashkë investim, atëherë investimi nga sektori privat përfitues në skemë është rreth 12 milionë euro, që në total investime në projekte zhvillimore në agro-biznes sivjet janë 32 milionë euro. Ky investim ka gjeneruar 2500 vende të reja pune të sigurta në sektorin e bujqësisë, dhe të cilët do të jenë edhe të regjistruar si të punësuar. Mesatarja e grantit është 50 mijë euro. Nga ky program pritet të rritet prodhimi primar tek pemët dhe perimet, ku dukshëm janë shtuar mbjellje të reja të pemëve manore dhe drufrutore si dhe rritje të sektorit të mishit, me hapjen e fabrikave të reja përpunuese, si dhe të shtohet ngritja e serrave.

Pagesat Direkte - Subvencionet

Është rritur deri në 50 për qind subvencionimi për shumë kultura bujqësore dhe blegtori si dhe janë shtuar kultura të reja që subvencionohen nga MBPZHR-ja. Është rritur subvencionimi për krerë të lopëve qumështore, nga 50 në 70 euro. Është rritur subvencionimi për grurin, misrin dhe lulediellin në 150 euro për secilin nga 125 dhe 100 sa ka qenë në vitin 2014. Për dele dhe dhi është rritur subvencionimi për krerë nga 10 euro në 15 euro. Ndërkaq janë shtuar kultura të reja subvencionimi, siç është subvencionimi i pemëve me nga 400 euro për hektar dhe therjet e

raportuara të gjedhit, nga 30 euro për krerë. Ndërkohë ka vazhduar edhe subvencionimi për perime në fushë të hapur nga 300 euro për hektar si dhe subvencionimi për qumështin sipas cilësisë, dhe për pulat vojse dhe bletë. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim edhe me Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB), që zbaton programet mbështetëse ka arritur që këtë vit të realizojë me sukses pagesat e subvencioneve, dhe tashmë ato u janë bërë secilit fermer përfitues. Numri total i përfituesve në skemën e pagesave direkte është 36 786 fermerë.

MBPZHR-ja ka rritur transparencën në raport me publikun. Këtë vit për herë të parë kemi publikuar dy procese të vlerësimit të granteve, listat preliminare dhe listat finale me emrat dhe shumat e mbështetjes për fermat dhe agrobizneset përfituese. Gjithashtu, qysh në momentin e hapjes së fazës së aplikimit janë shpallur publike të gjitha procedurat dhe kriteret e vlerësimit. Po ashtu edhe listat e përfituesve të subvencioneve janë publikuar në ueb faqen e ministrisë në momentin e vlerësimit të aplikacioneve. Kemi urdhëruar kontrolla dhe superkontrolla me qëllim të inspektimit të projekteve që janë mbështetur si dhe janë realizuar me kohë pagesat për përfituesit.

Këtë vit janë rritur aktivitetet promovuese për prodhimet vendore përmes organizimit të panairëve për prodhimet të ndryshme, si në pemë, perime, bletari, blegtori, etj., dhe duke mbështetur organizimin e panairëve të mëdha ndërkombëtare në Kosovë. Gjithashtu, janë organizuar edhe aktivitete të ndryshme alternative që kanë pasur për qëllim të nxisin interesimin e të rinjve tanë që të merren me bujqësi, si festival të verës dhe rrushit, gara të fotografisë për bujqësinë, etj.

MBPZHR ka vazhduar të avancojë shërbimet këshillimore në bujqësi, si një nga elementet kyçe për zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e sektorit. Në këtë drejtim janë miratuar udhëzime të rëndësishme administrative për shërbimet këshillimore, që mundësojnë një qasje moderne dhe bashkëpunim publiko privat në dhënien e shërbimeve. Për herë të parë është hapur ueb faqja publike për shërbime këshillimore, [ëë.keshillabujqesore.com](http://www.keshillabujqesore.com).

Ministria ka hartuar Projektligjin e ri për Pyjet i cili është gati për miratim në Qeveri. Ai do të mundësojë një menaxhim efikas dhe do të sigurojë masa të mëdha ndëshkuese për prerësit ilegal. Gjithsesi edhe këtë vit, mbrojtja ka avancuar dhe ka rënë prerja ilegale, por ajo ende mbetet një sfidë. Janë përgatitur dhjetëra dosje për në organet e hetuesisë për shkelësit e ligjit. Ka vazhduar implementimi i programeve për ripyllëzim dhe këtë vit janë ripyllëzuar 400 hektar me pyje. Këtë vit kemi pasur situatë mjaftë të mirë të menaxhimit të zjarreve nëpër pyje dhe për dallim nga vendet e tjera të rajonit në Kosovë ka pasur shumë pak zjarre, e edhe ato të cilat kanë ndodhur janë shuar dhe lokalizuar. Kjo ka ndodhur falë një bashkëpunimi mes të gjitha institucioneve. Për ripyllëzim dhe mbrojtje të pyjeve sivjet kemi angazhuar në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale rreth 1000 punëkërkues, të cilët janë angazhuar për 9 muaj dhe janë paguar me pagë 250 euro në muaj.

Këtë vit janë eliminuar disa barrierat që kanë qenë mes Kosovës dhe Shqipërisë në raport me produktet bujqësore. Është miratuar certifikata fitosanitare për importin e vezëve dhe tashmë eksporti i tyre për në Shqipëri nuk është i penguar. Është hequr çmimi referent dhe limiti i sasisë së eksportit të rrushit për në Shqipëri. Gjithashtu, jemi në finalizim të unifikimit të

standardëve të miellit, të cilat presim t'i realizojmë vitin e ardhshëm. Vlen të theksohet se këtë vit nuk ka pasur bllokadë për këtë sektor apo sektorë tjerë.

Regjistrimi i bujqësisë dhe analizat sektoriale

Realizimi i aktiviteteve të ndërlidhura me publikimin e rezultateve preliminare dhe finale të Projektit për Regjistrimin e Bujqësisë, ku është ngushtë me ASK-në dhe të dhënat e para preliminare janë publikuar me 28 Shkurt ndërsa rezultatet finale me 26 nëntor të këtij vitit. Në kuadër të analizave sektoriale janë kryer analizat ekonomike të drithërave me ç'rast janë përgatitur bilancet e furnizimit si dhe janë përgatitur publikimet për këto kultura: grurin, mollë, dredhëz, kumbull, rrush, mish, qumësht, spec, patate, po ashtu është përgatitur edhe raporti analitik për kredi rurale. Gjithashtu, është përgatitur dhe publikuar raporti për FADN për vitin 2015. Është përgatitur dhe publikuar analiza mbi ndikimin e politikave dhe orientimin e politikave të reja, dhe/apo riorientimin e politikave ekzistuese. Finalizim i raporteve të kërkuara nga Komisioni Evropian për eksportin dhe importin e produkteve bujqësore të Kosovës me shtetet anëtare të BE-së, për të gjitha produktet bujqësore në nivel të kodeve 2 shifror dhe në nivel të kodeve tetë (8) shifror si dhe finalizim i tabelës me gjendjen e Bilancit Tregtar për produktet bujqësore 2007-2014 në nivel të kodeve dy (2) shifror.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural gjatë periudhës raportuese i ka arritur edhe këto prioritetet, të cilat kanë qenë edhe pjesë e angazhimit tonë të përditshëm, e të cilat janë si më poshtë:

1. Përgatitja e Programit të Reformës Ekonomike për sektorin e Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2016. Ky program është përgatitur në përputhje me prioritetet e MBPZHR-së, me planet strategjike të Qeverisë së Kosovës, në pajtim të plotë me Politikën e Përbashkëta Bujqësore të BE-së, si dhe merr për bazë realizimin e obligimeve që dalin nga MSA-ja;
2. Përgatitja e Raportit të Gjellbër Kosova 2015, ky është edicioni i tretë i këtij raporti faktik, i cili i prezanton të dhëna zyrtare kredibile në të cilin pasqyrohen ndryshimet strukturore në sektorin agro rural;
3. Përgatitja e Programit vjetor kombëtarë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2016. Ky program është përgatitur bazuar në kërkesat dhe prioritetet e sektorit dhe në përputhje me Politikën e Përbashkëta Bujqësore të BE-së. Programi përbëhet nga projekt masat në vijim:
 - 3.1 Investimet në asetet fizike në ekonominë bujqësore/Masa 101
 - *Spektori i pemëve drufrutore;*
 - *Spektori për pemë manore përfshirë dredhëzën;*
 - *Spektori për Serra dhe depo për ruajtje të perimeve;*
 - *Spektori i mishit (majmëria e gjedhit dhe rritja e bojlerëve);*
 - *Spektori i qumështit të lopës, deleve dhe dhive;*
 - *Spektori i rrushit.*
 - 3.2 *Spektori i vezëve* Investimet në Agro-përpunim dhe Marketingun e Produkteve Bujqësore/Masa 103.
 - *Përpunimi i qumështit & mishit- thertoret;*
 - *Përpunimi i pemëve & perimeve dhe rrushit.*

3.3 Masa 202: Mbrojtja dhe kultivimi i pyjeve;

3.4 Investimet në kuadër të Masës 302: Diversifikimi në fermë/Masa 302

- Masa 302.1 - Bletaria prodhimi/përpunimi dhe marketingu i mjaltit;
- Masa 302.2 - Grumbullimi dhe përpunimi i prodhimeve jo drusore të malit dhe marketingu i tyre;
- Masa 302.3 - Përpunimi i prodhimeve bujqësore (të kultivuara) dhe marketingu i tyre;
- Masa 302.4 - Zhvillimi i aktiviteteve artizanale dhe marketingu i tyre;
- Masa 302.5 - Zhvillimi i turizmit rural dhe turizmit në fermë;
- Nën masa 303.2 - Funkcionalizimi i GLV-ve të përzgjedhura 2016 dhe RRZHR.

3.5 Asistenca teknike/Masa 501;

3.6 Masa për ujitjen e tokave bujqësore.

4. Projekt masat e pagesave të drejtpërdrejta për:

Mbjelljet vjeshtore të grurit, Mbjelljen e farës së grurit, Thekër, Elb, Mbjelljen pranverore të misrit, Mbjelljen pranverore të lulediellit, Pemishtet ekzistuese, Pagesa direkte për vreshtat ekzistuese, prodhimtarinë e materialit fidanor të pemëve drufrutore dhe hardhisë së rrushit mbi nënshartesa vegjetative, Prodhimtarinë organike, Lopë qumështore, Buallica, Dele, Dhitë, Bletari, Qumësht sipas kategorive të cilësisë, Prodhimtarinë e vezëve, Dosa në riprodhim, Mbjelljen e kulturave primore në fushë të hapur.

5. Freskimi i programi afat mesëm shtatëvjeçar për bujqësi dhe zhvillim rural PZHRB 2014 - 2020. Në këtë kontekst janë identifikuar gjashtë prioritete të programit:

- Zhvillimi i njohurive dhe ndryshimeve në bujqësi, pylltari dhe zona rurale;
- Rritja e aftësisë konkurruese në të gjithë sektorët e bujqësisë dhe rritja e qëndrueshmërisë së fermave;
- Promovimi i organizatave të ushqimit dhe menaxhimi i rrezikut në bujqësi;
- Restaurimi, ruajtja dhe përmirësimi i ekosistemeve të varura nga bujqësia dhe Pylltaria;
- Promovimi i efikasitetit të resurseve;
- Promovimi i përfshirjes sociale, zvogëlimi të varfërisë dhe zhvillimit ekonomik në zona rurale.

6. Themelimi i qendrave informative bujqësore komunale në të gjitha komunat.

MBPZHR në kuadër të procesit të Integritimit Evropian ka ndërtuar një bashkëpunim të mirëfilltë institucional dhe efikas në funksion të realizimit të të gjitha detyrave dhe obligimeve që rrjedhin nga Procesi i Stabilizim Asocimit- *Dialogu i Procesit të Stabilizim Associmit (DPSA)*, zbatimin e suksesshëm të prioriteteve nga *Plani i Veprimt për Negocim të MSA-së, koordinimin e donatoreve* si dhe i të gjitha detyrave tjera në këtë drejtim, shfrytëzimin efikas dhe të të gjitha formave të asistencës të BE-së për Kosovën (*IPA, asistencë teknike, grante rurale, TAIEX etj.*).

7. MBPZHR në bashkëpunim me MIE ka organizuar me sukses takimet e nivelit me të lartë me KE, takimet e DPSA-së: Plenar dhe atë sektorial dhe ka përgatitur dokument narrativ

- për arritjet në bujqësi zhvillim rural dhe pylltari, ne këtë dokument janë përfshirë zhvillimet legjislativë, zhvillimet institucionale dhe zhvillimet tjera ne kuadër të Ministrisë si dhe ka monitoruar përmbushjen e konkluzioneve të dala nga këto takime.
8. MBPZHR ka bërë adresimin e prioriteteve të parapara karshi kërkesave të BE-se, në PVNMSA-se. Sfidat nga *raporti i progresit* i ka adresuar gjatë hartimit të PVNMSA ku një herë përmbushen kriteret e BE-së.
 9. Përgatitja e Draft Raportit të Vlerësimit përfundimtar/Ex post, të PBZHR 2007-2013. Raporti është në proces të shqyrtimit dhe komentimit (Projekt i financuar nga Komisioni Evropian). Finalizimi i draft Raportit të Monitorimit, në të cilin është bërë përmbledhja e aktiviteteve të monitorimit të cilësisë së zbatimit të Programit të miratuar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, për periudhën 2014. Gjithashtu, është përshkruar progresi i arritur lidhur me zbatimin e programit, përmes vlerësimit të indikatorëve të performancës, si dhe është bërë adresimi i sfidave, të cilat janë identifikuar gjatë procesit të monitorimit në terren të aplikantëve (përfitueseve dhe jo përfitueseve).
 10. Në mbështetje të projektit për Akreditim/KE, Autoriteti Menaxhues është në proces të zhvillimit të aktiviteteve në përputhje me procedurat dhe rregullat e IPARD-it: Analiza e zbrastësirave, njohja me procedurat e përgatitjes së manualeve, zhvillimi dhe zbatimi i një Sistemi për M & E, sipas Programit IPARD, etj.
 11. Edhe për vitin 2015 ka vazhduar implementimi i skemës së pestë të Granteveagro rurale të financuar nga Komisionit Evropian - kjo është vazhdimësi e suksesit të MBPZHR edhe pse akoma pa u nënshkruar marrëveshje kontraktuale me KE dhe vetem falë punës së mirë të MBPZHR, jemi vend i parë në rajon që zbatojmë një lloj skeme të tillë edhe pse akoma nuk jemi vend kandidat. Aktualisht është hapur thirrja për aplikim.
 12. Në aspektin e legjislacionit është punuar ne një mori projekt ligjesh dhe udhëzimesh administrative si në: Projektligjin për Pijet e Forta Alkoolike janë finalizuar tabelat e përputhshmërisë Kosovë - BE dhe BE - Kosovë është proceduar në Kabinetin e Ministrit, në MF për Deklaratë Financiare dhe Deklaratë të Pajtushmërisë në MIE. Për Projektligjin për Ushqimin janë finalizuar tabelat e përputhshmërisë Kosovë - BE dhe BE - Kosovë është proceduar në Kabinetin e Ministrit, në MF për Deklaratë Financiare dhe Deklaratë të Pajtushmërisë në MIE. Pritet finalizimi i Draftit të parë të Projektligjit për Gjuetinë. Pastaj projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.2004/21 për Veterinarinë ku grupi punues ka filluar punën për hartimin e këtij projektligji dhe jemi në konsultim e sipër me një ekspert nga Republika e Sllovenisë. Projektligji për Pyjet - janë finalizuar tabelat e përputhshmërisë Kosovë - BE dhe BE - Kosovë është proceduar në Kabinetin e Ministrit, në MF për Deklaratë Financiare dhe Deklaratë të Pajtushmërisë në MIE. Për Projektligjin për farëra dhe materialin fidanor - është formuar Grupi Punues, me Vendim të Sekretarit të Përgjithshëm, me Ref.ZSP-207/15, Nr.124, datë 11/03/2015. Gjithashtu, janë hartuar edhe 12 Draft Udhëzime Administrative (UA), të cilat janë në procedurë të shqyrtimit dhe miratimit: 1) Draft UA - Për Licencimin e Grumbulluesve dhe Përpunuesve industrial të duhanit dhe produkteve të tij; 2) Draft UA - Për Përmbajtjen dhe Mënyrën e Mbajtjes së Regjistrave për Prodhimin, Paketimin, Përpunimin, Importin, Eksportin, Deponimin, Shpërndarjen e Bimëve, Produkteve Bimore dhe objekteve tjera; 3) Draft UA - Për Përdorimin, Autorizimin dhe Përmbajtjen e Pasaportës Bimore; 4) Draft UA - Për Sistemin e Kontrollës, Autoriteti i Kontrollit, Organet e Kontrollit si dhe Rregullat për Zbatim të Kontrollit; 5) Draft UA - Për prodhimtarinë në Akuakulturë; 6) Draft UA - Për Prodhimtarinë Blegtorale; 7) Draft UA - Për Prodhimtarinë Bimore; 8) Draft UA - Për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Përbërja e Komisionit për Bujqësi Organike; 9) Draft UA - Për

- Standardet e Cilësisë dhe Kategorizimi i Qumështit të pa Përpunuar; 10) Draft UA - Për Themelimin e Këshillit Blegtoral; 11) Draft UA - Për Mënyrat e Ruajtjes së Racave Autoktone; 12) Draft UA - Për Vlerat Gjenetike.
13. Në kuadër të masave të ndërmarra për ruajtjen e tokës bujqësore, nga ndërtimet e paplanifikuara urbane, përmes koordinimit të aktiviteteve me drejtoritë komunale për planifikim hapësinor, inspektorat dhe bujqësi. Ka vazhduar zbatimin e projektit të komasacionit të papërfunduar të tokës dhe implementimi i projektit për rregullim të tokës në baza vullnetare. Projekti i pa përfunduar në 21 Zona kadastrale në komunën e Drenasit është duke vazhduar dhe gjendet në fazën e shqyrtimit dhe diskutimit me pronarët dhe shfrytëzuesit e tokës bujqësore nga komisioni komunal për komasacion, në Komunën e Vushtrrisë projekti është duke vazhduar në 5 zona kadastrale ku është bërë skenimi, gjeoreferencimi, vektorizimi, digjitalizimi, vendosja e rrjetit geodezik të rendit të tretë, në Komunën e Vitisë dhe Kllokotit.
 14. Ka vazhduar koordinimi i aktiviteteve në implementimin e projektit (Zbatimin e Planit Hapësinor, Rural në të gjitha komunat e Kosovës) -ky projekt është duke vazhduar në përmirësimin e procedurave të planifikimit hapësinor rural, sigurimi i aplikacionit specifik (sistemi softverik) për Komunat, mbështetje në komponentet ligjore janë hartuar UA mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit zhvillimor Komunal dhe U.A mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e hartës zonale të Komunës.
 15. Vazhdon zhvillimi i mëtutjeshëm i Sistemit të Identifikimit të Parcelave të Tokës duke ndërlidhur LPIS-in me modulën e Pagesave Direkte për importimin automatik të të dhënave për kampanjën e digjitalizimit të vreshtave.
 16. Sistemi Informativ Pyjor i Kosovës ka përfunduar fazën finale testuese po ashtu edhe stafi i APK-së si dhe Autoritetet Pyjore Komunale është trajnuar. Gjithashtu, në lidhje me hartimin e programit nacional për pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura - ka përfunduar faza finale e projektit, Hartimi i Programit Nacional për Pyllëzime në sipërfaqet e zhveshura si dhe ka filluar faza e trajnimit për zyrtarët kompetent të MBPZHR-ës, komunave etj. të organizuar nga FAO dhe kompania zbatuese e programit.
 17. Mirëmbajtja e kadastrit të vreshtave për 3200 ha dhe zgjerimi i kadastrit të vreshtave për 100 ha, si dhe krijimi i sistemit të kontrollit të verërave - ka vazhduar mirëmbajtja, përforcimi dhe zgjerimi i Kadastrës së Vreshtave dhe Industrisë së verës në Kosovë. Softveri Kaveko ka digjitalizuar të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me deklaratimet e prodhimit të rrushit dhe verës. Sistemi për menaxhimin e cilësisë së verës ka filluar të funksionojë. Janë analizuar një mori mostra të verës dhe kanë marrë të drejtën për treg. Të gjitha këto mostra kanë qenë të dedikuara për tregti të brendshme dhe eksport. Janë digjitalizuar edhe procedurat për krijimin e kartelës për sasi të verës për të gjitha kompanitë prodhuese të licencuara nga MBPZHR. Janë përgatitur 4500 kartela për vreshtarë. Kartelat janë në proces të shpërndarjes.

Gjatë vitit 2015, **Ministria e Punëve të Brendshme** ka planifikuar të gjitha projektet e parapara në Strategjinë për Asistencën në fushën e Sundimit të Ligjit 2016-2019 si dhe Dokumentin Planifikues për Sektorin e Sundimit të Ligjit. MPB tanimë ka përzgjedhur partnerët për zbatim të dy projekteve.

Ministria e Punëve të Brendshme ka paraparë të hartojë dhe ndryshojë dhe plotësojë gjithsej gjatë (6) Projekt-ligje të cilat janë si në vijim:

Prej këtyre janë miratuar: Projekt-ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-143 për Armët, Projekt-ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-246 për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri, si dhe Projekt-ligji për Letërnjoftimet Elektronike.

Ndërsa janë finalizuar: Projekt-ligji për pensionimin e zyrtarëve Policor të Kosovës, Projekt-ligji për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-049, për Zjarrfikje dhe Shpëtim, si dhe Projekt-ligji për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 04 /L-012 për Mbrojtje nga Zjarri.

Ndërsa ka plotësuar dhe ndryshuar gjithsej 32 akte nënligjore, për zbatimin e legjislacionit në fuqi në kuadër të fushëveprimtarisë së kësaj ministrie.

Për **ngritja e kapaciteteve dhe bashkëpunimi në fushën e rendit dhe sigurisë** gjatë këtij viti është rritur bashkëpunimi ndërinstytucional në fushën e parandalimit dhe luftimit të krimin, ku me këtë rast është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit për themelimin e komitetit drejtues për fushën e IT-së për të gjithë institucionet e zbatimit të ligjit. Është kryer Studimi i interoperabilitetit të sistemit të TI të institucioneve të zbatimit të ligjit. Është funksionalizuar SIPK i ri me standarde më të larta në fushën e IT-së, i cili sistem ka integruar të gjitha bazat e të dhënave të Policisë së Kosovës. Në kuadër të SIPK-ut të ri janë krijuar dy module të SIPK-ut: moduli i operativës dhe moduli i hetimeve si dhe janë hartuar shumë politika në nivel strategjik. Po ashtu, me qëllim të avancimit të kontrollit të kufirit, janë nënshkruar kontratat për mirëmbajtjen e BMS, CCTV dhe ANPR.

Gjithashtu, në kuadër të ngritjes së kapaciteteve, Agjencioni Kosovar i Forenzikës në përputhje me standardet ndërkombëtare ISO, i ka akredituar këto pesë divizione: Divizioni (Laboratori) për Analiza Serologjike dhe ADN-së, Divizioni (Laboratori) për Analiza Kimike të Narkotikëve, Divizioni i Balistikës, Divizioni i Daktiloskopisë dhe Divizioni për Dokumente dhe Dorëshkrime.

Gjithashtu, divizioni për analiza të eksploziveve dhe zjarr-vënieve ka krijuar dhe validuar tri metoda të reja në fushën e analizës së eksplozive.

Po ashtu, gjatë këtij viti janë shënuar arritje edhe në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal, si në zhvillimin e operacioneve të përbashkëta me shtetet fqinje dhe të BE-së, si dhe është arritur që të nënshkruhen tri (3) marrëveshje ndërkombëtare në fushën e bashkëpunimit policor gjegjësisht me shtet Shqipërinë, Slloveninë dhe Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandën Veriore.

Me qëllim të **ngritjes së sigurisë së dokumenteve** gjatë këtij viti është bërë lansimi i versionit të ri 2.0 të sistemit të gjendjes civile dhe është bërë lansimi i certifikatave të reja me standardet më të larta të sigurisë. Në kuadër të kësaj janë trajnuar të gjithë 530 zyrtarët e gjendjes civile rreth përdorimit të sistemit të ri dhe ndryshimeve legjislative. Po ashtu, gjatë këtij viti ka filluar

procesi i digjitalizimit të librave të kthyer nga Serbia i cili proces do të krijojë një regjistër më të besueshëm të gjendjes civile.

Menaxhimi i flukseve të migrimit

Si rezultat i masave të ndërmarra është arritur që të ndalet fluksi i migrimit të parregullt të qytetarëve të Kosovës në vendet e BE-së. Ndërsa, me qëllim të menaxhimit të fluksit të mundshëm të refugjatëve nga vendet e lindjes së mesme MPB ka përgatitur planin e reagimit duke definuar veprimet përgatitore dhe të reagimit nga institucionet të Republikës së Kosovës. Gjatë këtij viti është arritur të bëhet rishikimi i planit të veprimit të Strategjisë për Migrim, është hartuar rregullorja për integrimin e të huajve në shoqërinë kosovare dhe është hartuar Profili i Migrimit për vitin 2014. Për më tepër është funksionalizuar qendra për mbajtjen e të huajve. Po ashtu, në këtë vit Kosova është anëtarësuar në iniciativën rajonale për migracion, azil dhe refugjat (MARRI).

Ri-integrimi i Qëndrueshëm i Personave të Riatdhesuar

Gjatë vitit 2015 ka vazhduar ri-pranimi i personave të riatdhesuar duke respektuar marrëveshjet e nënshkruara me Shtetet e BE-së. Gjatë këtij viti (janar – nëntor) janë ripranuar 16 006 persona, prej tyre 8515 persona janë riatdhesuar me forcë (53%) kurse 7491 janë kthyer vullnetarisht (47%). Për më tepër, është finalizuar marrëveshja për ripranim me Maqedoninë si dhe është nënshkruar marrëveshja për ripranim me Turqinë.

MPB ka vazhduar me ri-integrimin e personave të riatdhesuar përmes fondit të posaçëm për Ri-integrim si dhe ka rishikuar rregulloren për përfitim nga programi për ri-integrim në mënyrë që të sigurojë ri-integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar. Për më tepër janë hartuar dhe miratuar Planet Komunale për ri-integrim pothuajse në të gjitha komunat.

Ministria e Forcës dhe Sigurisë së Kosovës - në përputhje me rekomandimet e RSSH-së Qeveria i ka propozuar Kuvendit të Kosovës amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me çka do të mundësohej krijimi i bazës ligjore për shndërrimin e Ministrisë së FSK-së në Ministri të Mbrojtjes dhe njëkohësisht i FSK-së, në Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës.

Gjatë kësaj periudhe, përkundër mosmiratimit të ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore, pas një punë intensive dhe në bashkëpunim me ekipin e DIR-it dhe me partnerët ndërkombëtar, MFSK/FSK, ka miratuar në parim strukturën për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Kosovës. Poashtu, në bashkëpunim me këshilltarët e Ekipit të NATO-s, është finalizuar në parim Draft-Doktrinën e Përgjithshme Ushtarake, Draft-Doktrinat e fushave funksionale (personelit, inteligjencës, operacioneve, logjistikës, komunikimit, trajnimit), Draft-Librin e Bardhë, Draft-Planin Afatgjatë Zhvillimor Dhjetëvjeçar (PAZH), Draft-planet mbështetëse dhjetëvjeçare (personelit, operacioneve, logjistikës, komunikimit dhe mjekësisë), Deklaratën e misioneve të Ministrisë së Mbrojtjes, FAK-ut dhe njësisë të saj, Draft-Tabelën e Organizimit dhe Pajisjeve (TOP), Draft-Planin afatgjatë buxhetor të mbrojtjes, Draft-Konceptin e transformimit dhjetëvjeçar nga FSK në FAK etj. Pasi të merret vendimi politik i Kuvendit të Republikës së Kosovës për transformimin e MFSK-së në MM dhe të FSK-së në FAK këto dokumente do të procedohen për aprovim.

Në kuadër të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies ndaj institucioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj është filluar me raportimet periodike dhe vjetore të zbatimit të planit vjetor dhe vendimeve të Qeverisë, të shpenzimeve buxhetore, regjistrimin, monitorimin dhe procedimin e të gjitha projekteve furnizuese, shërbyese, investimeve kapitale, donator të të gjitha aseteve funksionale dhe zhvillimin e procesit të zhvlerësimit të atyre jofunksionale.

Si rezultat i procesit të rekrutimit, gjatë vitit 2015 janë rekrutuar: pjesëtarë aktiv- 334 rekrutëve të rinj (305 meshkuj e 29 femra), prej të cilëve 17 rekrutë të përzgjedhur janë nga radhët e komuniteteve joshumicë.

Në pajtim me nevojat e Forcës së Sigurisë së Kosovës, është arritur që të realizohet përzgjedhja e 28 kadetëve (23 meshkuj dhe 5 femra), prej të cilëve 2 janë nga radhët e komuniteteve joshumicë. Kadetët e përzgjedhur do të shkollohen në qendrat shkollore si në vijim: Qendra për Studime Universitare/Forca e Sigurisë së Kosovës- 12, Akademia Ushtarake Mjekësore e Republikës së Turqisë- 5, Akademia Ushtarake Tokësore e Turqisë- 2, Kolegji Mjekësor i Nënoficerëve në Turqisë- 2, Akademia Ushtarake e Maqedonisë-2, Akademia Ushtarake e Kroacisë - 2, Akademi Ushtarake e Republikës Federale të Gjermanisë- 3.

Prej 12 kadetëve të përzgjedhur për shkollim në Qendrën për Studime Universitare të Forcës së Sigurisë së Kosovës, 2 kadetë janë nga Republika e Shqipërisë si rezultat i Memorandumit të bashkëpunimit në mes të MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Shqipërisë.

Rekrutimi i kadetëve për Ëest Point/SHBA - Procesi i rekrutimit të kadetëve për Akademinë Ushtarake të SHBA (Ëest Point) i filluar në fillim të vitit 2015, është duke vazhduar ende dhe nga 98 kandidatë konkurrues, garën aktualisht janë duke e vazhduar 4 kandidatë të cilët tani janë në fazën kualifikuese. Procesi i përzgjedhjes do të përfundojë me 28 shkurt 2016.

Rekrutimi i nëpunësve civil- Gjatë vitit 2015, në pajtim me planin e rekrutimit dhe kërkesat e njësisë organizative të MFSK/FSK-së, janë rekrutuar 3 nëpunës civil (shqiptar), prej të cilëve 2 meshkuj dhe 1 femër.

Rekrutimi i stafit politik/stafit të kabineteve- Gjatë vitit 2015 janë bërë 6 emërimë në radhët e stafit politik (5 meshkuj dhe 1 femër), dhe 4 emërimë në radhët e nëpunësve të kabinetit të ministrit dhe zëvendësministrave të FSK-së (3 meshkuj dhe 1 femër). Gjithsejtë, gjatë vitit 2015 janë emëruar në radhët e stafit politik dhe stafit të kabinetit 10 të emëruar shqiptar.

Angazhimi dhe Trajnimi i Komponentit Rezervë - Në pajtim me planin vjetor të veprimit për vitin 2015, si dhe në pajtim me plan programin e trajnimit të pjesëtarëve rezervë për vitin 2015, gjatë këtij viti janë hartuar urdhëresat, thirrjet, njoftimet dhe dokumentet tjera përcjellëse për trajnimin e 175 pjesëtarëve të komponentit rezervë.

Sipas marrëveshjeve bilaterale që kemi pasur me dymbëdhjetë (12) Shtete për vitin 2015, janë zhvilluar trajnimet si në vijim:

Nga 117 trajnime që kanë qenë të parapara për tu realizuar gjatë këtij viti, 69 nga to kanë përfunduar, 22 janë duke u zhvilluar dhe 9 nga to janë anuluar.

Gjatë këtij viti kanë përfunduar trajnimin 118 pjesëtarë, janë duke zhvilluar trajnimin 27 pjesëtarë si dhe pritet për ta filluar trajnimin 20 pjesëtarë.

Në shkollim jashtë vendi aktualisht i kemi 34 kadetë në katër vende: Gjermani 2, Turqi 19, Kroaci 2, dhe Maqedoni 11.

Kapacitetet dhe gatishmëria Operacionale - Sipas vlerësimit të RGJONj-së, FSK ka arritur të mbajë dhe në disa fusha edhe të avancojë nivelin e gatishmërisë të përcaktuar nga Komandanti i FSK-së.

Operacionet për asgjësimin e mjeteve të pashpërthyera (EOD) dhe operacionet e deminimit Qendra Koordinuese për Deminim ka koordinuar realizimin e intervenimeve të EOD-së. Njësitë kujdestare të FSK-së kanë intervenuar në 301 raste dhe kanë demoluar 441 mjete të ndryshme eksplozive.

Gjatë kësaj sezone të deminimit humanitar njësitë e FSK-së kanë qenë të angazhuara në gjashtë lokacione: Seqishte, Brenda hapësirës së Kazermës në Ferizaj, Parku "Liria" Ferizaj, Luzhnicë, Zagrimle dhe Gorancë. Në këto lokacione janë pastruar 282,985 metra katror dhe janë demoluar 440 mjete të pashpërthyera.

Operacionet tjera të njësive të FSK-së - Operacionet e Kërkim-Shpëtimit, Vërshime, Incidente - 9, Inspektime në fushën e Mbrojtjes Kimike Atomike dhe Biologjike - 15, Vlerësimi i Rreziqeve të mundshme nga Njësia e Ndërlidhjes për Reagim në Kriza - 11, Operacione të Zjarrëfikjes- 4, Operacione në zhbllokimin e rrugëve nga dëbora- 5.

Operacionet e Kërkim Shpëtimit - Operacioni Mbështetës pas përmbytjeve në R.Shqipërisë nga data 04-09 Shkurt 2015; në fshatin Rufc, KK Lipjan për gjetjen e fëmiut të mbytur në Ujë nga data 06-20 Shkurt 2015; në Lumin Ibër për gjetjen e trupave të pa jetë nga data 11-28 Prill.

Trajnimet - Trajnimet kolektive jashtë vendit: KampiVeror 2015 (Maqedoni) UF "Immediate Response" (Slloveni) UVK/Ushtrimi Simulativ "Joint Reaction15" (Shqipëri). Trajnimet kolektive brenda vendit: Hedhja e pakove nga ajri dhe lidhja e pakove për helikopter, Ushtrimi i Komunikimit, Ushtrimi mbi Tavolinë për Inteligjencë, Ushtrimi mbi Tavolinë për Logjistikë, UF "Shqiponja 4".

Sistemi i mbështetjes logjistike - Blerjet kapitale të realizuara: Furnizim me kompresor ajri mobil (Pajisje Kërkim-Shpëtimit), Municion, Uniformë ceremoniale për kadetët e FSK-së dhe Uniformë për kadetët e QSU - së dhe Vajra Lubrifikante.

Është nënshkruar kontrata dhe jemi pritje te furnizimit me: automjete taktike, autoambulancë, kombi i mbyllur - furgon, kompjuter, çizme ushtarake dhe pajisje operacionale fushore (tenda).

Pajisjet e pranuar donacion në vitin 2015- Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë ofruar pajisje në vlerë prej 354,316.42 dollar; Fondi i Mirëbesimit të NATO-s-28,959.00 €; KFOR-i turk- 3,476.00 dollar.

Projektet infrastrukturore - Projektet të cilat kanë filluar në vitin paraprak (2014) dhe kanë përfunduar gjatë vitit 2015 apo janë në proces të përfundimit: 4 projekte në vlerë të përbashkët prej 869,212.61 €, Projektet e reja që kanë filluar dhe përfunduar në vitin fiskal 2015: 1 projekt në vlerë të përbashkët prej 102,971.00 €, Projektet të cilat priten të përfundojnë deri në fund të dhjetorit 2015 : 3 projekte në vlerë të përbashkët te kontratave (2014-2015) prej 1,845,118.10 €, Projektet kapitale në infrastrukturë të cilat kanë filluar në vitin 2015 dhe vazhdojnë edhe ne vitet tjera (janë projekte në faza 2015 -2016-2017): 12 projekte në vlerë të përbashkët te kontratave (2015-2016):3,338,762.76 €.

Shfrytëzimi i kapaciteteve të ngritura në ndihmë dhe mbështetje autoriteteve civile dhe komuniteteve - Departamenti për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak i MFSK në bashkëpunim me G9KFT, BMO, përmes Batalionit të Xhenios, ka arritur të realizojë: 19 projekte dhe 28 asistenca humanitare.

Ekipe të mjekësore të FSK-së, kanë realizuar vizita mjekësore duke ofruar asistencë mjekësore dhe barna esenciale për komunitetin serb në fshatrat e Komunës së Istogut dhe të Novobërdës. Prezenca e personelit mjekësor të FSK-së dy herë në muaj, të cilët për një kohë të gjatë pranojnë shërbime të ndryshme shëndetësore falas.

Është organizuar aksion humanitar për dhurimin vullnetar të gjakut me një përgjigje masive nga ana e zyrtarëve të MFSK-se dhe oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve të FSK-së duke dhuruar gjithsejtë 1107 doza të gjakut për nevoja të Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut të Kosovës.

Instruktorët e deminimit, përveç operacioneve të deminimit, kanë realizuar edhe ligjërata nëpër shkolla fillore dhe ato të mesme për vetëdijësimin e nxënësve nga rreziku i minave, mjeteve tjera të pashpërthyer dhe mjeteve piroteknike.

Me qëllim të koordinimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve në ndriçimin e fatit të personave të zhdukur gjatë luftës së viteve 1998-1999, së bashku me partnerët vendorë e ndërkombëtarë, MFSK ka luajtur rol aktiv në punën e këtij komisioni. Ka marrë pjesë rregullisht në takimet e komisionit qeveritar KQPZH-së, njësitë e FSK-së kanë mbështetur KQPZH, transportimin dhe nderimin e 28 mbetjeve mortore në Rezallë, komuna e Skënderajt të 21 mbetjeve mortore në fshatin Çikatovë e Vjetër komuna e Drenasit me rastin e rivarrimit. BCU, ka marrë pjesë në shënimin e 27 prillit-Dita e të Pagjeturve të Kosovës dhe 30 gushtit- Dita Ndërkombëtare e të Pagjeturve.

Në kuadër të bashkëpunimit që kemi me zyrën Mbështetëse Civilo-Ushtarake pranë Ambasadës Amerikane në Prishtinë, janë realizuar trajnime dhe disa projekte humanitare si, projekti i përbashkët i Kadetëve Amerikan me Kadetët e FSK, pastrimi i ambientit në hapësirën e hekurudhës në Ferizaj, ngjyrosja e SHFMU "Daut Bogujevci", në Fushë Kosovë, mbajtjen e ligjëratave të përbashkëta nëpër shkolla si në Mitrovicë, Shkolla "Frank Bardhi", dhe në Podujevë, shkolla "Aleksandër Xhuvani" dhe në Viti shkolla "Jonuz Zejnullahu".

Ndarje e donacioneve të medikamenteve mjekësore Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Klinikë, donacione, mjete materiale të Agrikulturës, Shoqatës së Grave në Remnik, Lubishtë komuna e Vitisë dhe Shoqatës së Grave në fshatin Begracë, komuna e Kaçanikut, si dhe në veshmbathje Kryqin e Kuq të Kosovës në komunën e Kaçanikut, në bashkëpunim me Departamentit të BCU-së në MFSK dhe FSK-së.

Pjesëtarët e FSK-së kanë marrë pjesë në trajnimet/seminaret e mbajtura në Kosovë, SHBA dhe vende të tjera, një numër i konsiderueshëm i këtyre trajnimeve kanë qenë të ofruara nga SHBA-të përmes ODC.

Gjatë periudhës kohore shtator 2014-shtator 2015 aktivitetet/trajnimet të cilat kanë qenë të planifikuara në Programin Shtetëror (SPP) në mes Kosovës dhe Ioëa-s, përkatësisht Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Gardës Nacionale të Ioëa-s janë realizuar sipas planifikimeve fillestare. Trajnimet/Seminaret që janë mbajtur në bashkëpunim me Gardën Nacionale të Ioëa-s janë përqendruar në mbrojtjen kibernetike, menaxhimin e resurseve njerëzore, zhvillimin profesional ushtarak, ndërveprueshmërinë dhe dislokimin e forcave të kombinuara tokësore, zhvillimet strategjike, kapacitetet reaguese gjatë fatkeqësive natyrore, partneritetit dhe bashkëpunimit regional, kapacitetet operacionale të logjistikës, zhvillimi i doktrinës si dhe planifikimi dhe ekzekutimi i ushtrimeve fushore të realizuara në Kosovë dhe Ioëa si dhe vizita

të niveleve të ndryshme që për qëllim kanë pasur thellimin e bashkëpunimit në fusha të ndryshme dhe zhvillimit të mëtutjeshëm të FSK-së.

Angazhimi në zgjerimin e fushës së bashkëpunimit ndërkombëtar bilateral me shtete të reja dhe thellimi i bashkëpunimit bilateral me shtetet partnere - Gjatë këtij viti janë zhvilluar proceset e koordinimit, hartimit dhe finalizimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit bilateral me Republikën Çeke, Ministrinë Federale të Mbrojtjes dhe Sportit të Austrisë dhe Ministrinë e Mbrojtjes së Zvicrës; thellimi i bashkëpunimit bilateral me Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës së Kroacisë, Ministrinë Federale të Mbrojtjes së Republikës Federale të Gjermanisë, Ministrinë e Mbrojtjes së Maqedonisë, Forcat e Armatosura të Republikës së Turqisë, Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës së Letonisë, Republikës së Shqipërisë, Republikës së Sllovenisë.

Oficerët tanë në përgjithësi në të gjitha trajnimet dhe shkollimet në qendrat arsimore ushtarake kanë treguar rezultate të larta për këtë vit vlen të ceket sukcesi i oficerit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, Toger Ismail Hoxha, i cili është shpërblyer me "Shpatën për studentin më të mirë", çmim të cilin i dhuroi në mënyrë ceremoniale Princi Charles. Kjo është hera e parë kur Akademia Mbretërore Ushtarake e Britanisë së Madhe jep këtë çmim për një oficer nga Ballkani.

Koordinimi i aktiviteteve me atashetë e FSK-së dhe atashetë e akredituar nga vendet tjera në dhe për Kosovë - Janë bërë të gjitha koordinimet e aktiviteteve të përditshme me atashetë e FSK-së të akredituar jashtë vendit. Gjithashtu, janë koordinuar të gjitha aktivitetet e planifikuara me atashetë përkatëse të vendeve partnere me të cilat FSK ka bashkëpunim bilateral. Përveç këtyre gjatë këtij viti janë organizuar dy sesione të konferencës "FSK dhe partnerët", ku është diskutuar për bashkërendimin e asistencës së ofruar FSK-së nga vendet partnere.

Pjesëmarrja në Iniciativat ndërkombëtare të mbrojtjes dhe sigurisë - Pjesëmarrja në seminarin "Qasja rajonale në reduktimin e armëve të tepërta - RASR" e organizuar nga RACVIAC, Kroaci, në konferencat planifikuese të parapara për ushtrimet "Joint Reaction 2015", Shqipëri dhe "Immediate Response 2015", Slloveni/Kroaci, në takimin vjetor të shefave të logistikës të forcave të armatosura në kuadër të Kartës së Adriatikut A5, Maqedoni, në sesionin trajnues për "Rolin e Shoqatave dhe Asociacioneve të Ushtrive në Shtetet e Ballkanit", organizuar nga EUROMIL, Maqedoni, në Konferencën e Mynihut "European Defence Summit 2015", Bruksel, në konferencën e Shefave të Mbrojtjes në kuadër të Kartës së Adriatikut A5, Maqedoni, në takimin vjetor të Drejtoreve të Politikave të Mbrojtjes të organizuar në kuadër të A-5 Kartës së Adriatikut, Bosne dhe Hercegovinë, në Seminarin "Zhvillimi i Nënoficerëve" i zhvilluar me 16-19 qershor 2015, Bullgari, në Konferencën për Siguri të Evropës të organizuar nga Komanda Evropiane e ShBA-ve për Evropë (EUCOM), zhvilluar Qendrën "George Marshall", në Garmisch të Republikës Federale Gjermane, në Konferencën „ShBA - Karta e Adriatikut 5“, me temë "Barazia Gjinore, Integrimi dhe Perspektiva në Strukturat Ushtarake", Shqipëri, në punimet e Samitit të II-të Evropian të Mbrojtjes, në organizimin e Konferencës për Siguri të Mynihut, Bruksel, në Konferencën në kuadër të SHBA-Karta e Adriatikut (A-5), të shefave të Mbrojtjes të shteteve të Rajonit dhe të Komandës Amerikane në Evropë (USEUCOM), Maqedoni, në punimet e takimit gjithëpërfshirës regional të ministrave të mbrojtjes (Comprehensive Regional Ministerial -CMR), Kroaci, në punimet e Konferencës vjetore të ushtrive të shteteve të Evropës, sponsorizuar nga Komanda e Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara për Evropë (U.S. Army Europe), në Eiesbaden të Gjermanisë, në Konferencën e 10 të sigurisë "Konferenca e Rigës" (Riga Conference), Letoni, në Konferencën "Avancimi i sigurisë nga vizioni modern" organizuar nga Forumi Ndërkombëtar i Halifaksit për Siguri, në Halifaks të Kanadasë.

Progresi për anëtarësim në iniciativat rajonale A5, SEEDM, SEEBRIG, EMAC - MFSK me MPJ kanë koordinuar aktivitetet dhe politikat e jashtme dhe të sigurisë për përfaqësimin e Kosovës jashtë me atashë të sigurisë ose përfaqësues të fushës së sigurisë pranë ambasadave tona në vende të ndryshme, si dhe për koordinimin me iniciativat rajonale (A5, RACVIAC, SEECP, RCC, etj).

Kryetarët e komunave të Kosovës i kanë ofruar mbështetje procesit të regjistrimit, duke nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Diasporës në takimin e Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Është arritur që tarifa e Kartonit të Gjëlber të zbritet për 50%, ndërsa kanë vazhduar përpjekjet për heqjen e plotë të kësaj tarife, duke propozuar nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale me shtetet anëtare të Këshillit të Byrove.

Ministria e Diasporës, Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe AlbKonfindustria, të përkrahura nga projekti DEED, biznese e përfaqësues të dy qeverive, organizuan në Prishtinë Ekspoforumin, për t'i identifikuar mënyrat e reja të financimit të projekteve strategjike Kosovë-Shqipëri. Ekspoforumi u hap me minipanairin e prodhuesve të diasporës në Kosovë.

QKKDM-ja në Zvicër, në bashkëpunim me OJQ-në "Bazel Gjakova", e realizoi aktivitetin kulturor të forumit ekonomik turistik për Kosovën, ku morën pjesë Ministri i Diasporës dhe ai i Tregtisë dhe i Industrisë, afaristë dhe biznesmenë të shumtë nga Zvicra e vendet e tjera, në Suedi, në bashkëpunim me shkollat shqipe në Halmstad, e shënoi 30-vjetorin e shkollës shqipe në Halmstad me një program të pasur kulturo-artistik dhe në bashkëpunim me asociacionet kulturo-arsimore dhe grupet rapsodike, organizoi Festivalin e parë të rapsodëve shqiptarë në Suedi.

Në kuadër të projektit për rrjetëzimin e bizneseve të diasporës, Ministria e Diasporës dhe RRBDSH (Rrjeti i Bizneseve të Diasporës Shqiptare), janë themeluar rrjetet e bizneseve të diasporës në Australi, Gjermani (Hamburg), Turqi (Stamboll), Suedi dhe në Norvegji.

Rreth 60 afaristë shqiptarë nga mbarë bota, përfaqësues të rrjeteve të bizneseve të diasporës shqiptare nga shtetet e ndryshme të botës janë mbledhur përgjatë katër ditëve në Prishtinë, Istog dhe në Tiranë.

U mbajt forumi ekonomik me temën "Përmirësimi i ambientit për investimet nga investitorët e diasporës në Kosovë".

Me qëllim të promovimit të rrjeteve të bizneseve shqiptare të themeluara në botë, informimit lidhur me objektivat dhe qëllimin e tyre, si dhe motivimin e bizneseve të tjera të bëhen anëtare të rrjeteve dhe të kontribuojnë në fushën e investimeve dhe të zhvillimit ekonomik të vendit, është përgatitur një monografi, në të cilën është pasqyruar i tërë procesi i themelimit të këtyre rrjeteve.

Po ashtu, gjatë këtij viti ka përfunduar faza e parë e projektit, duke u themeluar rrjete të juristëve në Gjermani, Suedi, Austri, Zvicër dhe Itali.

Është themeluar grupi i punës për çështje administrative, i përbërë nga zyrtarë të institucioneve relevante dhe të shoqërisë civile. Janë identifikuar problemet, me të cilat ballafaqohen bashkatdhetarët tanë, në veçanti problemet që hasin për nxjerrjen e dokumenteve. Rezultat i punës së këtij grupi është broshura me informata të rëndësishme për nxjerrjen e dokumenteve, memorandumit ndërmjet MeD-së dhe komunave të Republikës së Kosovës, si dhe arritja e publikimit të informatave mbi fluksin e automjeteve në pikat kufitare, me ndihmën e Qendrës Kombëtare për menaxhimin e kufijve.

Ministria e Punëve të Jashtme - janë ratifikuar dhe kanë hyrë në fuqi edhe disa marrëveshje që rregullojnë raportet e RKS me vendet e rajonit: është ratifikuar dhe ka hyrë në fuqi marrëveshja për bashkëpunim të ndërsjellë në fushën e sigurisë, në mes të Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, është ratifikuar dhe ka hyrë në fuqi marrëveshja në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, për hapjen e kalimit kufitar të përbashkët Kotlovë-Kuqishtë, Republika e Kosovës e ka ratifikuar dhe fuqizuar marrëveshjen dhe protokollin e saj të zbatimit për bashkëpunim financiar ushtarak, në mes të Kosovës dhe Turqisë, është ratifikuar dhe ka hyrë në fuqi marrëveshja për hapjen, funksionimin dhe aktivitetet e Qendrave të Kulturës në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, është ratifikuar dhe ka hyrë në fuqi marrëveshja për Mbrojtjen e Investimeve në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë.

Kryeministri dhe ZvKM/MPJ me fokus të vazhdimit të thellimit të marrëdhënieve me vendet e rajonit kanë zhvilluar në NY takime me Kryeministrin turk në të cilin janë diskutuar çështje të interesit të përbashkët si dhe zhvillimet në rajon, gjithashtu ata janë takuar me Ministrin e Jashtëm grek me të cilin janë diskutuar çështje të interesit të përbashkët, përkrahja e RKS për anëtarësim në organizata ndërkombëtare dhe rajonale si dhe lidhur me zhvillimet e përgjithshme në rajon.

Nënshkrimi i MSA-së si dhe zbatimi i rekomandimeve në kuadër të udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave

Në bashkëpunim me MIE, MPJ ka arritur që përmes misionëve diplomatike të lloboj pranë shteteve anëtare por edhe institucioneve të BE-së lidhur me nënshkrimin e MSA-së, njëherit janë realizuar ato pika për të cilat MPJ ka qenë përgjegjëse lidhur me udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave.

Avancimi i proceseve për përafrim me NATO dhe mekanizmat Euro- Atlantike

Janë mbajtur disa takime me nivele të ndryshme të NATO-s, përfshirë edhe vizitën e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, në Prishtinë. Janë bërë koordinimet e duhura me MFSK lidhur me atashetë, ndërsa pas anëtarësimit në Qendrën për Bashkëpunim për Sigurinë "RACVIAC", me seli në Zagreb, Kosova ka dërguar përfaqësuesin e saj në këtë organizatë të rëndësishme rajonale të sigurisë.

Diplomacia ekonomike

Janë organizuar qindra aktivitete të ndryshme të cilat synim parësor kanë tërheqjen e investimeve të huaja direkte, promovimin e produkteve të Kosovës jashtë, informimin e investitorëve potencial, prezantimin e potencialit ekonomik e tregtar të Republikës së Kosovës.

Në këtë drejtim MPJ në bashkëpunim me ministritë tjera të linjës përgjegjëse direkte për ekonomi, të organizojë: Forumin Ekonomik Kosovë-Kroaci, në të cilën mbi 30 kompani nga Kroacia dhe qindra nga Kosova kanë diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit dhe thellimit të marrëdhënieve biznesore ndërmjet dy vendeve. Gjithashtu, Zv.KM dhe MPJ ka marrë pjesë në Croatia Forum 2015 në Dubrovnik me qëllim nxitjen e përkrahjes ekonomike.

Këtë vit janë arritur 19 marrëveshje të karakterit ekonomik-tregtar, të cilat synojnë nxitjen e mëtejshme të zhvillimit ekonomik, ndërsa janë iniciuar edhe 7 tjera që kanë synim fuqizimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ekonomik ndërkombëtar të Kosovës. Më qëllim të rritjes së kapaciteteve për diplomaci ekonomike, MPJ, ka trajnuar stafin nëpër misionet diplomatike e konsullore, në fushën e diplomacisë ekonomike, ndërsa ka mirëpritur delegacione nga vende të ndryshme të botës të cilët kanë qenë të interesuar për investime në Kosovë.

Diplomacia Publike dhe Digjitale

Kanë vazhduar aktivitetet në kuadër të diplomacisë publike dhe dixhitale, duke organizuar projektet me renome ndërkombëtare si Interfaith, e cila ka mbledhur në Kosovë, 400 liderë fetar dhe tjerë nga të gjitha vendet e botës. Janë bërë të gjitha përgatitjet për organizimin e Germia Hill, duke filluar me sesionet e para të Germia Hill Talks, ndërsa janë lansuar disa botime si: This is hoëëe do soft poëer, botimet për UNESCO në disa gjuhë të ndryshme, Insta Kosovo, revista Neë Diplomat me disa numra të ri, si dhe është lansuar ueb faqja e re e Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Të Arriturat Kryesore Në Dialogun E Brukselit

Ministrja për Dialog së bashku me ekipet e ekspertëve nga ZKM-ja dhe Ministritë e linjës kanë zhvilluar një aktivitet intensiv dhe voluminoz në përpjekje për të arritur sa më shumë sukses në këtë proces. Këtu përfshihen arritja e një numri të konsiderueshëm të marrëveshjeve të reja dhe përparimet serioze në zbatimin e tyre, realizimi i një numri të madh të takimeve të Dialogut në Bruksel dymbëdhjetë (12) takime, takime bilaterale me BE-në dhe Zyrën e BE-së në Kosovë njëzetëntë (29) takime, takime bilaterale me SHBA dhe Ambasadën Amerikane në Kosovë njëzetepesë (25 takime), si dhe takime përgatitore ndërinstitucionale për hartimin e platformave strategjike të negociimit për temat që janë trajtuar e që gjithsejtë, shtatëdhjetënjë (71).

Janë mbajtur një numër i konsiderueshëm i raundeve të dialogut në nivelin e Kryeministrave të dy shteteve dhe PL/BE Mogherini, me qëllim të përmbylljes së marrëveshjeve që janë gjeneruar nga niveli teknik i bisedimeve. Kryeministri, Zëvendëskryeministri dhe Ministri i jashtëm dhe Ministrja për dialog dhe ekipet mbështetëse kanë qenë pjesë e gjashtë (6) takimeve të nivelit të lartë të mbajtura në Bruksel.

Janë publikuar katër raporte për gjendjen në zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit të cilat janë dorëzuar në BE, ambasadat e huaja, zyrën e Presidentes, Kuvendin e Kosovës, Qeveri, Misionet diplomatike të Kosovës jashtë vendit si dhe të gjitha ministrive, agjencive dhe institucioneve të Kosovës të përfshira në dialog.

Ministrja për dialog ka raportuar dy herë në komisionet parlamentare në Kuvend, një raportim në Komisionin për Punë të Jashtme dhe një raportim në Komisionin për Legjislacion si dhe

shtatë herë ka pas paraqitje në seancat plenare të Kuvendit gjatë këtij viti.

Ministrja për dialog ka udhëhequr delegacionin e Kosovës në Bruksel në dy takime në të cilat është adresuar problematike e migrimit ilegale të qytetarëve të vendit drejt vendeve të BE-së.

Të Arriturat e Vitit 2015

Të arriturat në Dialogun e Brukselit kanë ndikuar drejtpërsëdrejti në realizimin e objektivave strategjike duke përfshirë: forcimin e sovranitetit shtetëror brenda dhe jashtë vendit, përmirësimin e sundimit të ligjit, përmirësimin e jetës që qytetarëve në planin social, ekonomik, politik, të sigurisë dhe integritetit, shtrirjen e sovranitetit shtetëror në veri të vendit dhe zhbërjen e strukturave paralele serbe, normalizimin e marrëdhënieve fqinjësore mes dy shteteve me një të kaluar armiqësore, avancimin e agjendës euro-atlantike dhe forcimin e imazhit të shtetit dhe aleancës me SHBA-të, BE-në dhe NATO-në.

Suksesi kryesor u arrit me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA) mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian në tetor të këtij viti, si një moment historik, që hapi rrugën zyrtare të Kosovës për anëtarësim në BE. Dialogu i Brukselit ka kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në arritjen e MSA-së.

Të gjitha marrëveshjet e arritura janë në pajtim të plotë me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës dhe janë konfirmim për njohjen e pavarësisë së Kosovës nga Serbia në fushat ku janë arritur marrëveshjet.

Është bërë raportimi i rregullt për të argumentuar për mos përmbushjen e obligimeve zbatuese nga ana e Serbisë, gjë e cila rezultoi me vendimin e BE-së që ta kushtëzoj Serbinë në integrimin evropian dhe me përmbushjen e detyrimeve të Dialogut të Brukselit dhe normalizimin e marrëdhënieve fqinjësore me Kosovën përmes Kapitullit 35.

Marrëveshjet e arritura gjatë këtij viti përfshijnë fushat: drejtësia, shuarja e “mbrojtjes civile”, marrëveshjet në pako të datës 25 gusht 2015 për kodin telefonik, për energjinë (zhbllokimin e procesit të zbatimit), largimin e barrikadës nga ura e Mitrovicës dhe asociacionin, pastaj, marrëveshjet si sigurimi i automjeteve, tregtia në produktet medicinale, ndalja e ndërtimeve ilegale në veri, asistenca e ndërsjellë ligjore, shkëmbimi elektronik i të dhënave doganore, licencimi i kompanive në veri. Për sa i takon Asociacionit, marrëveshja e bënë të qartë se nuk do të ketë kompetenca ekzekutive dhe është në pajtim me kushtetutën dhe ligjet e Kosovës. Kosova ka kushtëzuar themelimin e Asociacionit me largimin e plotë të strukturave paralele të Serbisë në Kosovë.

1. Forcimi i sovranitetit të shtetit – shtrirja e sovranitetit në veri të vendit

Forcimi i mëtejshëm i sovranitetit të shtetit është një ndër arritjet kryesore në Dialogun e Brukselit. Është arritur të finalizohet zbatimi i një numri të marrëveshjeve, ndër të cilat veçojmë marrëveshjet në drejtësi dhe shuarjen e strukturës ilegale të “mbrojtjes civile,” krahas të tjerave që janë në proces.

Kosova vendos përfundimisht sistemin unitar të drejtësisë edhe në pjesën veriore të shtetit në fillim të vitit tjetër, përmes funksionimit të një gjykate themelore për shtatë komunitat dhe një zyre prokurorie, në përputhje me të gjitha ligjet e Kosovës, siç përcaktohet në marrëveshjen e Brukselit. Kosova ka finalizuar integrimin e gjykatësve, prokurorëve dhe stafit administrativ serb në sistemin e Kosovës, që shuan përfundimisht strukturat paralele serbe në këtë fushë.

Shuarja e strukturës ilegale të ashtuquajtur mbrojtje civile ka përfunduar, me integrimin e ish-pjesëtarëve të sajë në institucionet civile e shtetërore, sipas marrëveshjes. Pas shumë vitesh, institucionet qendrore të vendit që kanë veprimtari lokale do të funksionojnë në veri të vendit, duke konsoliduar sovranitetin shtetëror në të gjitha fushat institucionale. Plani i realizuar për integrim përfshinë një numër të madh të ministrive dhe të institucioneve/agjencioneve publike.

Këto arritje së bashku me arritjet në vendosjen e sistemit të policisë së Kosovës në veri, vendosjen e kontrollit në dy pikat kufitare dhe vendosjen e kufirit ndërshtetëror përmes marrëveshjes së IBM-it, si dhe zgjedhjen e strukturave dhe funksionimin legal të katër komunave veriore ndonëse ende të brishtë, përbëjnë një forcim të fuqishëm të sovranitetit territorial të shtetit në tërë vendin.

Marrëveshja për energji ka vendosur kufirin elektrik mes dy shteteve, sepse Kosova/KOSTT është bërë sistem i pavarur i transmisionit të energjisë në sistemin evropian të transmisionit (ENTSO-E).

Përmes marrëveshjes për telekomunikacion, Kosova ka siguruar kodin telefonik shtetëror 383, të cilin ITU do të ja alokojë në mars të vitit 2016, ku në emër të Kosovës do të aplikoj Austria. Me këtë marrëveshje vendoset kufiri frekuencor mes dy shteteve.

Heqja e barrikadës nga ura e Mitrovicës, e cila filloi në tetor përmes revitalizimit të urës nga BE, ka një simbolikë të fuqishme në kuptimet e konsolidimit të sovranitetit, sepse pas shumë vitesh do të jetë bashkuese dhe e lirë për qarkullim për të gjithë, qytetarët dhe automjetet në qershor 2016.

2. Forcimi i sundimit të ligjit, të mirëqenies, integritit dhe sigurisë së qytetarëve

Marrëveshjet e arritura dhe zbatimi i tyre kanë pasur ndikime të rëndësishme në përmirësimin e jetës së qytetarëve, si në planin socio-ekonomik ashtu edhe në planin politik dhe të sigurisë. Marrëveshjet kanë ndikuar në përmirësimin e gjendjes edhe në katër komunitat veriore si dhe në integrimin e serbëve të asaj pjese në institucionet shtetërore dhe në shoqëri.

Marrëveshjet si ajo e IBM dhe protokollin teknik, liria e lëvizjes, tregtia e lirë/ vulat doganore, SEED-in doganor (apo Shkëmbimin sistematik të të dhënave elektronike), grumbullimi i taksave doganore në pikëkalimet Jarinjë dhe Bërnjak, kanë pasur efekte të drejtpërdrejta në planin ekonomik dhe social, sepse kanë ulur dukshëm veprimtaritë e jashtëligjshme, kanë forcuar sundimin e ligjit dhe kontrollin efektiv kufitar. Janë shtuar dukshëm të hyrat në buxhetin e Kosovës nga rritja e të hyrave nga taksat. Një pjesë e taksave është derdhur në Fondin për zhvillimin e komunave veriore. Po ashtu, qytetarët janë liruar nga tarifat shtesë për sigurimin e automjeteve. Është zgjidhur çështja import eksportit të produkteve farmaceutike

përmes njohjes së ndërsjellë të certifikatës së produkteve mjekësore. Marrëveshjet për telekomunikacion dhe energjinë do të kenë ndikime të dukshme ekonomike, si dhe sigurojnë siguri dhe stabilitet për shtetin dhe qytetarët.

Në planin e stabilitetit politik dhe sigurisë kanë kontribuar një varg marrëveshesh siç janë ajo për Funksonimin ligjor të katër komunave veriore, vendosja e sistemit të policisë së Kosovës në veri dhe shuarja e policisë paralele të Serbisë, ndërsa së shpejti edhe e drejtësisë. Heqja e barrikadës do të krijoj një ambient më të sigurtë, është duke u punuar për ndaljen e ndërtimeve ilegale në veri, etnikisht të motivuara nga Serbia, dhe për vendosjen e rendit dhe ligjit në zhvillimin urban për të gjithë qytetarët.

3. Forcimi i sovranitetit ndërkombëtar - Avancimi i agjendës euroatlantike

Në planin diplomatik, Ministria e Dialogut ka zhvilluar një diplomaci të dendur lobizuese në planin bilateral dhe multilateral, në veçanti me SHBA-të dhe BE-në e vendet e BE-së, për të ndriçuar rolin konstruktiv të Kosovës në dialogun e Brukselit dhe për të kërkuar që Kosova të shpërblehet me përparimin në integrimin evropian dhe euroatlantik.

Si rezultat i dialogut të Brukselit, Kosova nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit (MSA) me BE-në, që është një dëshmi e fortë e forcimit të subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës si dhe njohje për sukseset në reformat evropiane dhe Dialogun e Brukselit. Dialogu ndihmoi që edhe pesë vendet mosnjohëse ta mbështesin MSA për Kosovën. Vlen të theksohet se BE-ja kishte marrë vendim për MSA-në për Kosovën në fund të vitit 2011, pas arritjes së pesë marrëveshjeve të para mes Kosovës dhe Serbisë. Po ashtu, kodi telefonik ndërkombëtar për Kosovën që ITU ia alokon Kosovës në mars 2016, konfirmon sovranitetin ndërkombëtar të Kosovës në fushën e telekomunikacionit. Kosova është bërë sistem i pavarur në sistemin evropian të transimisionit (ENTSO-E).

Poashtu, jemi angazhuar për shpejtimin e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës dhe përshpejtimin e integritetit të Kosovës në BE. Ndër caqet e lobimeve kanë qenë angazhimi për njohje nga pesë vendet anëtare të Bashkimit Evropian që të mos pengojnë MSA-në për Kosovën, në të mirë të paqes dhe stabilitetit në rajon. Kosova ka avancuar në anëtarësimet në organizata rajonale ku sivjet është anëtarësuar në Iniciativën Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë (MARRI), ndërsa më herët në Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal (RCC), Procesin e Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP), Bankën Evropiane për rindërtim dhe zhvillim (EBRD), në Shkollën Rajonale të Administratës Publike (ReSPA), Qendrën për Bashkëpunim të Sigurisë (RACVIAC), Komisionin e Venecias, etj.

Diplomacia është shfrytëzuar edhe për mbështetjen e qëndrimeve tona në dialog. Bashkëpunim i veçantë është zhvilluar me Qeverinë Amerikane dhe Ambasadën Amerikane në Kosovë, pastaj me Gjermaninë dhe vendet tjera.

Qeveria e Kosovës konsideron se dialogu i Brukselit duhet të përfundoj me njohjen reciproke mes dyja shteteve, Kosovës dhe Serbisë, para pranimit të tyre në Bashkimin Evropian, rezultat

ky që duhet të mbështetet nga të gjitha vendet e anëtare të Bashkimit Evropian, me qëllim të forcimit të paqes dhe stabilitetit në rajon dhe forcimit të një Evrope të tërë dhe të lirë.

Ministria e Integritimit Evropian - janë shënuar përparime të rëndësishme në avancimin e agjendës evropiane përmes themelimit të marrëdhënieve kontraktuale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe BE-së me anë të nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, si dhe miratimit e ratifikimit të saj nga Qeveria, respektivisht Kuvendi i Republikës së Kosovës. Janë bërë parapërgatitjet për zbatimin e MSA-së përmes përgatitjes së Programit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) dhe miratimit të tij nga Qeveria, më 16 dhjetor. Programi është dokumenti kryesor kombëtar i politikave për zbatimin e agjendës evropiane gjatë periudhës së ardhshme afatmesme (2016-2020) dhe parasheh zbatimin e mbi 1,000 masave vetëm gjatë vitit 2016 për përmbushjen e detyrimeve të MSA-së përmes përafrimit të legjislacionit kombëtar me *acquis*-në e BE-së, avancimit të politikave, reformave institucionale e ngritje së kapaciteteve të tyre, si dhe zbatimit në praktikë.

Është përmbyllur procesi i vlerësimit nga ana e KE-së për përmbushjen e kriterëve të Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave: është përmbyllur misioni i fundit faktmbledhës i BE-së dhe janë përmbushur të gjitha rekomandimet e kërkuara.

Qeveria ka themeluar Këshillin Kombëtar për Investime, i cili ka koordinuar përgatitjen e Listës Prioritare të Projekteve Infrastrukturore e cila përbëhet nga 39 projekte kyçe infrastrukturore në vlerë prej 2.4 miliardë euro. Janë programuar afro 80 milion euro të asistencës financiare të Instrumentit të Para Anëtarësimit në fushën e energjisë, bujqësisë dhe sundimit të ligjit.

MIE i ka dorëzuar KE-së inputin e parë të institucioneve të Republikës së Kosovës për Raportin e KE-së për Kosovën për vitin 2015 (për periudhën 1 shtator 2014 - 31 prill 2015), kurse me 1 shtator 2015 inputin e dytë për këtë raport (për periudhën 1 maj - 31 gusht 2015).

Në kuadër të parapërgatitjeve për zbatimin e MSA-së gjithashtu është punuar në shkëmbimin e përvojave me vendet e tjera. Për këtë qëllim, më 25-26 nëntor, MIE, në mbështetje të UNDP-së, ka organizuar një konferencë dy ditore me temën *"MSA: Çfarë mund të përfitojë Kosova nga përvoja e Kroacisë"*, ku kanë marrë pjesë ekspertë kroat që kanë qenë të involvuar në procesin e negociatave për anëtarësim të Kroacisë në BE dhe mbi 200 përfaqësues të institucioneve vendore.

MSA u nënshkrua më 27 tetor, në Strasburg, u miratua nga Qeveria e Kosovës më 30 tetor dhe u ratifikua nga Kuvendi më 2 nëntor.

Sa i përket koordinimit të strukturave qeveritare për Integritim Evropian, gjatë këtij viti janë mbajtur takimet e nivelit të komisioneve ekzekutive për integritime evropiane (shtatë komisioneve).

Vlen gjithashtu të përmendet se në drejtim të ngritjes së kapaciteteve të MIE-së dhe institucioneve të linjës për përafrimin dhe zbatimin e legjislacionit kombëtar me atë të BE-së dhe përgatitjeve për zbatimin e MSA-së, në mbështetje të zyrës së UNDP-së në Prishtinë, po ashtu edhe në përkrahje të GIZ janë mbajtur sesione trajnimesh për fushat prioritare të MSA-së. Fushat për të cilat janë mbajtur sesione trajnimi përfshijnë mbrojtjen e konsumatorit dhe

shëndetit publik, politikat e bujqësisë, politikat e konkurrencës, Tatimet dhe politikat doganore etj.

Janë përgatitur dhe organizuar të gjitha mbledhjet vjetore në kuadër të DPSA-së: Nën-Komiteti për Drejtësi, Liri dhe Siguri, më 27-29 janar, në Bruksel, Nën-Komiteti për Bujqësi, Zhvillim Rural, Pylltari, Peshkatori dhe Siguri e Ushqimit, më 4-5 mars, në Bruksel, Nën-Komiteti për Inovacion, Kapital Njerëzor, Politika Sociale dhe Shoqëri të Informacionit, më 10-11 mars, në Bruksel, Nën-Komiteti për Tregu i Brendshëm, Konkurrenca, Mbrojtja e Shëndetit dhe Konsumatorit, më 26 mars, në Prishtinë, Nën-Komiteti për Tregti, Industri, Dogana dhe Tatime dhe NVM, më 21 prill, në Prishtinë, Nën-Komiteti për Transportin, Mjedisi, Energjia dhe Zhvillimi Regjional, më 27-28 maj, në Prishtinë, Nën-Komiteti për Ekonomi, Statistika dhe Kontrolli Financiar, më 16 qershor, në Prishtinë, Grupi i Veçantë për Reformën e Administratës Publike, më 1-2 qershor dhe 24 nëntor, në Prishtinë, Takimi Plenar, më 9 korrik, në Prishtinë.

Për të gjitha takimet e DPSA-së, janë përgatitur raporte paraprake për zhvillimet në sektorë të cilat i janë dorëzuar KE-së para mbajtjes së takimeve dhe janë miratuar konkluzionet për secilin takim, që më pas janë monitoruar duke dorëzuar raporte periodike për përmbushjen e veprimeve pasuese.

Sa i përket Dialogut për Liberalizimin e Vizave, MIE ka azhurnuar raportin mbi gatishmërinë e Kosovës për liberalizim të vizave, ka identifikuar 'çështjet e hapura' apo ngecjet në procesin e realizimit të rekomandimeve të identifikuara në raportin e KE-së të dhjetorit 2014. Është mbajtur mbledhja e Komitetit Drejtues për Liberalizimin e Vizave (KDLV) dhe takimi i Grupit Punues teknik për koordinimin e hartimit të raportit të tretë të gatishmërisë së Republikës së Kosovës për liberalizim të vizave. Bazuar në raportet e ekspertëve nga ky mision, dhe ende pa u publikuar raporti zyrtar i Komisionit Evropian), në mënyrë pro-aktive MIE në bashkëpunim me institucionet përkatëse ka hartuar një plan të veprimit për realizimin e 8 çështjeve kryesore të identifikuara nga ana e ekspertëve.

Në bashkëpunim me KE-në janë finalizuar draftet e Dokumenteve Planifikuese Sektoriale (DPS): DPS për Sundimin e Ligjit dhe Drejtave Fundamentale, DPS për Bujqësi dhe DPS për Energji. DPS-të për Sektorin e Konkurrueshmërisë dhe Reformës të Administratës Publike janë në përfundim e sipër. Janë mbajtur takime konsultuese me donatorë dhe shoqëri civile për DPS-të e 5 sektorëve. Është përfunduar dhe miratuar lista e propozimeve për projekte në kuadër të programimit të IPA 2015, në vlerë prej afro 80 milion euro, ndërsa planet për programimin e IPA 2016 do të finalizohen në vitin pasues.

Është punuar në përgatitjen e nominimeve për instrumentin e TAIEX-it, dhe janë mbajtur takime punuese për përzgjedhjen e zbatuesve për projekte të Binjakëzimit/Tëining nga paketa e IPA 2015, respektivisht 5 projekte.

Në nivel rajonal, Kosova për herë të parë ka qenë nikoqire e IPA-së me Shumë Përfitues, i cili u mbajt më 4 - 5 qershor 2015 në Prishtinë.

Sa i përket strukturave koordinuese për ndihmën e jashtme, më 26 Tetor është mbajtur mbledhja e radhës e Forumit të Nivelit të Lartë. Sa i përket monitorimit të ndihmës së jashtme, gjatë kësaj periudhe është përgatitur raporti vjetor mbi aktivitetet të donatorëve për vitin 2014.

Gjatë vitit 2015 gjithashtu u nënshkrua Marrëveshja Kornizë me Komisionin Evropian për zbatimin e IPA II, u nënshkrua marrëveshja financiare për IPA 2014, si dhe marrëveshja financiare IPA 2014 dhe IPA 2015 për bashkëpunimin ndërkufitar me Maqedoninë, Shqipërinë dhe Malin e Zi. Së fundi u nënshkrua marrëveshja për bashkëpunim në reforma ndërmjet Kosovës dhe Suedisë.

Me qëllim të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit - në kuadër të avancimit të kornizës strategjike, institucionale dhe ligjore për përafrimin e legjislacionit kombëtar me Acquis të BE-së, gjatë periudhës raportuese është bërë kontrollimi i përputhshmërisë me acquis të BE-së i gjithsej 126 (njëqind e njëzetë e gjashtë) projekt-akteve legislative, nëntë dhjetë (90) janë projekt-akte ligjore dhe tridhjetë e gjashtë (36) janë projekt-akte nënligjore. Lidhur me ngritjen e kapaciteteve institucionale të ministrive të linjës, MIE në bashkëpunim me IKAP ka mbajtur trajnime në fushën e përafrimit të legjislacionit me acquis të BE-së. Gjithsej, janë mbajtur katër (4) trajnime në dy (2) runde. Trajnimet janë fokusuar në aplikimin e metodologjisë dhe udhëzimeve praktike gjatë procesit të përafrimit të legjislacionit kombëtar me acquis të BE-së.

Është përgatitur manuali praktik që përmban udhëzime dhe metodologji praktike lidhur me përafrimin e legjislacionit dhe përpilimin e tabelave të përputhshmërisë të legjislacionit të Kosovës me *acquis* të BE-së, gjegjësisht, *acquis* së BE-së me legjislacionin kombëtar.

Ka hyrë në fuqi Rregullorja nr. 02/2015 për procesin e përkthimit të *acquis*-së së BE-së në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, e miratuar nga Qeveria.

MIE ka grumbulluar nga Ministrinë e Linjës të gjitha aktet e BE-së me të cilat do të bëhet përafrimi i ligjeve vendore gjatë vitit 2016. Të gjitha këto akte janë dërguar tek kompania e përkthimit të kontraktuar nga MIE.

Në bazë të Marrëveshjes për përkthimin e legjislacionit të BE-së në gjuhën shqipe si dhe bashkëpunimit në sferën e përafrimit të legjislacionit në mes të Ministrisë së Integritimit Evropian të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Integritimit Evropian të Republikës së Shqipërisë, u mbajt takimi i rregullt i Komisionit Teknik.

MIE me financimin nga GIZ, realizoi blerjen e Sistemit Softuerik për Përkthim Studion Professional 2015. Është mbajtur një trajnim për përdorimin e sistemit TRADOS, financiar nga GIZ.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal - është bërë koordinimi i Integritimit të ashtuquajturës Mbrojtje Civile në Institucionet e Republikës së Kosovës për 483 punëtorë. Proces i rekrutimit të tyre ka përfunduar. 105 punëtor janë përfshirë në sistemin e pagave, kurse pjesa tjetër do të përfshihet në sistemin e pagave nga data 1 janar 2016. MAPL ka prodhuar një seri të dokumenteve për të ndihmuar ekipin negociator gjatë procesit të bisedimeve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Në kuadër të zhvillimit të politikave dhe avancimit të vetëqeverisjes lokale, janë hartuar:

- Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026 dhe Plan i veprimtari 2016-2026 (e miratuar në muajin dhjetor në Qeveri);

- Koncept-dokumenti për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtina (i miratuar në Qeveri);
- Projekt-rregullorja për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave (është dërguar për miratim në Qeveri);
- Projekt-Udhëzimi Administrativ për transparencë në komuna (pritet të nënshkruhet nga ministri i MAPL-së);
- Projekt-Udhëzimi Administrativ për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës (pritet të nënshkruhet nga ministri i MAPL-së).

Konform Rregullores së punës së Qeverisë janë hartuar shkresat konfirmuese për aktet e dërguara nga ministrinë e linjës: 33 Projektligje, 9 Koncept-dokumente, 18 Projekt-rregullore, 62 Projekt-Udhëzime administrative.

Në fushën e monitorimit dhe Zbatimit të ligjshmërisë dhe mbikëqyrjes së cilësisë së shërbimeve komunale janë shënuar këto të arritura:

- Janë shqyrtuar të gjitha ankesat/kërkesat e parashtruara nga komunitat dhe qytetarët. Në këtë kontekst, MAPL ka pranuar dhe shqyrtuar gjithsej 123 ankesa dhe kërkesa të parashtruara nga komunitat dhe qytetarët, të cilat ndërlidhen me zbatimin e legjislacionit për vetëqeverisje lokale;
- Janë ofruar përgjigje për 8 raste të konsultimeve paraprake me komunitat para miratimit të akteve të komunave;
- Janë hartuar 11 shpjegime ligjore për komuna lidhur me zbatimin e obligimeve ligjore.
- Janë dërguar për vlerësim të ligjshmërisë në ministrinë e linjës dhe komisione sektoriale gjithsej 710 akte të miratuara nga organet e komunave;
- Është përgatitur Doracaku i ligjeve dhe akteve nënligjore të Qeverisë së Republikës së Kosovës që ndikojnë në vetëqeverisjen lokale;
- Janë monitoruar 404 mbledhje të mbajtura të kuvendeve të komunave të Republikës së Kosovës, 363 kanë qenë mbledhje të rregullta, 38 të jashtëzakonshme, 1 mbledhje urgjente dhe 2 solemne. Për të gjitha mbledhjet e monitoruara, MAPL ka hartuar raportet e monitorimit;
- Nga 1527 akte të miratuara nga kuvendet e komunave (135 Rregullore dhe 1392 Vendime), MAPL ka vlerësuar ligjshmërinë e 817 akteve për të cilat ka qenë kompetente. Aktet të cilat nuk ka qenë në kompetencë të MAPL-së, janë adresuar në ministrinë e linjës për vlerësim të ligjshmërisë;
- MAPL së bashku me komisionet sektoriale të ministrive, kanë dërguar në komuna 60 kërkesa për rishqyrtim të akteve. Prej tyre 26 akte të komunave nuk janë harmonizuar me legjislacionin primar, ndërkaq 34 janë harmonizuar sipas kërkesave për rishqyrtim;
- Është realizuar monitorimi i drejtpërdrejtë i komunave, sipas Planit të Monitorimit, me qëllim të monitorimit të përmbushjes së obligimeve ligjore, verifikimin e zbatimit të kërkesave të MAPL-së për rishqyrtimin e akteve të kundërligjshme dhe përcaktimin e hapave për përmirësimin e zbatimit të ligjit.

Janë hartuar dokumentet, raportet dhe analizat si vijon:

- Raport për të hyrat dhe shpenzimet komunale për vitin 2014;
- Dy raporte për rekomandimet e auditorit gjeneral për komuna (krahasimet për vitin 2012 dhe 2013);

- Raporti për investimeve kapitale në komuna nga fondet e MAPL-së;
- Raporti i performancës së komunave 2014 (azhuriteti i administratës komunale dhe cilësia e shërbimeve publike komunale) si dhe ndarja e fondit stimulus;
- Analiza për të hyrat vetanake të komunave për periudhën 2010 – 2014;
- Analizë e funksionimit të Sistemit për Menaxhim të Performancës së Komunave (2010–2014);
- Është avancuar programi elektronik për sistemin e menaxhimit të performancës së shërbimeve komunale (CSC/CSM). Është bërë mbledhja e të dhënave nga komunat për treguesit matës të shërbimeve, zhvillimi i fushave dhe i treguesve për matjen e performancës së komunave, trajnimi i koordinatorëve të performancës komunale, mozaiku 2015 – anketimi i qytetarëve për nivelin e kënaqshmërisë së ofrimit të shërbimeve dhe vlerësimi i tregueseve të SMP-së.

Në ueb aplikacionin e MAPL-së janë publikuar raportet lidhur me funksionimin e komunave. Gjithashtu, janë ofruar përgjigje për 23 pyetjet e parashtruara nga mediet dhe shoqëra civile lidhur me mbikëqyrjen e cilësisë së shërbimeve komunale.

Në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve institucionale të komunave dhe transparencës komunale është organizuar fushata mediale për të drejtën e qytetarëve në informacion dhe zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, janë ofruar 11 informata për grupet e interesit lidhur me kërkesat për qasje në dokumente publike, përfshirë interesimet nga mediet dhe organizatat jo-qeveritare.

Janë organizuar një numër i seminareve dhe punëtorive, si: seminari për të hyrat vetanake të komunave; Seminari për zhvillim rajonal; Seminari për menaxhimin e projekteve; Organizmi i takimeve për planet e integruara; Punëtorja për model strategjinë dhe planin për zhvillim-socio-ekonomik lokal; Punëtorja për programim e zhvillim lokal dhe rajonal; Seminari për investimet e huaja në komuna; Punëtorja për të hyrat vetanake; Modulet e trajnimit për përfituesit nga programet e bashkëpunimit ndërkufitar.

Është realizuar programi 4 ditor i trajnimeve për fushën e integrimit evropian për zyrtarët komunal të integrimi evropiane dhe zyrtarët e nivelit qendror për integrimi evropiane.

Me qëllim të mbështetjes së kapaciteteve të zyrtarëve komunal në fusha të ndryshme të vetëqeverisjes lokale janë hartuar dokumentet udhëzuese si vijon:

- Udhëzuesi për model-strategjinë dhe planin për zhvillim socio-ekonomik të komunave;
- Doracak për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, sipas rekomandimeve të adresuara në Raportin e Progresit. Ky doracak është hartuar për të përmbushur detyrimet që dalin nga dialogu për liberalizimin e vizave dhe për t'iu shërbyer komunave (KKSB-ve) për zbatimin e dispozitave ligjore dhe politikave lokale me ndikim në sferën e sigurisë në bashkësi;
- Udhëzuesi për parimet e vetëqeverisjes lokale në Kosovë – aspekte krahasuese me parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale;
- Drafti-Udhëzuesi për menaxhimin e pronës komunale;

- Udhëzuesi për zëvendës-kryesuesit e kuvendeve të komunave nga radhët e komuniteteve jo shumicë për planifikimin dhe zbatimin e detyrave të punës dhe përgjegjësi të tyre. Udhëzuesi për mënyrën e përfitimit nga fondet e IPA-së;
- Draftet për profilet e 38 komunave.

Ministria për Komunitete dhe Kthim- ka vazhduar të ofrojë mbështetje financiare për nismat për kthim dhe ri-integrim. Ndërtimi i shtëpive është një shembull i qartë i përpjekjeve të vazhdueshme të MKK-së për strehimin e të kthyerve të komuniteteve të ndryshme duke ju siguruar kushte të dinjitetshme për jetesë të cilat më pastaj do të kenë efekte përcjellëse pozitive në aspektet e tjera të jetës së tyre siç është punësimi, shëndeti, arsimi etj. 134 familje të kthyerja janë përfituese të mbështetjes nëpër regjione të ndryshme.

Në kuadër të Projektit "Kthimi dhe Riintegrimi në Kosovë 4" (BE-RRK 4"), është program i financuar nga Bashkimi Evropian dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim, përmes Zyrës së BE-së në Kosovë dhe zbatohet nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM/ONM) në 7 komuna të Kosovës: Pejë, Klinë, Istog, Shtërpçë, Obiliq, Suharekë dhe Gjilan. Projekti i BE-së "RRK 4" synon të mbështesë kthimin e 250 familjeve në vendet e origjinës.

Në kuadër të projektit BE-RRK 4 janë ndërtuar 121 shtëpi për familjet e kthyerja në komuna. Përfituesit e programit kanë marrë edhe pako të harmonizuara ushqimorë, higjienikë, orëndi shtëpiake, pajisje shtëpiake dhe grante për gjenerimin e të ardhurave nga partnerët në projektin "Arbeiter Samariter Bund" (ASB) dhe Këshilli Danez për Refugjatë (DRC/KDR).

Në kuadër të programit për mbështetjen e risistemimit për të kthyerit të komunitetit romë, ashkali dhe egjiptian nga Maqedonia dhe Mali i Zi, financuar nga BE dhe bashkëfinancuar nga MKK, për kthimin e të zhvendosurve të komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian janë përfshirë 60 familje që janë zhvendosur në kampet në Maqedoni dhe Mal të Zi.

Janë ndërtuar 13 shtëpi të mbetura, nga të cilat 12 janë për familjet e komunitetit Egjiptian në komunën e Gjakovës, dhe një për familjet Rome në komunën e Fushë Kosovës. Në total të programit në periudhën 2013-2015 janë ndërtuar 61 shtëpi për 61 familje të kthyerja të këtij komuniteti.

Projektet Infrastrukturore për Integrimin e Komuniteteve - Përmes projekteve të ndryshme të ndërtimit dhe rekonstruimit të shtëpive, ndihmës për shkolla, ndërtimit të qendrave kulturore dhe sportive, rrugëve, rrjeteve të kanalizimit, urave, shesheve, ndriçimeve rrugore dhe projekteve për qëndrueshmërinë e tyre, MKK-ja është munduar që komuniteteve t'iu sigurojë kushte për jetë stabile dhe normale në tërë Kosovën.

Janë përfunduar projektet infrastrukturore: Ndërtimi i parkut në Shtërpçë, Riasfaltimi i pjesës së rrugës nga ura tek Lipa drejt qytetit - Komuna e Shtërpçës, Asfaltimi i fushës sportive në fshatin Staro Gacko - Lipljan, Gërmimi i pusetave për ujë të pijshëm në fshatin Rajanovce - Ranillugut dhe në fshatin Strazha - Novo Brdo, Rindërtimi i fushës së basketbollit në Shtërpçë - komuna e Shtërpçës.

Ndërsa projektet të cilat janë në proces të punimeve dhe finalizimit, janë:

Projektet Në Bashkëpunim me OjQ-të Për Stabilizimin e Komuniteteve - Janë ndihmuar në mënyra të ndryshme komunitetet në mbarë Kosovën edhe përmes shoqërisë civile. Me iniciativat e qytetarëve dhe organizatave jo-qeveritare, MKK-ja ka financuar një numër të madh të projekteve nga fusha e edukimit, kulturës, sportit, manifestimeve fetare dhe shumë fushave të tjera që kanë rëndësi për kualitetin e jetës së qytetarëve.

Ky lloj i ndihmës përmes projekteve me të cilat kanë konkurruar organizatat jo-qeveritare, ka pasur për qëllim përmirësimin e jetës kulturore dhe edukimin e qytetarëve në fushat e lartpërmendura.

Programi i Be-së për Stabilizimin e Komuniteteve Faza Iii (Be- Csp Iii) - Qëllimi i programit është vazhdimi i mbështetjes së komunitetit pakicë në 38 komunat e Kosovës. Grupet minoritare të synuara përfshijnë Serbët etnikë, pjesëtarët e Romëve, Ashkalinjëve dhe Egjiptasve, Turq, Goranë, Boshnjakë, nga BE 2 milion euro dhe kontributi prej 230,000.00 euro nga MKK-ja.

Të gjitha projektet e shqyrtuara dhe miratuara nga Komisionet Komunale Mbështetëse kanë qenë të vlerësuara, rishikuara, dhe të miratuara në nivel komuniteti / komuna përmes Komiteteve nga Projekti për Mbështetje, të cilët kanë dhënë mbështetjen e tyre për secilin nga projektet. Të gjitha këto projekte janë zbatuar një vlerë të përgjithshme prej € 212,594.28. Nga kjo shumë e kontributit të EU-CSP III është € 148,438.28 dhe kontributi i drejtpërdrejtë i Komunave përfituese përfitues e 64,156.00 €.

Arritjet kryesore të projektit: Rregullimi i oborrit të Kishës – Babin Most/Obiliq, Furnizimi me energji elektrike për komunitetet e kthyerë – Dubravë/Istog, Ndërtimi i pusëve për ujë në fshatin Novak – Novak/Prizren, Rekonstruimi i terenit për futboll të brendshëm – Shtërpçë, Veshje tradicionale – Bresje/Fushë Kosovë, Furnizimi me kamiona për mbledhjen e mbeturinave dhe pastrimi i mbeturinave në fshatin Çabër – Çabër/Zubin Potok, Zërimi dhe teknologjia e II-së – Kisha në Prizren, Rregullimi i rrjetit të kanalizimit – Hoçë e Madhe/Prizren, Riparimi i ngrohjes qendrore – Ajnovcë/Shtërpçë, Renovimi i terrenit sportiv – Snaishor/Kamenicë, Renovimi i Kishës – Bresje/Fushë Kosovë, Parku për lojëra për komunitetet e kthyerë – Nakell/Pejë, Ndërtimi i rrugës për komunitetet e kthyerë – Gorazhdevc/Pejë, Renovimi i Shkollës Fillore – Shtërpçë.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - gjatë vitit 2015 janë miratuar 17 Udhëzime Administrative dhe 2 Rregullore, nga legjislacioni primar MMPH për arsye të natyrave të ndryshme dhe mos koordinimit të mirëfilltë ndërinstytucional nuk ka arritur të miratoj asnjërin nga 6 projektligjet e parapara.

Ka përfunduar Master Plani për menaxhimin e Mbeturinave – që është një plan për veprim për komunat për menaxhimin sa më të mirë të mbeturinave nëpër komuna dhe riciklimin e tyre. Hartimi i këtij Plani është bërë në përkrahje të KE.

Ka përfunduar Raporti Kombëtar për Gazra Serrë për vitin 2012 dhe është në përfundim e sipër edhe inventari i gazrave serrë për vitin 2013. Ky raport është i realizuar në kuadër të projektit "Bartja e eksperiencës Çeke në aktivizimin e sistemit për monitorimin e Gazrave të serrës në Kosovë". Përgatitja e Raportit është përkrahur nga UNDP. Një përmbledhje e të dhënave kryesore të raportit është përfshirë në kuadër të Raportit për gjendjen e mjedisit 2015.

Raporti mbi gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2015, është miratuar në Kuvend me datë 30.11.2015. Është përgatitur Raporti për Gatishmërinë e vendit për themelimin e Rrjetit për zonat e mbrojtura NATURA 2000.

Është publikuar Raporti për gjendjen e natyrës 2010-2014 dhe versioni elektronik është publikuar edhe në ueb faqen e AMMK.

Në kuadër të aktivitetit Renovimi i stacioneve hidrometrike sipas Pellgjeve lumore, janë shënuar rezultate në përmirësimin e rrjetit hidrometrik të ujërave sipërfaqësor përmes të cilit bëhet monitorimi i sasisë dhe nivelit të ujit. Në Mbështetje të UNDP, po vazhdon edhe instalimi i 25 shimatësve manual për matjen e reshjeve.

Janë miratuar dhe publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës 10 Vendime për Shpalljen e Zonave të Mbrojtura Sanitare.

Janë ndërmarrë një serë aktivitete në kuadër të ndalimit të veprimeve ilegale të funksionimit të furrave të gëlqeres në komunat Lipjan Shtime dhe Malishevë.

Në kuadër të aktivitetit për ndalimin e të gjitha ndërhyrjeve në zonat e veçanta të mbrojtura të natyrës janë zhvilluar aktivitete inspektive dhe janë ndërprerë të gjitha aktivitetet dhe ndërtimet e paligjshme në këto zona si: në Manastirin e Deçanit, në zonën e Ujëvarës së Mirushës dhe ndërtimeve të realizuara brenda kufijve të Qendrës Historike të Prizrenit.

Në kuadër të fuqizimit të Planifikimit hapësinor, Ndërtimit, Banimit, administrimit të tokës dhe zhvillimit të kadastrit, përfshirë edhe shpronësimin, janë realizuar këto të arritura:

Ka filluar dhe vazhdon Rindërtimi i Informacioneve kadastrale në 50 zona kadastrale në 10 Komuna.

Në kuadër të shpronësimit të pronave për interes Nacional sipas Vendimeve të Qeverisë, MMPH gjatë vitit 2015 ka proceduar 440 lëndë dhe ka shpronësuar dhe kompensuar 632 prona në vlerë prej 23,743,267€, buxheti për kompensim i ndarë për vitin 2015 është realizuar 99.8%. Gjithashtu, ka pasur për zbatim 19 Vendime të Qeverisë, prej të cilave i ka zbatuar 12 dhe 7 janë në zbatim e sipër.

Gjatë vitit 2015, në MMPII zhvilluar edhe 11 projekte të rëndësishme në fushën e mbeturinave, ujërave dhe fushën e planifikimit, ndërtimit dhe banimit, prej të cilave disa janë në përfundim e sipër kurse të tjerat vazhdojnë.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit - me qëllim të mbrojtjes së të Drejtave të Autorit dhe të Drejtave të Përafërta - Qeveria ka miratuar Projektligjin për Plotësimin dhe Ndryshimin e

Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, i cili është në harmoni të plotë me direktivat e BE-së të kësaj fushe.

Janë ofruar këshilla ligjore për mbi 100 mbajtës të të drejtave. Me qëllim të promovimit të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta janë mbajtur seminare në Gjakovë, Ferizaj, Mitrovicë dhe Prishtinë. Është botuar numri i dytë të revistës "Autori". Për mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe të drejtat e përafërta, janë trajnuar gjyqtarë nga Gjykata e Apelit e Kosovës, nga Gjykata Themelore e Prishtinës - Departamenti për Çështje Ekonomike, dhe pjesëtarë të Policisë së Kosovës, Doganës së Kosovës dhe Inspektoratit të Tregut. Poashtu, janë mbajtur disa ligjërata me student në Prishtinë, Ferizaj, Mitrovicë dhe Prizren.

Task Forca Kundër Piraterisë dhe Falsifikimi, në kuadër të obligimeve të saj në qendrat kryesore të vendit ka sekuestruar mbi 2000 (dy mijë kopje) të materialëve pirate dhe për shkelësit janë shqiptuar gjoba dhe filluar procedurat në gjykatat kompetente.

Për kryerjen e obligimeve në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit janë miratuar edhe akte nënligjore si në vijim: Rregullore 02/2015 (MKRS) për Kushtet dhe Kriteret e Themelimit dhe Funksionimit të bibliotekave; Rregullore 03/2015 (MKRS) për Revizion, Spastrim dhe Çregjistrim të Koleksioneve dhe Materialeve Bibliotekare; Rregullore Nr. 04/2015 (MKRS) për Kushtet dhe Kriteret e Themelimit të Teatrove Kombëtare dhe të Teatrove të Qyteteve; Rregullore Nr. 05/2015 (MKRS) për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Materialeve Bibliotekare; Rregullore Nr. 06/2015 (MKRS) për Çmimin Kombëtar Letrar për Vepër Jetësore "Azem Shkreli" dhe për Çmimet Vjetore për Letërsi; Rregullore Nr. 07/2015 (MKRS) për Mënyrën e Funksionimit, dhe Kriteret e Procedurat e Ekspozimit në Galerinë e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Rregullore Nr. 08/2015 (MKRS) për Mënyrën e Ruajtjes dhe të Shfrytëzimit të Materialit Arkivor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit Rregullore Nr. 09/2015 (MKRS) për Subvencionimin në Fushën e Kulturës, Trashëgimisë Kulturore, Rinisë dhe Sportit.

Statutet për institucionet vartëse të MKRS-së: Statuti i Ansamblit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve "Shota", Statuti i Filarmonisë së Kosovës, Statuti i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani" dhe Statuti i Baletit Kombëtar të Kosovës.

Udhëzimet Administrative: për Funksionimin Komitetit Olimpik të Kosovës për Themelimin dhe licencimin e Federatave dhe Shoqërive Sportive për Themelimin dhe Regjistrimin e Klubeve Publike dhe Private të Sportit dhe për Edukim Jo Formal të Rinjve.

Ministria e Administratës Publike - në kuadër të angazhimeve për kompletimin e politikave dhe standardeve, në koordinim me institucionet tjera është përgatitur drafti i Strategjisë për Qeverisje Elektronike 2016-2020 dhe draft rregullorja për Koordinim e ASHI-së me zyrat e TI-së së Institucioneve tjera. Gjithashtu, janë përgatitur Udhëzimet Administrative për llogari elektronike zyrtare, për ueb faqet e institucioneve publike, udhëzimi administrativ për harduer dhe softuer si dhe hartimi i disa urdhërësive administrative për menaxhimin e TIK-ut në institucione.

Përkrahja në ofrimin e resurseve është fokusuar në ofrimin e hapësirës për hostimin e pajisjeve harduerike në Qendrën e të dhënave shtetërore dhe dhënie e resurseve harduerike për

shfrytëzim duke përdorur private cloud computing. Gjatë këtij viti, Institucionet që kanë hostuar pajisje harduerike ose i janë dhënë në shfrytëzim resurse harduerike në Qendrën e të dhënave janë: Doganat e Kosovës, Ministria e Financave, Agjencia Qendrore e Prokurimit Publik, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Bujqësisë, Zyra e Kryeministrit, Komuna e Dragashit, Komuna e Mitrovicës, Komuna e Drenasit, etj. Në total resurset harduerike që i janë dhënë institucioneve tjera për shfrytëzim nga qendra e të dhënave janë 14 serverë me kapacitet prej 5 TB hapësirë për ruajtjen e të dhënave, 192 GB RAM memorie dhe 68 procesorë.

Po ashtu, gjatë këtij viti janë realizuar këto projekte në fushën e TIK: Fuqizimi i Qendrës shtetërore e të dhënave, fuqizimi i rrjetit shtetëror, avancimi i sistemit të postës elektronike zyrtare (në sistemin e ri janë bartur llogaritë e mbi 15000 shfrytëzuesve), migrimi i shfrytëzuesve nga Office Communicator në Lync, ngritja e performancës së rrjetit në 32 institucione, demontimi i pikës transmetuese në Gjilan, rilokimi i pikës transmetuese TSS në Golesh, ngritja e performancës së rrjetit, Ëireless dhe VoIP implementimi në 32 institucione, kyçje të reja shtesë me VPN në 35 institucione, furnizimi i Institucioneve qendrore dhe lokale me softuer të licencuar të Microsoft-it si dhe disa institucioneve edukative-arsimore.

Është vazhduar më mirëmbajtjen e sistemeve elektronike duke përfshirë rrjetin shtetëror (janë realizuar 760 intervenime), telefoninë (janë realizuar 1651 intervenime), qendrën shtetërore e të dhënave, infrastrukturën private cloud computing, posta elektronike zyrtare, e pasuria, Sistemi i Vijueshmërisë në Punë, Sistemi Gjendja Civile si dhe shumë sisteme tjera aplikative.

Menaxhimi i Objekteve Qeveritare

Nëpërmjet një Marrëveshje Bashkëpunimi është bërë bartja e 11 projekteve kapitale për ndërtimin e objekteve shkollore nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Ministrinë e Administratës Publike. Ndërsa, kur është në pyetje zbatimi i projekteve kapitale, punimet kanë përfunduar në Pallatin e Drejtësisë, dhe në fazën e dytë të ndërtesës së MFSK-së. Në këtë periudhë ka vazhduar ndërtimi i ndërtesave të prokurorive themelore në Gjilan, Ferizaj, Gjakovë dhe ndërtimi i qendrave të paraburgimit në Gjilan dhe në Prishtinë dhe ndërtimi i Universitetit të Mitrovicës. Po kështu, është përgatitur dokumentacioni investivo-teknik për ndërtimin e ndërtesës së IKAP-it dhe për këtë pritet vendimi i komunës së Prishtinës për lejin e lokacionit. Ndërsa në Lipjan ka filluar ndërtimi i Qendrës Korrektuese.

E arritur e veçantë është padyshim akomodimi i gjykatave, dhe prokurorive të shtetit në kompleksin e pallatit të drejtësisë, MFSK në ndërtesë të re, Doganat e Kosovës, Ministria e Diasporës, IKAP, Federata e Sindikatës së Shërbyesve Civil, Sindikata e përgjithshme e administratës publike, ATK, OSHP, KRPP, Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, një pjesë e këtyre subjekteve kanë qenë të akomoduar në hapësira private si p.sh. Doganat e Kosovës dhe agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë.

Regjistrimi i OJQ-ve

Në Departamentin për Organizata Joqeveritare, gjatë vitit 2015 janë regjistruar 496, prej tyre: 490 janë OJQ-ja, regjistruar vendore, 6 Ndërkombëtare.

Struktura nacionale e themeluesve të OJQ-ve është si në vijim: 382 OJQ janë të regjistruara nga themeluesi me përkatësi kombëtare shqiptare, 83 Minoriteti serb dhe 25 janë multi-etnike nga përfaqësues të etnive të ndryshme. Ju është njohur Statusi për Përfitim Publik 13 OJQ-ve. Ndërsa, kemi pas edhe tri vendime për Rinjohje të SPP dhe një kërkesë për SPP është refuzuar.

Gjatë kësaj periudhe janë pranuar gjithsej 254 raporte vjetore të OJQ-ve. Prej tyre 201 raporte me SPP aktive, dhe 27 pa SPP dhe 11 me SPP të revokuar dhe 15 raporte me përmirësime për vitet të ndryshme. Të obliguara për të sjellë raport vjetor për vitin 2014 kanë qenë 227 OJQ. Prej tyre vetëm 201 raporte janë dorëzuar.

Nuk kanë sjellë raport edhe 26 OJQ me SPP aktive. Në periudhen raportuese me vendim të DOJQ/ ju ka pezulluar veprimtaria 13 (trembëdhjetë) OJQ-ve.